

Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash

Raportet e projekteve për thellim dhe
implementim të projektit rrjeti Kultura
e parë, e dytë dhe ndërkultura (NEZI)

Seria e dokumentacioneve e Qendrës
International Projects in Education
Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihut
Vëllimi 2

Botues i këtij vëllimi

Basil Schader, Prof. dr. dr., përgjigjës për projekte në Qendrën IPE të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut
Rolf Gollob, Prof. dr. h.c., bashkëdrejtues të Qendrës IPE të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut

Përkthimet shqip – gjermanisht dhe gjermanisht – shqip

Brikena Kadzadej, Prof. dr.; Departamenti i Gjermanistikës, Universiteti i Tiranës

Lektorati i teksteve shqip

Brikena Kadzadej, Prof. dr.; Departamenti i Gjermanistikës, Universiteti i Tiranës

Koncepti dhe kopertina

Nadine Hugi

Layouti dhe radhithja

Barbara Müller

Printimi

Shtypshkronja Printing press, Prishtina

Mbështetja financiare

Rrjeti «Kultura e Parë, e Dytë dhe Ndërkultura» u financua nga Sekretariati Shtetëror Zviceran për Arsime, Hulimtim dhe Inovacion (SBFI)

Dorëzimi/Porosia

PH Zürich, Zentrum IPE
LAA M042
Lagerstrasse 9
CH-8090 Zürich
ipe@phzh.ch

© 2017 Zentrum IPE (International Projects in Education) der PH Zürich. <http://www.phzh.ch/ipe>
Të gjitha të drejtat i rezervohen autorit.

Kjo vepër është e mbrojtur nga të Drejtat e Autorit. Për këtë arsye të drejtat e argumentuara, veçanërisht të përkthimit, të ribotimit, të referimit apo të shumëfishimit dhe të memorizimit në dosjet e përpunimit të të dhënave, mbeten të rezervuara edhe gjatë ripërdorimit vetëm në fragmente. Shumëfishimi i veprës apo i pjesëve të veprës është i lejueshëm edhe në raste të veçanta vetëm në kufijtë e përcaktimeve ligjore të ligjit për të Drejtat e Autorit në versionin në fuqi. Ato parimisht janë të detyruara për dëshmipërbllim.

Ky vëllim del në një botim në gjuhën shqipe dhe gjermane.

ISBN Botimi në gjermanisht: 978-3-9524544-6-6

ISBN Botimi në shqip: 978-3-9524544-7-3

Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash

Raportet e projekteve për thellim dhe
implementim të projektit rrjeti Kultura
e parë, e dytë dhe ndërkultura (NEZI)

BASIL SCHADER, ROLF GOLLOB (BOTUES)

Përmbajtja

FJALË PËRSHËNDETËSE	5
---------------------	---

HYRJE	
Basil Schader, Rolf Gollob	7

Rrjeti «NEZI»	8
Projektet për thellim dhe implementim të rrjetit NEZI	10
Sfonde, parahistoria	10
Projektet në një shikim	12
Rishikim	14
Vështrime; propozime për projekte të ngjashme	16
Për formën e tekstit	17

RAPORTET PËRMBYLLËSE TË PROJEKTEVE PËR THELLIM DHE IMPLEMENTIM

Projekte konkrete për zbatim në fushën e formimit për demokraci, të të Drejtave të Njeriut dhe të diversitetit

1	Akademia e Kosovës për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut	20
2	Vlerat demokratike në arsim dhe aplikimi i tyre në shoqëri	34
3	Javë studimore për temën «Diversiteti në fushën e konfliktit shkollë, familje dhe kolegë si sfidë për punën sociale»	44
4	Demokracia në praktikë – Trajnim pilot për versionin në gjuhën shqipe të uebsajtit www.living-democracy.al për Shqipërinë dhe Maqedoninë	54
5	Shkolla Verore Rajonale në Edukim	62

Projekte për zhvillimin dhe forcimin e strukturave ndihmëse

6	Ngritja e një partneriteti ndërkombëtar (IPATE)	79
7	Dokumentimi videografik për mësimin shqip të gjuhës së prejardhjes (MGJP) në katër vende	91

Projekte hulumtuese në fushën e bikulturalitetit

8	Të rinjtë me prejardhje shqiptare midis identitetit kombëtar dhe fetar	103
9	Fenomeni i «shacave» i parë në mënyrë multiperspektive	116
10	«Përkthimi është kulturë»	139


Fjalë përshëndetëse

Vëllimi II DOK është i lidhur drejtpërdrejt me vëllimin e parë të serisë DOK. Ndërkohë që ai paraqet përfundimet e fazës së parë, më shumë plenare dhe të orientuara nga përvoja dhe shkëmbimi (2013 – 2015) të Projektit «Rrjeti i kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkultures» (NEZI), vëllimi i tanishëm paraqet përfundimet e fazës vijuese dhe për zbatim (2016). Karakteristike për këtë ishte puna e fokusuar në grupe të vogla dy- ose shumë-kombëshe, tematikisht dhe në përputhje me kompetencat profesionale të pjesëmarrësve në projekte konkrete për zbatim dhe shpërndarje, por gjithashtu edhe në projekte për të forcuar strukturat ndihmëse dhe në projekte të orientuara drejt hulumtimit.

Qëndrueshmëria dhe zbatimi i gjerë i përmbajtjes së fokusuar, janë ndër shqetësimet qendrore të IPE-së. Në kompetencat e saj të njohura thelbësore përfshihet realizimi për më shumë se dhjetë vjet i suksesshëm i projekteve të qëndrueshme dhe të zbatuara gjerësisht. Projektet vijuese dhe për zbatim të NEZI-t paraqesin një hap të mëtejshëm në këtë drejtim. Modeli i instalimit dyfazësh të rrjeteve dhe projekteve të ngjashme, së pari një fazë më e gjatë shkëmbimi, trajnimit dhe njohja e ndërsjellë, së fundi projektet e zbatimit dhe të aplikimit në një shkallë më të vogël, ka provuar të jetë një gjë e mirë. Për të qenë e plotë do të ishte mirë një takim përfundimtar në grup të madh, në të cilin do të prezantoheshin dhe diskutoheshin në seancë plenare përfundimet e arritura në fazën II.

Të gjithë pjesëmarrësve të kësaj faze dhe të këtij libri, u shkon një falenderim i përzemërt.

Prof. Dr. Wiltrud Weidinger, Prof. Dr. h.c. Rolf Gollob,
Drejtues Qendra e Projekteve Ndërkombëtare



Hyrje

BASIL SCHADER, ROLF GOLLOB

Rrjeti «NEZI»

Me iniciativën e Qendrës së Projekteve Ndërkombëtare në Arsim (IPE) në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zyrih, filloi në vitin 2013 Projekti «Rrjeti i kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës: Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash» (shkurt: NEZI).

Kohëzgjatja e Projektit ishte e limituar në periudhën prej 1 qershorit 2013 deri më 31 dhjetor 2015; Ai u financua nga Sekretariati i Shtetit për Arsim, Hulumtimin dhe Inovacionin. Si drejtues të Projektit ishin Prof. Dr. h.c. Rolf Gollob dhe Prof. Dr. Dr. Basil Schader nga Shkolla e Lartë Pedagogjike Zyrih, mbështetur nga lic. Phil. Shqipe Bajrami.

NEZI u konceptua si një projekt bashkëpunimi i partnerëve nga hapësira shqiptare (Shqipëria, Kosova, Maqedonia) dhe nga Zvicra. Kjo e fundit u përfaqësua nga dy grupet respektivisht pa rrënjë shqiptare. 33 pjesëmarrësit e përzgjedhur me kujdes, ishin kryesisht profesionistë nga trajnimi për mësuesit universitarë ose parauniversitarë, por gjithashtu lektorë nga fushat që mbulohen nga NEZI, si edhe ekspertë të tjerë të kualifikuar për tematikat.

Kufizimi në hapësirën shqiptarofolëse dhe në Zvicër solli me vete një lehtësim gjuhësor në një gamë më të gjerë dhe lejoi të grumbullohej përvojë në këtë kontekst, e cila më vonë do të zbatohet për formate të zgjeruara.

Pikat kyçe tematike të Rrjetit formonin dy fusha të mëdha tematike tepër aktuale si në Zvicër edhe në Ballkan:

- a** Orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës, është një detyrë sfiduese për grupin e madh (rreth 250,000) të emigrantëve shqiptarë në Zvicër, por edhe të refugjatëve të Kosovës dhe të pakicave etnike në vendet shqipfolëse.
- b** Shqetësimet për një edukim dhe trajnim, orientuar drejt vlerave të demokracisë, të edukimit qytetar dhe të të Drejtave të Njeriut. (Edukimi demokratik qytetar, Edukimi për të Drejtat e Njeriut EDN) (Education for Democratic Citizenship, EDC, Human Rights Education, HRE).

Në këto fusha kryesore duhet të fitohen njohuri të thelluara nga pjesëmarrësit e NEZI-t; në njërën anë në formën e shkëmbimeve shkencore dhe kërkimore, kurse në anën tjetër përmes shkëmbimit reciprok të përvojës përshtatur me rrethanat e vendeve të veçanta. Së fundi, por jo më pak me rëndësi, Projekti duhet të nxisë mirëkuptimin dhe njohjen e ndërsjellë (gjithashtu brenda tri vendeve shqipfolëse), po ashtu si objektiv i dytë, të japë impulse për një formë didaktike, inovative dhe interaktive të konferencave.

Kuadrin për këtë gjë e ofruan pesë konferenca, të cilat u mbajtën në Tiranë, Prishtinë dhe Shkup, si dhe dy në Cyrih. Për afro gjashtë muaj ndërmjet konferencave, u dakortësuan detyrat e leximit dhe puna përgatitore për të siguruar vazhdimësinë. Temat e pesë konferencave ishin:

- Të rriturit dhe zhvillimi i identitetit në dhe midis sistemeve dhe normave të ndryshme të referimit (Cyrih, 7 – 8 nëntor 2013).
- Përvoja me koncepte të ndryshme të demokracisë dhe pjesëmarrja në kulturën e parë dhe të dytë; Ndikimi në marrëdhëniet me vendin dhe kulturën e origjinës (Prishtinë, 8 – 9 maj 2014).
- Trajtimi i edukimit demokratik (EDC): përvoja shkollore autentike; realizuar dhe jo realizuar ende në vende të ndryshme (Shkup, 6 – 7 nëntor 2014).
- Kontributi i mësimi të gjuhës së prejardhjes dhe mjetet mësimore për një orientim më të mirë midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës dhe për edukimin demokratik në diasporë (Cyrih, 7 – 8 maj 2015).
- Kontributi i trajnimit të mësuesve në të katër vendet për EQD dhe përkrahja për orientimin e pakicave etnike (përfshirë migrantët dhe emigrantët) midis kulturës së parë, të dytë dhe ndër-kulturës; Përfundimi i Projektit (Tiranë, 5 – 6 nëntor 2015).

Informacione të hollësishme mbi konceptimin dhe kronologjinë e Rrjetit për objektivat e tij dhe konferencat e veçanta gjenden në vëllimin e konferencës për Projektin (në tekstin vijues DOK vëllimi I), i cili u botua në vitin 2016.¹ Në të njëjtin vëllim gjenden edhe raportet e hollësishme të pjesëmarrësve mbi përfitimet dhe pasojat e bashkëpunimit të tyre në NEZI si dhe (fq. 80 ff.) një vlerësim përfundimtar me vështrim dhe perspektivë nga ana e drejtimit të Projektit.

¹ Basil Schader (Hg.; 2016): Për dinamikën e të rriturit në dhe midis normave dhe sistemeve të ndryshme të referimit. Përvojat dhe perspektivat nga Projekti Rrjeti i kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës (NEZI). Raporti për Projektin. Cyrih: Qendra IPE (= Seria DOK e IPE-së, vëllimi I)..

Projektet për thellim dhe implementim të rrjetit NEZI

Sfondi, parahistoria

Që në fillim nga pjesëmarrësit u paraqit dëshira, të vazhdonin bashkëpunimin e mirë në Rrjet, përtej kohëzgjatjes së pesë konferencave. Dëshira u bë më e saktë nga shqetësimi që ky vazhdim të mund të realizohej në ekipe më të vogla dhe më homogjene sipas kualifikimeve të pjesëmarrësve.

Të dyja këto shqetësime ishin plotësisht në përputhje me idenë dhe objektivat e NEZI-t, por qëndrueshmëria dhe përdorimi i kontakteve të lidhura në Rrjet përfshiheshin në mënyrë eksplicite në objektivat e tij (shih vëllimin I DOK, fq. 15f.). Sidoqoftë, nga dorëzimi i Projektit dhe planifikimi financiar, në vijim nuk ishin parashikuar projekte institucionale të financuara. Që nga mesi i periudhës së Projektit u bë e qartë se me llogaritjen shumë të kujdesshme (hotele më të lira, shpenzime më të ulëta të referencës etj.), buxheti i vlerësuar në fillim nuk duhet të shfrytëzohej plotësisht në fund të Projektit.

Për të qartësuar nevojat aktuale, interesat dhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm, pjesëmarrësve iu kërkua të shpreheshin me hollësi në kuadrin: e një grupi për çdo vend dhe b) një pyetësori për t'u përgjigjur individualisht. Anketimet u sqaruan në Konferencën IV dhe V të NEZI-t (maj dhe nëntor 2015); Në të dyja konferencat iu dha kohë diskutimeve dhe diskutime të para.

Në anketimet për t'u përgjigjur për grupet e vendeve (të cilat u paraqitën dhe u diskutuan në konferencën e fundit në nëntor 2015), pyetjet ishin përkatësisht:

Pyetja 2

Çfarë mund / duhet të thellohej [nga bashkëpunimi në NEZI]?

Pyetja 3

Si mund të bëhet kjo konkretisht?

Një pasqyrë e përgjigjeve gjendet në vëllimin I, DOK, fq. 75ff; për përgjigjet në veçanti, shih ebd., fq. 191ff.

Pyetjet lidhur me vazhdimin e mundshëm në anketim individual (që në të njëjtën kohë përfshinin vlerësimin përmbyllës individual të bashkëpunimit në NEZI) ishin:

Pyetja 4

Nëse NEZI do të gjente një vazhdim: Cilat do të ishin dëshirat e mia përsa i përket drejtimin të këtij vazhdimi?

Pyetja 5

Nëse NEZI do të gjejë një vazhdim: Cilat janë propozimet e mia konkrete për këtë vazhdim dhe çfarë mund të kontribuojë në këto projekte?

Për këtë, shih vëllimin DOK, fq. 71ff. (vështrim, përmbledhje) i përgjigjet 191ff. (Përgjigjet në detaje).

Diskutimet gjatë Konferencës së katërt dhe të pestë, si dhe përfundimet e të dy intervistimeve, dëshmuar për nivel të lartë të angazhimit dhe të interesit të pjesëmarrësve, përsa i përket bashkëpunimit të mëtejshëm në kontekstin e projekteve vijuese më të vogla të fokusuar tematikisht.

Meqë ndërkohë (nëntor 2015) ekzistonte mundësia e financimit së paku të shpenzimeve materiale, Rolf Gollob (si përgjegjës për fazën e projekteve në vijim) mundi t'u hapte pjesëmarrësve dritën jeshile për këtë gjë. Përveç sqarimeve të hollësishme për objektivat, pikat kyçe përmbajtësore dhe kushtet e përgjithshme të projekteve vijuese (të paktën ekipet bikombëtare, kufizimi i afatit deri në një vit, specifikimet për raportin përfundimtar etj.), pjesëmarrësit e interesuar morën një formular të inputit, në të cilin ishin paraqitur në mënyrë të detajuar projektet e parashikuara sipas rubrikave të mëposhtme: Titulli i Projektit / Përgjegjësit e Projektit (përgjegjësit kryesorë) / partnerët pjesëmarrës / objektivat / produktet e parashikuara / lidhjet me objektivat e Projektit NEZI / orari / informacionet shtesë / pasqyra financiare / mbështetja e kërkuar.

Formularët duhet të dorëzoheshin deri më 30 janar 2016. Deri në fund të shkurtit, përzgjedhja ishte bërë (pjesërisht pas rishikimit të inputit të parë). Në sajë të udhëzimeve të qarta dhe direktivave, nuk u paraqitën skica të projekteve që nuk ishin në përputhje me qëllimet e ndjekura. Të gjitha kërkesat mundën të miratohen. Puna aktuale në ekipet dy- ose shumëkombëshe filloi në mars 2016; Raportet përmbyllëse janë përmbledhur në këtë vëllim dhe këto duhet të dorëzoheshin deri më 31 mars 2017. Për të përgatitur raportet opo kapitujt e pjesshëm, të cilët duhet t'i përfshijnë ato, pjesëmarrësit morën të dhëna të detajuara (shih më poshtë); Kjo në kuptimin e uniformitetit dhe krahasues-

shmërisë më të mirë. Gjatë gjithë fazës së punës, drejtimi i Projektit ishte sigurisht në dispozicion për t'iu përgjigjur pyetjeve.

Në total u angazhuan 20 nga 33 pjesëmarrësit në rrjetin NEZI, në dhjetë projektet vijuese dhe për zbatim (pjesërisht në dy ose tri projekte), këtu u futën edhe tetë persona të tjerë për projekte individuale. Nga pjesëmarrësit e NEZI-t, të cilët nuk mundën të merrnin pjesë në projektet vijuese, shumë prej tyre sqaruan se u vinte shumë keq, por që për fat të keq nuk kishin ndonjë mundësi në kohë.

Projektet në një shikim

Dhjetë projektet vijuese dhe për zbatim mund të përmbliidhen në tri grupe (në kllapa respektivisht të dhënat e ekipeve të vendit pjesëmarrës)

a **Projekte konkrete për zbatim në fushën e formimit për demokraci, të të Drejtave të Njeriut dhe të diversitetit (projektet 1 – 5 në këtë vëllim).**

Këtu përfshihen javët dhe ditët e studimit si edhe aktivitete të ngjashme (akademi, udhëtime studimi, takime shkëmbimi) të kryera në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri dhe Zvicër; si edhe programin e hollësishëm të një «shkolle verore» rajonale të planifikuar për vitin 2018 si edhe një broshurë të hartuar për këtë qëllim.

Projektet përkatëse janë veçanërisht të lidhura ngushtë me objektivin e rrjetit NEZI të përmendur më lartë nën b), të cilat realizojnë kërkesat e një edukimi dhe trajnimit të bazuar në vlerat e demokracisë, të edukimit qytetar dhe të të Drejtave të Njeriut. Ata e bëjnë këtë në formën e aktiviteteve konkrete për edukim dhe trajnim, me të cilat në të gjitha vendet pjesëmarrëse mund të arrihet një numër më i madh mësuesish, nxënësish dhe aktorësh të tjerë nga fusha e arsimit. Kështu këto projekte japin një kontribut të çmuar në qëndrueshmërinë dhe zbatimin e shqetësimeve kryesore të NEZI-t. Kjo kategori përfshin projektet e mëposhtme:

:

- Akademia për demokraci dhe të Drejtat e Njeriut në Kosovë (KOS, CH, Norvegji [si i ftuar'])
- Vlerat demokratike në edukim dhe zbatimin e tyre në shoqëri (Maqedoni, Kosovë, Shqipëri)
- Java e studimeve për temën «Diversiteti në fushën e probleme të shkollës, të familjes dhe të kolegëve si sfida për punën sociale» (KOS, CH)

- Demokracia në praktikë. Projekti pilot për implementimin e Ëëbsites ëëë. living-democracy.al për Shqipërinë, Maqedoninë (AL, MAK, CH)
- Shkolla verore rajonale në fushën e edukimit (AL, KOS, MAK, CH).

b Projekte për zhvillimin dhe forcimin e strukturave ndihmëse (projektet 6 – 7 në këtë vëllim).

Kjo kategori përbëhet nga dy projekte, të cilat në një formë shumë të ndryshme kanë si qëllim një kontribut të dobishëm në të ardhmen në zbatimin të shqetësimeve të rëndësishme të rrjetit NEZI. Këtu bëhet fjalë për një partneritet universitar midis PH Zug dhe Universitetit 'Kadri Zeka' në Gjilan, i cili ofron një bazë të mirë për bashkëpunim të mëtijshëm në fushën tematike. Projekti i dytë ka të bëjë me një dokumentacion gjithëpërfshirës me video për mësimin shqip të gjuhës së prejardhjes (MGJP), roli i të cilit në orientimin midis kulturës së parë dhe të dytë qëndronte në qendër të konferencës së katërt të NEZI-t. Regjistrimet me video, skenarët e trajnimit etj. u ofrojnë shërbime të vlefshme drejtuesve të kurseve në kontekstin e MGJP-së.

- Ngritja e një partneriteti ndërkombëtar për shkollat e larta (IPATE) (CH, KOS, AL)
- Dokumentimi me video për mësimin shqip të gjuhës së prejardhjes (MGJP) në katër vende (CH, KOS)

c Projekte hulumtuese në fushën e bikulturalitetit (projektet 8 – 10, në këtë vëllim)

Në këtë grup janë tri projekte, të cilat nuk përqendrohen në zbatimin dhe implementimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, por më shumë në informacione në sfond mbi aspektet relevante të NEZI-t. Për këtë gjë në qendër është fusha e synuar e Rrjetit, përmendur më lartë nën a), domethënë orientimin midis kulturës së parë, të dytë dhe të ndërkulturës. Në një rast të orientuar më shumë sociologo-socialpsikologjik, kjo bëhet duke parë konceptet «identiteti kombëtar», «identiteti fetar», më tej mbi të gjitha, në lidhje me pyetjet përkthyes që kanë të bëjnë me një funksion ndërlidhës midis kulturave. Studimi i orientuar nga etnologjia për «Schatzis» i Nuhi Gashit trajton një anë interesante të kontaktit midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, një grup miqsh me origjinë shqiptare të ardhur për pushime, që nuk shihen mirë në Kosovë.

- Të rinj me origjinë shqiptare midis identitetit kombëtar dhe fetar (KOS, MAK)
- Fenomeni i («Shaca») i vështruar nga shumë perspektiva (KOS, CH)
- «Përkthimi është kulturë» (CH, KOS)

Siç ishte rasti edhe për raportet dhe vlerësimet e fazës së parë të Rrjetit (shih vëllimi I, DOK), pjesëmarrësit në projektet vijuese dhe për zbatim morën gjithashtu udhëzime të qarta për raportet përmbyllëse; nga ana tjetër, në lidhje kjo me qëndrueshmërinë dhe krahasueshmërinë. Secila prej raporteve që do të hartohet në 7 – 10 faqe, duhet të përmbante pjesët në vijim:

1. Të dhëna të shkurtra për titullin, bashkëpunëtorët, qëllimet, referenca me NEZI-n, orari dhe nevojat për buxhet e Projektit,
2. Përshkrimi i pyetjeve dhe përfundimeve të Projektit,
3. Pyetjet e hapura në lidhje me Projektin, qasje për hulumtime të mëtejshme,
4. Përshkrimi i procesit të punës gjatë periudhës së Projektit; përvojat me bashkëpunimin dy- ose shumëkombësh,
5. Rekomandime për faza të ngjashme të thellimit dhe të konsolidimit në vazhdim, me projekte shumëkombëshe.

Rishikim

(Shih gjithashtu rekomandimet në vëllimin I DOK pas fazës së parë të NEZI-t.)

Duke u kthyer pas në fazën e dytë të Projektit NEZI, i cili fillimisht nuk ishte planifikuar në këtë formë, mund të thuhet se ky është një sukses në aspekte të ndryshme. Objektivat e mëposhtëm janë arritur ose thelluar nëpërmjet tij:

-
- a Qëndrueshmëria:** Puna në projektet vijuese nënkuptonte njëkohësisht punë të mëtejshme për objektivat kryesore të NEZI-t (referenca për këto duhej të jepen në shënimet e Projektit dhe ishte një nga parakushtet për miratim). Në lidhje me dy fushat si objektivat të NEZI-t (orientimi midis kulturës së parë, të dytë dhe ndërkulturës, zbatimi i kërkesave të EQD / EDN), u realizuan projekte të cilat janë ose shembuj të mirë të zbatimit të suksesshëm, ose punë e vlefshme në sfond dhe hulumtim bazë. Të dyja mund të shihen si një demonstrim i suksesshëm i qëndrueshmërisë së dëshiruar.
-
- b Bashkëpunimi ndërmjet kufijve kombëtarë dhe gjuhësorë:** Një objektivat i mëtejshëm i NEZI-it - rrjetëzimi i ekspertëve nga tri vendet shqipfolëse midis tyre dhe atyre nga Zvicra, mund të konsiderohet si optimal. Formimi i ekepeve dy- ose shumëkombëshe ishte një nga parakushtet për miratimin e pjesëve të projekteve. Kjo ka thelluar bashkëpunimin e krijuar tashmë në kuadrin e pesë konferencave të NEZI-t dhe punën në mes të konferencave. Kjo është kënaqësi jo vetëm në lidhje me bash-

këpunimin dhe kontaktet midis Zvicrës, Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë, por edhe të atyre midis tri vendeve të përmendura më sipër. NEZI dhe projektet vijuese mundën të kontribuojnë në rrjetëzimin më të mirë dhe në njohjen e ndërsjellë, i cili pa dyshim do të përdoret edhe në projekte të tjera të pavarura nga NEZI.

- c Diseminim përhapje e rezultateve:** Në mënyrë të veçantë, projektet e kategorisë «zbatimi konkret në fushën e edukimit demokratik, të Drejtave të Njeriut dhe të diversitetit» kontribuan dhe kontribuojnë dukshëm në një shpërndarje më të gjerë dhe në njohuri të objektivave të Rrjetit, veçanërisht në fushën e EQD / EDNJ. Me aktivitetet e ndërmarra në këto projekte, një grup më i madh aktorësh nga fusha e shkollës mundi të adresohet, të zhvillohet dhe të sensibilizohet. Se kjo gjithashtu ka një efekt multiplikator, është e dukshme.

Përmes botimeve, prezantimeve dhe debateve në një shkallë më të gjerë edhe përfundimeve të shumicës së projekteve të tjera, u bënë të disponueshme për një audiencë të gjerë. Mund të përmendim si një shembull dy tryezat e rrumbullakëta, të organizuara nga Projekti i Nuhi Gashit «Schatzis» në Prishtinë dhe Vjenë, konferencën në Lozanë për Projektin e Driton Kajtazit dhe publikimin «Përkthimi është kultura» ose prezantime për dokumentimin me video të MGJP-së i Basil Schader në Cyrih, Prishtinë dhe Kamen afër Këlnit

Edhe pse cilësia dhe përpunimi i raporteve individuale ndryshojnë, projektet e dokumentuara në to tregojnë një angazhim të madh, pjesërisht mbimesatar dhe përdorim të mirë të kontakteve dhe sinergjive që rezultojnë nga përbërja dy- ose shumëkombëshe e grupeve.

Vështrime, propozime për projekte të ngjashme

Përsa u përket rrjeteve të ngjashme ose projekteve të krahasueshme të bashkëpunimit, dalin rekomandimet e mëposhtme nga përvoja e fituar në NEZI:

- Sistemi dyfazor ka provuar veten shumë mirë dhe mund të rekomandohet pa rezervë. Kjo çon në një shpengim shumë efikas të qëllimeve të tilla si qëndrueshmëria, bashkëpunimi dhe shpërndarja, siç kjo është e mundur vetëm në një realizim njëfazor.
- Aktivitetet në vijim dhe për zbatim duhet të merren parasysh gjatë planifikimit të tërë Projektit (të llogariten për një mundësi buxheti). Në rastin e NEZI-t, ky nuk ishte rasti; financimi i aktiviteteve vijuese mundi të sigurohet me anë të një trajtimi shumë të kujdesshëm të fondeve gjatë fazës së parë të Projektit.
- Përbërja dy- apo shumëkombëtare e ekipit (si kusht për mbështetjen e një projekti të mëvonshëm), është një aspekt thelbësor nëse kihet si qëllim thellimi gjithëpërfshirës gjuhësor i vendeve, i kulturës, si edhe konsolidimi i objektivave të Projektit kornizë.
- Të provuara dhe të rekomanduara janë udhëzime dhe kritere shumë të qarta për pjesëmarrje në projektet vijuese dhe për raportet përmbyllëse. Nga përmbajtja direktiva të qarta (Lidhje me projektin e saj mëmë ose në aspekte të caktuara të tyre), po ashtu direktiva të qarta për rendin e ditës dhe raportet përmbyllëse (vëllimi, struktura ose nënkapituj), lehtësojnë punën në shumë mënyra dhe ndihmojnë në parandalimin e keqkuptimeve dhe të daljeve bosh, pa kufizuar krijimtarinë e pjesëmarrësve.
- Një hap shumë i dëshiruar për zgjerim, do të ishte organizimi i një konference finale dy deri në tri ditë, ku mund të paraqiteshin dhe të diskutoheshin projektet vijuese individuale; Kjo sërish në kuptimin e konsolidimit, zbatimit dhe qëndrueshmërisë. Tek NEZI duhet të hiqej dorë nga ky hap (i cili duhej të ishte planifikuar që në fillimi dhe të buxhetohej).

Per formën e tekstit

Ky vëllim botohet si vëllimi I i DOK në versionin gjermanisht dhe shqip. Këto përkthime të kërkuara të shtatë artikujve origjinalë nga shqipja në gjermanisht dhe të tri kontributeve nga gjermanishtja në gjuhën shqipe, u bënë nga Prof. Dr. Brikena Kadzadej, drejtuese e departamentin të gjuhës gjermane në Universitetin e Tiranës. Meqenëse përgjegjësia për formën gjuhësore dhe cilësinë e artikujve origjinale qëndron tek autorët, këto tekste janë redaktuar minimalisht (dy klikimet bosh etj.). E njëjta gjë vlen edhe për përkthimet nga gjuha shqipe në atë gjermane. Nga ana tjetër, përkthimet e teksteve shqip në gjermanisht iu nënshtroan një redaktimi final pjesërisht të thellë, për të siguruar lexueshmërinë dhe kuptueshmërinë në gjuhën gjermane.



Raportet përmbyllëse të projekteve për thel- lim dhe implementim

Projekte konkrete për zbatim në fushën
e formimit për demokraci, të të Drejtave
të Njeriut dhe të diversitetit

1 Akademia e Kosovës për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesja i Projektit (Përgjegjësja kryesore):

- Melinda Mula, KEC, Kosovë

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Kosova:

- Melinda Mula, Menaxhere e programeve në KEC
- Veton Sylhasi, Bashkëpunëtor profesional në KEC
- Arbër Salihu, zyrtar në MASHT; zyrtar në Divizionin për Planprograme dhe Tekste Shkollore në MASHT
- Ekipet e 11 shkollave fillore, të mesme të ulta dhe të të mesme të larta nga 9 komuna të Kosovës

Zvicra:

- Rolf Gollob, zyrtar në PH Cyrih/IPE

Norvegjia:

- Caroline Gebara, zyrtare në European Eërgeland Center (EëC)

Buxheti:

- Fr. 20'000.-

Qëllimet e Projektit

Shoqëritë demokratike dhe paqja mund të ndërtohen vetëm nga qytetarët që posedojnë shkathtësi, qëndrime dhe vlera demokratike. Sot, si kurrë më parë, demokracia në shumë vende të Evropës është vënë në rrezik e sfidohet nga konfliktet dhe dhuna, nga racizmi, diskriminimi, ksenofobia dhe korrupsioni. Edukimi mund të jetë një vegël shumë e fuqishme për të adresuar këto sfida. Në të vërtetë, edukimi e ka rolin kyç në promovimin e respektit për të drejtat e njeriut, demokracisë dhe respektimin e ligjit si dhe në përgatitjen e të rinjve për një jetë aktive në shoqëritë demokratike.

Karta e Këshillit të Evropës për EQD/EDNj, e miratuar me rekomandimin CM/Rec(2010), e promovon EQD/EDNj si mënyrën parësore për «të pajisur nxënësit me njohuri, shkathtësi e vlera, dhe për të zhvilluar qëndrimet dhe sjelljet e tyre», në mënyrë që ata të promovojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Përveç mësimdhënësve, që qartazi luajnë një rol parësor këtu, Karta pranon rolin e palëve tjera në sistemin e edukimit dhe në komunitet, për të bashkuar përpjekjet drejt krijimit të institucioneve demokratike.

Akademia e Kosovës është një mundësi e re për ofrimin e trajnimeve në fushën e EDDNj dhe ka për qëllim forcimin e kulturës demokratike në shkollat e Kosovës duke trajnuar punëtorët e arsimit dhe aktorët komunitarë, si dhe duke zhvilluar më tej kapacitetin e tyre për ta zbatuar dhe promovuar EQD/EDNj në shkollat dhe komunitetet e tyre.

Në Akademinë e Kosovës për EDDNj të organizuar gjatë vitit 2016 kanë marrë pjesë 11 ekipe shkollore nga 9 komuna të Kosovës. Procedura për përzgjedhjen e shkollave pjesëmarrëse ka qenë:

- Publikimi i thirrjes për aplikim të shkollave të interesuara për të marrë pjesë në Akademi,
- Plotësimi i aplikacioneve ku shënon qartë qëllimi i shkollës për të marrë pjesë në akademi dhe një ide se si mund t'i kontribuojnë me aktivitetet e tyre EDDNj
- Shqyrtimi i aplikacioneve shkollore nga Këshilli Drejtues i Projektit dhe përzgjedhja e shkollave përfituese
- Njoftimi i shkollave përfituese për pjesëmarrje në trajnim.

Shkollat përfituese kanë marrë pjesë në trajnimin 5 ditorë të organizuar nga 6 – 10 dhjetor 2016 dhe më pas kanë hartuar projekte 4-mujore për zbatim të njohurive të fituara nga trajnimi në shkollat e tyre.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

Projekti Akademia e Kosovës për Eduktimin për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut është në lidhje të ngushtë me njërën nga dy pikat kyqe të Projektit NEZI, siç është Edukimi për qytetari demokratike. Organizimi dhe mbajtja e kësaj Akademie i kontribuon arritjes së qëllimit të projektit NEZI që përmes «bashkëpunimit ndërkombëtar në rrjet të fitohen njohuri të reja, të bazuara shkencarisht, për tematikën e të rriturit brenda dhe midis sistemeve të ndryshme të normave e të referimit, si dhe diskutimi dhe reflektimi i përfundimeve përkatëse në fokusin e edukimit politik dhe demokratik» (shih përshkrimin e projektit NEZI, faqe 1). Po ashtu Akademia i kontribuon projektit NEZI për të promovuar idetë, materialet dhe qasjen e «Këshillit të Evropës lidhur me Edukimin për Demokracinë dhe për të Drejtat e Njeriut (EQD/EDNj) si temë me rendësi të veçantë për Këshillin e Evropës» (po aty).

Mbajtja e Akademisë ka për qëllim aftësimin e strukturave shkollore me njohuri dhe praktika të mira për EQD/EDNj, gjë e cila është në përputhje të plotë me propozimin e «Sekretariati Shtetëror Zviceran për Arsim, Hulumtim dhe Inovacion të bërë qendrës IPE te PH Zürich për formimin e grupeve të ekspertëve që ndihmojnë në a) shkëmbimin e përvojave dhe të njohurive shkencore dhe b) në fitimin e njohurive të reja» (faqja 2). Bashkëpunimi ndërmjet ekspertëve mundëson «shkëmbimin e njohurive shkencore dhe të përvojave, si dhe të kualifikimit të mëtejshëm të ndërsjellë në fushën e edukimit për demokraci». Një gjë e tillë kontribuon edhe në arritjen e pikës së parë kyqe të projektit NEZI që ka të bëjë me sjelljen dhe integrimin e emigrantëve dhe të rrimigruarve në shoqëritë e ndryshme, sepse një «rol të rëndësishëm në integrim luajnë konceptet e lidhura me pjesëmarrje, bashkëvendim, barazi dhe sjellje demokratike p.sh. në kontekstet familjare ose shkollore, në të cilat duhet të orientohen fëmijë dhe të rinj/të reja të emigruara ose të rrimigruara, por edhe anëtarë të pakicave etnike ose fetare» (faqja 3).

Në veçanti Akademia E Kosovës për EDDNj ka shërbyer si aktivitet vijues për përmbushjen e qëllimeve dhe objektivave të Konferencës së dytë dhe të tretë:

Konferenca e dytë e organizuar më 8 dhe 9 maj 2014 me titull «Përvoja me koncepte të ndryshme të demokracisë dhe të pjesëmarrjes në kulturën e parë dhe në kulturën e dytën, si dhe sjellja në mjedise interkulturore».

Konferenca e tretë e organizuar më 6 dhe 7 nëntor 2014 në Maqedoni me temën «Sjellja jonë me temën edukim për demokraci: Çka është arritur, modele të provuara, perspektiva? Çka mungon akoma? Propozime dhe dëshira për përmirësime, mundësi për t'i realizuar ato».

Plani kohor, agjenda

Projekti është realizuar në tri faza.

I Faza përgatitore, 30 qershor – 30 nëntor 2016

Aktivitetet kryesore që janë realizuar gjatë kësaj faze kanë qenë hartimi i konceptit të Akademisë, përzgjedhja e shkollave përfituese dhe përgatitja e logistikës për mbajtjen e Akademisë.

Ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë dhe vendorë kanë hartuar konceptin e Akademisë së Kosovës për EDDNj 2016, kriteret për aplikim, formën e aplikimit dhe kanë publikuar thirrjen për aplikim për të gjitha shkollat e interesuara për të marrë pjesë në këtë Akademi. Gjatë kësaj kohe janë hartuar dhe materialet e nevojshme për akreditim të programit të trajnimit nga Këshilli Shtetëror për Licensimin e Mësimdhënësve (KShLM).

Koordinatorja e projektit ka bërë grumbullimin e formave të aplikimeve që kanë dërguar shkollat dhe të dhënat i ka paraqitur në databazë të projektit. Më pas, Këshilli Drejtues i Projektit ka bërë analizën e 54 aplikimeve shkollore dhe ka përzgjedhur 11 shkollat përfituese nga 9 komuna të Kosovës. Shkollat e përzgjedhura janë njoftuar për kohën e mbajtjes së Akademisë. Në vazhdim është hartuar agjenda dhe përshkrimi i detajuar i seancave të trajnimit, përcaktimi i trajnerëve për secilën seancë, si dhe janë identifikuar materialet e nevojshme për realizim të seancave. Po ashtu është siguruar lokacioni për mbajtjen e Akademisë dhe sistemimi i dhomave për pjesëmarrësve gjatë vijimit të saj.

II Faza e dytë: mbajtja e Akademisë dhe finalizimi i projekteve shkollore 1 – 30 dhjetor 2016

Aktiviteti kryesor gjatë fazës së dytë ka qenë mbajtja e Akademisë për EDDNj nga 6-10 dhjetor 2016 në hotel «Sharri» në Prevallë. Në trajnimin 5-ditorë morën pjesë 33 përfaqësues të 11 shkollave të përzgjedhura. Seancat e trajnimit janë mbajtur nga Prof. Dr. Rolf Gollub, ekspert ndërkombëtarë, z. Arbër Salihu, koordinator i Kosovës për EQD/EDNj, si dhe trajnerët e certifikuar të programit z. Veton Sylhasi, z. Petrit Tahiri dhe znj. Arberie Nagavci. Po ashtu i angazhuar ka qenë edhe Z. Valon Hoxha, në kapacitet të trajnerit ndihmës dhe si pjesë e strategjisë për zhvillimin e kapaciteteve trajnuese të programit Seminari është realizuar duke u bazuar në parimin e pjesëmarrjes aktive, pra të bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet tajnerëve dhe pjesëmarrësve. Pjesëmarrësit kanë reflektuar lidhur me situatën aktuale që ekziston në shkollën dhe komunitetin e tyre nga aspekti i zbatimit dhe respektimit të parimeve të EQD/EDNj. Më tej, ata kanë identifikuar fushën/fushat në të cilat mund të intervenojnë me qëllim të përmirësimit të situatës aktuale. Për të dhënë shembuj të suksesshëm të iniciativave të tilla, para pjesëmarrësve kanë prezantuar sukseset në zbatimin e projekteve të tyre, 2 ekipe shkollore që kanë vijuar Akademinë e vitit 2015.

Bazuar në informacionet e grumbulluara gjatë Akademisë, si dhe të mbështetur nga trajnerët, secili ekip shkollor ka zhvilluar një draft të planit të veprimit ku kanë identifikuar aktivitetet të cilat do të kontribuonin në kultivimin e kulturës demokratike në shkollat e tyre. Gjatë periudhës 11 – 30 dhjetor 2017, shkollat janë mbështetur nga trajnerët për të finalizuar projektet e tyre.

III Zbatimi i projekteve në shkollat përfituese, janar – prill 2017

Të gjitha shkollat pjesëmarrëse në Akademi kanë filluar zbatimin e projekteve shkollore varësisht nga nevojat e tyre për fuqizim të udhëheqjes demokratike, zbatim të parimeve të demokracisë në kurrikulën e lëndëve të caktuara apo ndërtim të raporteve bashkëpunuese me komunitetin. Një takim përcjellës është mbajtur më 11 mars 2017 në lokalet e KEC. Gjatë këtij takimi ekipet shkollore kanë bërë shkëmbimin e përvojave në realizimin e aktiviteteve të projekteve shkollore, si dhe kanë identifikuar iniciativat e përbashkëta, të cilat mund të organizohen për rritur shkallën e efikasitetit dhe sensibilizimit të opinionin shkollor lidhur me parimet e EQD/EDNj.

Shkollat do të vazhdojnë zbatimin e projekteve shkollore dhe do t'i përmbyllin ato përmes raporteve shkollore, deri më 10 maj 2017. Më 15 maj 2017 do të dorëzohet raporti përfundimtar për realizimin e të gjitha aktiviteteve në kuadër të Akademisë së Kosovës për EDDNj për 2016.

Pjesa 2: Përshkrimi i çështjeve hulumtuese të projektit dhe rezultateve të tij

Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT), Këshillin e Evropës (CoE) dhe Qendrën Evropiane Ëergeland (EËC) që nga vitit 2015 kanë filluar organizimin e Akademisë së Kosovës për Edukimin për Demokracinë dhe për të Drejtat e Njeriut (EDDNj). Kjo Akademi ka për qëllim trajnimin e ekipeve shkollore në fushën e Edukimit për Qytetari Demokratike dhe Edukimit për të Drejtat e Njeriut, të bazuara në programin e Këshillit të Evropës «Të mësuarit e demokracisë dhe të drejtave të njeriut». Kjo Akademi bazohet në modelin e Akademive regjionale për EQD/EDNj që organizohen nga Këshilli i Evropës në Mal të Zi dhe në Poloni.

Në kuadër të Akademisë ofrohet trajnim i ekipeve me nga tre anëtarë që përfaqësojnë shkollat pjesëmarrëse. Ekipet përbëhen nga dy përfaqësuesve të shkollës, përfshirë drejtorin apo zëvendësdrejtorin dhe një mësimdhënës, së bashku me një përfaqësues të shoqatës së prindërve apo një OJQ-je që bashkëpunon me shkollën.

Trajnimi ndjek qasjen tërëshkollore në EDDNj, e cila adreson sfera të ndryshme të jetës shkollore, si: procesin e mësimdhënies dhe të nxënies, qeverisjen shkollore, përfshirjen e komunitetit dhe ndërtimin e partneriteteve. Kjo qasje inkurajon pjesëmarrjen akti-

ve të të gjitha palëve të shkollës në ndërtimin e një mjedisi ku parimet e të drejtave të njeriut dhe demokracisë mund të mësohen dhe të praktikohen. Programi i bazuar në qasjen tërëshkolllore është ndërmarrje inovative në Kosovë, sepse deri tash programet e trajnimit janë organizuar kryesisht duke trajtuar çështje që fokusohen vetëm te elementet e caktuara, si p.sh: programet për udhëheqje arsimore janë fokusuar vetëm te udhëheqja e shkollës edhe pse në trajnim kanë marrë pjesë drejtorë dhe mësime të shkollave.

Trajnimi bazohet në materialet e Këshillit të Evropës, si: Karta e Këshillit të Evropës për EQD/EDNJ, Qeverisja demokratike e shkollave, volumet «Të jetuarit e demokracisë», si dhe manualët Compass-i dhe Compasito, të cilat janë të fokusuara në edukimin për të drejtat e njeriut për të rinj dhe fëmijë. Shfrytëzimi i këtyre materialeve është propozuar dhe nga projekti NEZI, i cili ka kontribuar në hartimin e disa prej tyre.

Megjithatë zhvillimi i kompetencës së qytetarisë është pjesë e kornizës së re kurrikulare të Kosovës, atëherë MASHT e ka konsideruar me interes organizimin e Akademisë për EDDNJ dhe ka bërë akreditimin e këtij programi. Akreditimi i programit bën që mësime të përfshihen në Akademi të shfrytëzojnë certifikatat me rastin e licensimit të tyre. Një gjë e tillë do të ndihmojë KEC që në partneritet me MASHT dhe donatorë të ndryshëm të organizojë Akademinë në baza vjetore.

Akademia e Kosovës për EDDNJ synon aftësimin e mësime të ndryshme, udhëheqjes dhe komunitetit të shkollave për përfshirjen e parimeve të demokracisë dhe të drejtave të njeriut në procesin mësimor, në ndërtimin e një kulture demokratike në qeverisjen e shkollave, si dhe në organizimin e aktivitetëve të ndryshme extra-kurrikulare që i kontribuojnë përgatitjes së nxënësve si qytetarë aktivë dhe të përgjegjshëm në ndërtimin e shoqërive të hapura dhe demokratike.

Pyetjet qëndrore që inicuan hartimin dhe realizimin e Projektit «Akademia e Kosovës për Demokracinë dhe të Drejtat e Njeriut» ishin:

1. Si mund të realizohet qeverisja demokratike e shkollave, e cila do të mundësonte përfshirjen e të gjitha palëve me interes në planifikimin, realizimin, monitorimin dhe raportimin e aktivitetëve shkollorë me theks të veçantë në fushën e edukimit për demokraci dhe të drejtat e njeriut?
2. Si mund të integrohen parimet e demokracisë dhe të drejtave të njeriut në kurrikulën e fushave lëndore, si dhe në zhvillimin e një ambienti miqësor që inkurajon pjesëmarrjen aktive të nxënësve në procesin mësimor?
3. Çfarë kontributi mund të japin prindërit, komuniteti, OJQ-të dhe organizatat e tjera në organizimin dhe realizimin e aktivitetëve të ndryshme, të cilat do të ndikojnë në përgatitjen e nxënësve si qytetarë të përgjegjshëm të një shoqërie demokratike?
4. Cilat aktivitete mund të realizojë shkolla për kultivimin e një fryme demokratike lidhur me organizimin dhe realizimin e aktivitetëve të ndryshme në shkollë dhe aktivitete jashtë-shkollorë?

Këto pyetje orientuan hartimin e programit të Akademisë për vitin 2016. Përvoja e fituar gjatë mbajtjes së Akademisë së vitit 2015, si dhe gjatë realizimit të aktiviteteve të ndryshme të shkollave përfituese që vijuan atë, bënë që planifikimi 5 ditor i aktiviteteve të Akademisë për vitin 2016 të jetë kombinim i natyrshëm i seancave teorike dhe praktike të tri fushave kryesore, si: të qeverisjes demokratike të shkollave, të aftësimit të mësimdhënësve për përfshirje të parimeve në kurrikulën e tyre lëndore dhe në ndërtimin e partneriteve të frytshme të shkollës me komunitetin.

Rezultatet e arritura

Publikimi i thirrjes për aplikim ka ndikuar që shkollat të fillojnë të reflektojnë për situatën që ekziston në shkollat e tyre lidhur me zbatimin e elementeve që karakterizojnë edukimin për qytetari demokratike. 54 shkolla të interesuara për të marrë pjesë në Akademi kanë shënuar në formën e aplikimit të tyre sfidat me të cilat ballafaqohen lidhur me demokracinë në shkollë, dhe aktivitetet e mundshme që mund të realizojnë dhe të cilat do të kontribuonin në demokratizimin e shkollës. Kjo ka ndikuar në sensibilizimin e shkollave lidhur me nevojat e tyre për ndërtim të kapaciteteve për EDDNj. Këshilli drejtues i projektit ka bërë analizën e të gjitha aplikacioneve shkollore. Përkundër faktit që shumica nga shkollat që kanë aplikuar i kanë plotësuar kriteret, për shkak të kufizimeve, Këshilli ka përzgjedhur vetëm 11 shkolla përfituese për të marrë pjesë në Akademi.

Në kuadër të projektit Akademia e Kosovës për EDNj janë arritur disa rezultate:

1. Hartimi i një programi trajnues për EDDNj

Programi për EDDNj është hartuar përmes bashkëpunimit të ekspertëve ndërkombëtarë dhe atyre vendorë. Përvoja nga zbatimi i projekteve të ngjashme në vendet e tjera ka bërë që ekspertët ndërkombëtarë të sugjerojnë kornizën e realizimit të programit, ndërsa ekspertët vendorë janë kujdesur që përmbatjet e seancave të jenë në harmoni me kërkesat e kornizës kurrikule dhe mundësive për zbatim në kontekstin e Kosovës. Programi i hartuar ka përfshirë seanca teorike dhe praktike që kanë adresuar çështje me interes për drejtorët e shkollave, mësimdhënësit, prindërit dhe komunitetin e shkollës. Në këtë mënyrë programi është përgatitur që të ofrojë informata dhe shembuj për të dhënë përgjigje në katër pyetjet mbi bazën e të cilave është hartuar projekti. Cilësia e programit të përgatitur, si dhe nevoja për aftësim të strukturave shkollore dhe përfaqësuesve të komunitetit lidhur me EDDNj ka bërë që ky program të akreditohet nga Këshilli Shtetëror për Licencim të Mësimdhënësve (KShLM) dhe të shërbejë si program trajnimi, të cilin mësimdhënësit mund ta shfrytëzojnë me rastin e licensimit të tyre. Programi ofron 60 orë trajnim që paraqet më shumë se gjysmën e orëve të nevojshme për të përhirë licencën apo për t'u promovuar në nivel më të lartë të zhvillimit të tyre profesional.

2. Ndërtimi i kapaciteteve të 11 shkollave për planifikim dhe zbatim të projekteve shkollore që kanë të bëjnë me EDDNj

Pyetjet e hartuara për realizim të projektit si dhe hartimi i programit të trajnimit kanë lehtësuar jashtëzakonisht shumë organizimin e ditëve dhe seancave brenda seminarit trajnues. Kështu në ditën e parë janë mbajtur seancat të cilat kanë pasur për qëllim krijimin e një klime të përshtatshme pune brenda ekipeve shkollore, prezantimin e qëllimeve dhe objektivave të Akademisë, si dhe shtjellimin e kornizës dhe koncepteve kyçe të EQD/EDNj.

Gjatë ditës së dytë, trajnerët ndihmuan shkollat për të bërë një analizë të gjendjes së në raport me fushat e kulturës demokratike në shkollë dhe të identifikojnë fushën/fushat ku planifikojnë të përmirësojnë gjendjen e tyre ekzistuese. Gjatë pasdites u mbajtën tri seanca paralele, njëra më drejtorë të shkollave, e dyta me mësëmdhënës, ndërsa seanca e tretë me përfaqësues të komuniteteve shkollore. Këto seanca kishim për qëllim aftësimin e këtyre strukturave për të shfrytëzuar botimet të materialeve të përgatitura për EDC/EDNj në gjuhë të ndryshme nga Këshilli i Evropës.

Përfitimi i njohurive lidhur me kornizën dhe konceptet e EQD/EDNj, materialet ekzistuese, si dhe identifikimi i fushave për përmirësim krijuan një bazë të përshtatshme për të orientuar bashkëpunimin e trajnerëve dhe pjesëmarrësve drejt përgatitjes së drafteve të projekteve shkollore. Kështu në ditën e tretë u shtjelluan parimet e Kartës së EQD/EDNj, si dhe elementet kryesore të kornizës kurrikulare me theks të veçantë në zhvillimin e kompetencës së qytetarisë që promovon kjo kornizë. Në vazhdim u shtjellua tema udhëheqja demokratike e shkollave, ku u theksua roli që ka udhëheqja e shkollës për krijimin e një klime të përshtatshme për realizimin e aktiviteteve të ndryshme. Në fund të ditës, 2 shkolla që kanë qenë pjesëmarrëse në Akademinë e vitit 2015 prezantuan përvojat e tyre gjatë realizimit të projekteve të tyre shkollore. Këto prezantime kishin për qëllim të motivonin pjesëmarrësit në hartimin dhe realizimin e projekteve të tyre. Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj dite ofruan përgjigje lidhur me temat e përmendura në pyetjen e parë.

Në pjesën e parë të ditës së katërt të seminarit u shtjelluan temat që kishin për qëllim aftësimin e mësëmdhënësve për të përfshirë parimet e EQD/EDNj në kurrikulat lëndore. Kështu u prezantuan modele të mësimit në Letërsi, Matematikë, Mbrojtje të Mjedisit, etj në të cilat ishin përfshirë parimet e EQD/EDNj. Pasdite, pjesëmarrësit përfituan njohuri lidhur me ndërtimin e partneriteteve të fuqishme të shkollës me komunitet dhe OJQ, për të organizuar aktivitete të ndryshme. Aktivitetet e realizuara gjatë kësaj dite ofruan përgjigje lidhur me temat e përmendura në pyetjen e dytë dhe të tretë.

Gjatë ditës së fundit shkollat arritën të përgatisin nga një draft të planit të veprimit me aktivitete të cilat kishin për qëllim zbatimin e njohurive e shkathtësive të fituara në

shkollat e tyre. Këto projekte u prezantuan para të gjithë pjesëmarrësve, për të shikuar nëse ka aktivitete të ngjashme. Në raste kur kishte aktivitete të ngjashme u propozua që shkollat të koordinohen për realizimin e tyre. Gjatë kësaj dite u përmendën shumë aktivitete që shkollat të kishin planifikuar për t'i realizuar në shkollat e tyre.

Gjatë 5 ditëve sa ka zgjatur Akademia, trajnerët në bashkëpunim me pjesëmarrësit kanë dhënë përgjigje në 4 pyetjet që janë hartuar paraprakisht me rastin e hartimit të projektit.

3. Zbatimi i 11 projekteve shkollore me fokus në EDDNj

Që nga fillimi i muajit janar 2017, 11 shkollat pjesmarrëse në Akademi kanë filluar realizimin e projekteve të tyre. Realizimi i projekteve shkollore me qëllim të kultivimit të kulturës demokratike tek palët me interes janë «produkti» kryesor i këtij projekti. Aktivitetet e realizuara në kuadër të shkollave kanë ndikuar jo vetëm në strukturat shkollore, por edhe më gjerë në komunitetet e tyre. Shkollat përfituese janë duke realizuar këto projekte:

Shkolla «Ali Hadri» në Mirash, në Ferizaj është duke promovuar EDDNj përmes përfshirjes së parimeve të saj në kurrikulën shkollore. Mësimdhënësit e kësaj shkolle janë trajnuar si të shfrytëzojnë web faqen e Këshillit të Europës «Të jetuarit e demokracisë- Living Democracy» dhe botimet e publikuara në të.

Gjimnazi «Hajdar Dushi» në Gjakovë është duke promovuar komunikimin dhe të kuptuarit ndërmjet gjeneratave përmes një projekti të udhëhequr nga nxënësit për të përkrahur Shoqatën e Pensionistëve të Gjakovës. Ky projekt përfshin vizitat në shoqatë për vlerësimin e nevojave të pensionistëve, mbledhjen e fondeve për ta përmes organizimit të aktiviteteve artistike, organizimin e ditës në nderim të mësimdhënësve pensionistë, etj.

Shkolla «Zef Lush Marku» në Brekoc, në Gjakovë është duke shfrytëzuar diversitetin në shkollë nga aspekti etnik dhe religjioz për të promovuar «Laboratorin e Demokracisë», si një hapësirë të përbashkët për të diskutuar çështjet që kanë të bëjnë me EDQ /EDNj dhe promovimin e diversitetit etnik dhe kulturor si pasuri.

Shkolla «Ali Kelmendi» në Vushtrri është e fokusuar në integrimin e nxënësve me nevoja të veçanta në klasat e rregullta. Ata janë duke ndërtuar partneritete të cilat mundësojnë që këta fëmijë të vizitojnë institucione të ndryshme me qëllim të inkurajimit të të nxënësve të tyre.

Shkolla «Razim Cokli» në Brod në Shterpce gjendet në një vend të thellë rural. Kjo shkollë është duke promovuar të drejtën shoqërore si një qasje për të adresuar çështjet që kanë të bëjnë me diskriminimin dhe dhunën në shkollë.

Gjimnazi «Frang Bardhi» në Mitrovicë është duke promovuar qasjen e vendimmarrjeve të përbashkëta në shkollë. Kjo shkollë është duke punuar me nxënësit e komuniteteve shqiptare dhe boshnjake për të forcuar Këshillin e nxënësve, si një strukturë efektive për vendimmarrje në shkollë dhe komunitet.

Shkolla «Edit Durham» në Mushtisht në Suharekë është duke forcuar bashkëpunimin në mes të saj dhe komunitetit përmes organizimit të aktiviteteve që sjellin prindërit në shkollë. Njëri nga aktivitetet është «Një ditë ndryshe», në të cilën të gjitha palët angazhohen në aktivitete të përbashkëta.

Shkolla «Skenderbeu» në Perlepnice – Gjilan është duke realizuar projektin «Të bashkuar për qytetari aktive» përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme. Njëri ndër ta është trajnimi i mësimdhënësve për të përfshirë parimet e EQD/EDNj në kurrikulën e fushave të tyre mësimore.

Shkolla «Nazim Hikmet» në Dobërçan – Gjilan, është një shkollë tjetër multi-etnike që po promovon EQD/EDNj përmes kurrikulës dhe aktiviteteve jashtë-shkollore.

Shkolla «Asllan Thaçi» në Karaqevë – Kamenicë, është duke u angazhuar në përhapjen e koncepteve të EQD/EDNj në shkollë dhe jashtë saj. Mësimdhënësit e trajnuar ndihmojnë nxënësit të përfshihen në aktivitete që kanë të bëjnë me zgjidhjen e problemeve në shkollë.

Shkolla «Hasan Prishtina» në Prishtinë është duke e zhvilluar ndjenjën e solidaritetit tek nxënësit e tyre. Ata janë duke zhvilluar një projekt në ndihmë të fëmijëve jetim të SOS fshatit.

Për të prezantuar aktivitetet e shkollave është hapur dhe një grup në rrjetin social Facebook. Prezantimi i sukseseve në punën me mësimdhënës, nxënës dhe komunitet do të forcojë bashkëveprimin e këtyre shkollave, si dhe do të shtojë motivimin e tyre për të organizuar aktivitete të ngjashme.

Si rezultat i zbatimit të projektit:

- Është hartuar një program trajnimi me 60 orë që është i akredituar nga KShLM dhe mësimdhënësit mund ta shfrytëzojnë për licensimin e tyre,
- Janë aftësuar 33 drejtorë shkollash, mësimdhënëës dhe përfaqësues të OJQ dhe komuniteteve shkollore për t'u angazhuar në krijimin e kulturës demokratike në shkollë
- Është forcuar bashkëpunimi ndërmjet MASHT dhe shkollave lidhur me organizimin e aktiviteteve të ndryshme që kanë në fokus zbatimin e parimeve të EQD/EDNj në udhëheqje dhe mësimdhënie
- Drejtorët dhe mësimdhënësit e këtyre shkollave kanë filluar të shfrytëzojnë në procesin mësimor materialet e publikuara nga Këshilli i Europës, të cilat janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të komuniteteve të tjera që jetojnë në Kosovë.
- Janë duke u realizuar 11 projekte shkollore që sensibilizojnë palët e ndryshme të këtyre shkollave lidhur me parimet e EQD/EDNj.

Shkollat do të vazhdojnë realizimin e projekteve të tyre deri më 30 prill dhe do të përgatisin raportet e tyre deri më 10 maj 2017. Pjesë të këtyre raporteve do pasqyrohen dhe në raportin përfundimtar që do të dorëzohet te donatorët dhe palët e tjera me interes deri më 15 maj 2017. Pas realizimit të projekteve shkollore, pjesëmarrësit që plotësojnë kriteret e aprovuara të programit të Akademisë për EDDNj do të certifikohen.

Në përgjithësi, zbatimi i Projektit ka qenë shumë i suksesshëm. Suksesin e dëshmojnë prezantimet e aktiviteteve të realizuara që publikohen në rrjetet sociale qoftë të faqen e Akademisë apo në faqet shkollore, si dhe prezantimet që u bënë më datën 11 mars 2017 në KEC gjatë takimit përcjellës. Gjëtë këtij takimi u prezantuan sukseset e arritura deri më tash, si dhe u ofruan instruksione si të vazhdohet më tutje në realizimin e aktiviteteve vijuese.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me Projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Ka dy vite që KEC në bashkëpunim me MASHT dhe partnerë të tjerë janë duke e organizuar Akademinë e Kosovës për EDDNj. Interesimi i madh i shkollave për të aplikuar për pjesëmarrje në këtë Akademi, vijimi i rregullt i programit të trajnimit nga ekipet shkollore, zbatimi me sukses i projekteve nga shkollat pjesëmarrëse në Akademi, si dhe akreditimi nga KShLM i programit të trajnimit dëshmojnë për cilësinë e këtij programi trajnues dhe nevojën që kanë shkollat për të fituar njohuri që kanë të bëjnë me parimet dhe konceptet e EQD/EDNj.

Pjesëmarrja në këtë projekt po shihet me interes nga shkollat, pikërisht nga fakti se Akademia po ofron shembuj të suksesshëm të udhëheqjes demokratike të shkollave, të modeleve mësimore se si të zhvillohet kompetenca e qytetarisë aktive në procesin mësimor si kërkesë e Kornizës Kurrikulare të Kosovës, si dhe të qasjeve të ndryshme për ndërtim të partneriteteve me komunitetin në funksion të krijimit të një klime më të përshtatshme në shkollë dhe jashtë saj.

Përvoja e arritur deri më tash duhet të shërbejë si motiv për të ndërmarrë aktivitete të cilat mundësojnë organizimin e përvitshëm të kësaj Akademie. Bashkëpunimi i frytshëm i ekspertëve ndërkombëtarë me ekipin e trajnerëve vendorë duhet të vazhdojë, jo vetëm për të siguruar cilësinë në organizimin e përvitshëm të kësaj Akademie, por edhe si mundësi për të iniciuar projekte të tjera të karakterit ndërkombëtar.

Akademia e Kosovës për EDDNj bazohet në modelin e akademive regjionale që organizohen për EQD/EDNj në Mal të Zi dhe Poloni, si dhe të Akademive vendore që kanë filluar të organizohen në Greqi, Shqipëri, etj. KEC dhe MASHT duhet të shqyrtojnë mundësinë e bashkëpunimit më të ngushtë me këto Akademi, qoftë për organizim të trajnimeve të përbashkëta ose mbajtje të konferencave regjionale që kanë për qëllim shkëmbimin e përvojave të suksesshme në promovimin e EQD/EDNj në shkolla dhe më gjerë. Kjo do të ndihmonte në ndërtimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet kombeve dhe vendeve të ndryshme me aspirata të përbashkëta për kultivim të kulturës demokratike të qytetarët e tyre.

Akademia e Kosovës për EQD/EDNj promovon një risi në programet trajnuese siç është qasja tërëshkollore në zbatimin e parimeve të EQD/EDNj. Meqë ka dy vite që shkollat përfituese kanë filluar të praktikojnë këtë qasje, atëherë do të ishte me interes organizimi i hulumtimeve që do të vlerësonte efektin apo impaktin që ka në shkolla zbatimi i njohurive të fituara gjatë Akademive dhe realizimit të projekteve shkollore. Meqë Akademi të ngajshme mbahen në regjion, atëherë hulumtimet mund të organizohen dhe me karakter regjional. Të dhënat nga hulumtimet mund të shërbejnë për përgatitje të projekteve të reja, të cilat do të adresonin ndonjë nga rekomandimet e identifikuara në to.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Në pjesën 1 është dhënë një përshkrim i tri fazave të realizimit të projektit. Po ashtu janë përshkruar dhe aktivitete kryesore që janë realizuar brenda këtyre fazave. Në veçanti është theksuar bashkëpunimi i shkëlqyer që ka ekzistuar ndërmjet ekspertëve ndërkombëtarë dhe trajnerëve vendorë në hartimin e programit trajnues, si dhe në organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve gjatë Akademisë. Njohja dhe puna e përbashkët gjatë Akademisë së Kosovës 2015, të trajnerëve vendor me ekspertët z. Rolf Gollob nga Zvicra, znj. Carolin Gebara nga Norvegjia, z. Astrit Dautaj nga Shqipëria, si dhe me ekspertë të shumtë gjatë realizimit të projektit NEZI, në veçanti me z. Basil Shroeder, dhe ekspertë të tjerë realizimit të projekteve të organizuara nga Këshilli i Europës në Kosovë ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në harmonizimin e qëndrimeve dhe angazhimeve gjatë realizimit të Akademisë së Kosovës për EDDNj 2016. Suksesi i realizimit të aktiviteteve është rezultat i bashkëpunimeve afatgjata të trajnerëve vendorë me ekspertë ndërkombëtarë.

Akademia e Kosovës bazohet në modelin Akademive Rajonale për EQD/EDNj në të cilat prezantojnë ekspertë të ndryshëm ndërkombëtarë nga Anglia, Polonia, Norvegjia, Greqia, Bullgaria, etj. Fatmirësisht trajnerët e Kosovës kanë marrë pjesë në këto Akademi si pjesëmarrës, por edhe si trajnerë, dhe kanë integruar përvojat më të suksesshme të tyre në programin e trajnimit të Akademive Kosovare për EDDNj.

Ndërsa në pjesën 2 është dhënë përshkrim i shkurtër i projekteve shkollore, disa prej të cilave kishin ndërtimin e bashkëpunimit efektiv midis komuniteteve të ndryshme, si dhe përfaqësuesve të religjioneve të ndryshme. Shkollat «Zef Lush Marku», «Frang Bardhi» dhe «Nazim Hikmet» janë disa nga shkollat multi-etnike, të cilat kanë organizuar aktivitete që kanë për qëllim fuqizimin e bashkëveprimit midis komuniteteve të ndryshme dhe promovimin e diversitetit etnik dhe kulturor si pasuri.

Gjatë muajit shkurt dhe mars 2017, trajnerët nga Kosova kanë ndihmuar ekipin nga Shqipëria për të realizuar projektin «Ngritja e Shkollës Verore në Edukim». Përvoja e fituar gjatë realizimit të Akademive të Kosovës për EDDNj ka shërbyer si shembull që ekipi nga Shqipëria të planifikojë aktivitete të cilat do të jenë me interes për mësimdhënësit që do të marrin pjesë në këtë shkollë verore.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtare

Është me interes për të gjitha palët që kanë ndihmuar që dy vite organizimin dhe mbajtjen e Akademive të Kosovës për EDDNj, të vazhdojnë një gjë të tillë edhe në të ardhmen. Interesimi i shkollave për të marrë pjesë në Akademi dhe përkushtimi i tyre për të zbatuar projektet shkollore me forcat e tyre duhet të motivojë KEC dhe MASHT që të bashkëpunojnë dhe më tutje me donatorët për të mundësuar organizimin e Akademive në baza vjetore. Përvoja e fituar gjatë 2 viteve është mirë të kultivohet dhe të kthehet në traditë në mënyrë që të sensibilizojë në mënyrë të vazhdueshme komunitetin arsimor lidhur me nevojën për të zbatuar dhe respektuar parimet e EQD/EDNj në shkollë dhe jashtë saj. Akreditimi i programit të trajnimit nga KShLM dhe shfrytëzimi i tij nga mësimdhënësit me rastin e përtrirjes së licensës apo promovimit është një tregues shtesë për nevojën e organizimit të kësaj Akademie në të ardhmen.

Meqë në kuadër të Akademisë së Kosovës për EDDNj janë përfshirë elemente të Akademive regjionale, përvoja të vendeve të tjera, si dhe elemente nga projekti NEZI, atëherë është me interes që gjatë organizimit të Akademive të ardhshme të bëhet e mundur shkëmbimi i ekspertëve nga vendet e ndryshme. Përvojat e vendeve të tjera do të pasurojnë gamën e temave të trajtuara dhe qasjet që janë përdorur në shtjellimin e tyre.

Gjerësia e temave të trajtura dhe të përkrahura nga NEZI, siç është rasti dhe i përkrahjes së kësaj Akademie, duhet të jetë motiv për planifikim dhe organizim të projekteve të tjera që kanë për qëllim kultivimin e kulturës demokratike te qytetarët përmes bashkëpunimeve brenda kulturave të ndryshme.

2 Vlerat demokratike në arsim dhe aplikimi i tyre në shoqëri

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesi i Projektit (Përgjegjësi kryesor):

- Prof. Dr. Jonuz Abdullai, PhD

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Maqedonia:

- Jonuz Abdullai, Gostivar: Doktoratë në politikën Social; M.A. jurisprudenca; Profesor në Universitetin e Evropës Juglindore (UEJL); Fakulteti i Administrimit Publik dhe Shkencave Politike.
- Myqereme Rusi, Tetovë: Studimet e psikologjisë në Maqedoni dhe Shqipëri; M.A. dhe doktoraturë në psikologji; Profesor në Universitetin Shtetëror të Tetovës (USHT).

Kosova:

- Lulzim Dragidella, Prishtinë: I diplomuar në pedagogji sociale dhe në punë sociale, Udhëheqës i Departamentit, Universiteti i Prishtinës (UP), Fakulteti Filozofik, Departamenti i Punës Sociale.

Shqipëria:

- Nikoleta Mita, Tiranë: Profesor në Universitetin e Tiranës (UT), Fakulteti i Shkencave Sociale; Prioritetet: zhvillimi kurrikulës, didaktika e Shkencave Sociale, trajnimi i mësuesit, edukimit dhe të drejtave njerëzore (fëmijë), etj.

Buxheti:

- 11'000.-

Qëllimet e Projektit

Ky projekt ka për qëllim të ndihmojë në zhvillimin e të kuptuarit të demokracisë nga ana e studentëve të parë dhe të dytë të fakulteteve të shkencave shoqërore të Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë. Në veçanti përparësi do të kenë studentët e fakulteteve të mësuesisë, duke respektuar kriteret paraprakisht të përcaktuara. Kjo nevojë e dalë nga realizimi paraprak i projektit NEZI, ka për qëllim njohjen e ndërsjellë të mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe njohjen me praktikën e mira nga partnerët tanë nga Zvicra dhe më gjerë të kontekstit evropian. Duke pasur parasysh se shtetet në tranzicionin e stërzgatur, të tilla si tre vendet e përmendura më sipër, ballafaqohen me një demokraci të brishtë, të rinjtë kanë nevojë për të kuptuar sa më drejt vlerat demokratike, të shoqërisë së hapur, pjesëmarrje në iniciativa për avancimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, për kyçe në ndryshimet dhe transformimet në shoqëri, për participim në vendimmarrje në nivel lokal dhe qendror, si dhe në shoqërinë qytetare (civic society).

Studentët e Fakulteteve të shkencave shoqërore të njihen me vlerat e nevojshme demokratike për ndërtimin e një shoqërie moderne ku do të respektohet të qenurit dhe menduarit ndryshe.

Rezultatet nga ky trajnim dhe hulumtim do të japin një pasqyrë më të mirë për aftësinë e mësimdhënësve të ardhshëm në aplikimin e njohuive dhe shkathtësive në procesin e mësimnxënies dhe aftësimin e të rinjve për pjesëmarrje aktive në vendimmarrje në shoqëritë në tranzicion. Gjithashtu, hulumtimi do të japë një pasqyrë të qartë në lidhje me nivelin e demokracisë që e posedojnë mësimdhënësit e ardhshëm në shoqëritë që ballafaqohen me sfida të demokratizimit dhe tranzicionit të stërzgatur.

Qëllimet kryesore të këtij projekti janë:

- Të ndihmojë në zhvillimin e të kuptuarit të demokracisë nga ana e studentëve.
- Të japë kontribut në ndërtimin e një shoqërie të hapur (Popper) dhe në formimin e një qytetarie demokratike
- Të avancojë edukimin ndërkulturor, edukimin për barazi, edukimin për zhvillim të qëndrueshëm dhe edukimin për paqe.
- Të japë një hartë të vlerave demokratike dhe të statusit të tyre në arsimin e lartë në kontekstin ballkanik, respektivisht në atë shqiptar (trekëndëshi Maqedoni, Shqipëri, Kosovë).
- T'i evitojë mangësitë dhe t'ua hapë rrugën zbatimit të përvojave të mira nga kontekste të huaja, si ai zviceran.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

- Projekti «Vlerat demokratike në arsim dhe aplikimi i tyre në shoqëri» është vazhdimësi e projektit paraprak të realizuar me kolegët nga Universiteti i Cyrihut, të Shkollës së Lartë Pedagogjike (PHZH), të titulluar «Netzwerk Erst-, Zweit-, Interkultur (NEZI) - (Netzwerk albanischer Sprachraum)/Rrjeti Kultura e parë, e dytë dhe interkultura (Rrjeti për trevat shqiptare)», të cilët vazhdimisht japin mbështetje në përfundimin e vlerave demokratike dhe në rritjen e kapaciteteve për zbatimin cilësor të tyre në këto tre shoqëri.
- Gjatë punës në konferencat në Prishtinë dhe në Shkup, respektivisht gjatë vëzhgimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, u vërejtën mangësi mbi nivelin e njohurive mbi vlerat demokratike tek nxënësit dhe mësimdhënësit. Në veçanti kjo u vërejt në komunikimin interaktiv, lirinë e të shprehurit, metodat e mësimdhënies, veglat e përdorura dhe kushtet e punës.
- Rritja e nivelit të njohjes mbi demokracinë dhe vlerat demokratike do të rritë edhe respektimin e këtyre vlerave, të cilat janë shtylla të bashkjetesës dhe tolerancës në mjedise multikulturore dhe multireligjioze.
- Përvojat e pjesëmarrësve nga trajnimet do të ndërlihen me përvojat e pjesëmarrësve nga diaspora, gjë e cila do të ndihmojë në integrimin e tyre në shoqëritë e shteteve në tranzicion. Nga ana tjetër, trajnimet do të mundësojnë të kuptuarit më të mirë të tjetrit, përfshirë këtu dallimet ekzistuese në mes pjesëtarëve të shoqërive të ndryshme.

Plani kohor, agjenda

Prill 2016	Takim pune me përgjegjësit e grupeve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia në Tetovë.
Prill 2016	Përzgjedhja e pjesëmarrësve në bazë të kriterëve paraprakisht të përcaktuara nga grupi i punës.
30. – 31. Maj 2016	Seminari në Tetovë
31. Maj 2016	Ndarja e certifikatave për pjesëmarrësit dhe evaluimi
Shtator – Tetor 2016	Realizimi i hulumtimit.
Nënt./Dhjet. 2016	Takim i përgjegjësve të projektit për vlerësimin e projektit në Tetovë.

Dhjetor 2016	Shpalosja e rezultateve nga hulumtimi dhe raporti përfundimtar i përgaditur për botim.
Shkurt 2017	Botimi i hulumtimit të realizuar
Mars 2017	Prezantimi i hulumtimit të publikuar në Prishtinë dhe Tiranë.

Pjesa 2: Përshkrimi i çështjeve hulumtuese të projektit dhe rezultateve të tij

Gjatë punës në konferencat e NEZI-t në Prishtinë dhe në Shkup të viteve paraprake (2014-2015), respektivisht gjatë vëzhgimit të procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, u vërejtën mangësi në nivelin e njohurive mbi vlerat demokratike tek nxënësit dhe mësimdhënësit. Në veçanti kjo u vërejt në komunikimin interaktiv, në lirinë e të shprehurit, metodat e mësimdhënies, veglat e përdorura dhe kushtet e punës në një kontekst të ri që vjen me kërkesa të reja.

Hipoteza e këtij hulumtimi ka qenë kjo: «Arsimi i lartë dhe mjedisi universitar, që duhet të gjenerojnë vlera demokratike, kulturë rinore për jetë në një shoqëri të hapur post-tranzicionale, janë në krizë në segmentin e jetësimit të vlerave shoqërore.»

Premisa jonë është se «rritja e nivelit të njohjes mbi demokracinë dhe vlerat demokratike do të rritë edhe respektimin e këtyre vlerave, të cilat janë shtylla të bashkëjetesës dhe tolerancës në mjedise multikulturore dhe multireligjioze.» Në këtë projekt kërkimor përvojat tona janë ndërlidhur edhe me përvojat e pjesëmarrësve nga diaspora, gjë e cila mund të ndihmojë si në integrimin e tyre në shoqëritë amë në tranzicion, ashtu edhe të fëmijëve të tyre dhe grupeve të ndryshme sociale që mund të jenë të marginalizuara. Përveç kësaj, trajnimet na kanë mundësuar të kuptuarit më të mirë të tjetrit, përfshirë këtu dallimet ekzistuese mes pjesëtarëve të shoqërive të ndryshme, ballkanike dhe të Evropës së Parë

Për qëllimet kryesore të këtij projekti shih lart në pjesën I të këtij raporti.

Ky punim shkencor përbëhet nga pjesa teorike që flet për raportin vlerat-shoqëria, që shpjegon triadën tranzicioni, arsimi dhe demokracia dhe përmbyllet me hulumtimin empirik, gjegjësisht me gjetjet kuantitative dhe interpretimin e tyre. Në këtë studim është përdorur një sërë metodash si ajo deskriptive, analitike, e sintezës, komparative, metoda e vëzhgimit, fokus grupi, vizita studimore si dhe metoda kryesore, anketa. Të dhënat kuantitative dhe interpretimet janë të kufizuara me kohën kur ky punim është realizuar

(2016), me kampionin e përbërë nga studentët të vitit të parë dhe të dytë të katër universiteteve shqiptare, andaj nuk mund të jepen vlerësime përgjithësuese

Nga hulumtimi i realizuar konstatojmë se:

- Si vlerë më frekvente dhe më e kërkuar nga rinia universitare është barazia.
- Sundimi i së drejtës, demokracia, llogaridhënia/transparenca nuk respektohen në mjediset universitare.
- Të rinjtë shqiptarë theks të veçantë vënë mbi sjelljen e mirë apo bontonin, 93.3 % kanë thënë se edukata e mirë është karakteristikë që duhet t'u mësohet fëmijëve në shtëpi.
- Më tepër se gjysma e studentëve shqiptarë (54.1%) fenë e shohin si vlerë shumë të rëndësishme shoqërore.
- Si formë më e shfaqur e diskriminimit është ajo e statusit ekonomik, më pas ajo e vendbanimit, e pamjes së jashtme dhe e fesë.
- Parimi i meritokracisë, apo i vlerësimit objektiv në bazë të performancave që studentët tregojnë duhet të avancohen më tepër universitetet shqiptare.
- Institucionet shqiptare të arsimit të lartë duhet t'i japin më tepër hapësirë fjalës së lirë.
- Vetëm rreth 1/3 e studentëve pohojnë se kritikizmi është frymë mbizotëruese në komunikimin akademik.
- Studentët kanë vërejtje lidhur me dallimin mes asaj që profesorët flasin dhe asaj që ata bëjnë, pra shohin mospërputhje mes fjalëve dhe veprimeve të tyre.
- Faktorët e politikave arsimore në spektrin shqiptar nuk janë impuls për promovimin e vlerave demokratike, politikat destruktive në arsim kanë ndikuar në mënyrë depri-muese të rinia universitare.
- Dallime në perceptime janë shënuar mes studentëve të tre universiteteve publike dhe atij privat që përbëjnë kampionin e këtij hulumtimi.

Si rezultat i gjetjeve nga hulumtimi sugjerojmë ndryshime cilësore në kurrikulat universitare në bazë të trendeve globale, instalim të një fryme të re kreative, më liberale, të mësimit interaktiv, krijim të universiteteve të brezit të tretë, avancim të kuadrove të reja, të profileve me njohuri, shkathtësi të kohës. Rekomandojmë mobilizim gjithëshoqëror për t'i luftuar antivlerat në akademi, në veçanti gangrenën sociale të quajtur korrupsion. Gjithë këtë ngase akademia-universiteti është një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, institucion për transformimin e shoqërisë, për ndërtimin një shoqërie të mirëqenies, të hapur, racionale dhe demokratike. Vetë studentët gjatë takimit të Tetovës (maj 2016) kanë rekomanduar zbatimin efektiv të ligjit, përmirësimin e infrastrukturës universitare, transparencë në përzgjedhjen e pedagogëve, fushata ndërgjegjësimi mbi vlerat, mbi moralin-etikën, fushata për përmirësim të trajtimit dhe statusit të personave me nevoja të veçanta, avancim të grupeve të marginalizuara, projekte bilaterale të bashkëpunimit, shfrytëzimin e programeve akademike ndërkombëtare etj.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me Projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Nga hulumtimi i realizuar nga ky projekt, si rrjedhim kemi edhe konstatime dhe sugjerime për iniciativa përkrahëse për projektet ekzistuese si dhe për mirëmbajtjen dhe forcimin e rrjetit të krijuar të deritanishëm. Dukse pasur parasysh të dhënat kthyesë të cilat i morëm si rezultat i hulumtimit, vlen të sugjerojmë se nevojiten të bëen ndryshime cilësore në kurrikulat universitare në bazë të trendeve globale, instalim të një fryme të re kreative, më liberale, të mësimit interaktiv, krijim të universiteteve të brezit të tretë, avancim të kuadrove të reja, të profileve me njohuri, shkathtësi të kohës.

Gjithashtu, rekomandojmë mobilizim gjithëshoqëror për t'i luftuar antivlerat në akademi, në veçanti gangrenën sociale të quajtur korrupsion. Gjithë këtë ngase akademia-universiteti është një nga shtyllat kryesore të shoqërisë, institucion për transformimin e shoqërisë, për ndërtimin një shoqërie të mirëqenies, të hapur, racionale dhe demokratike.

Vetë studentët gjatë punimeve në seminar kanë rekomanduar zbatimin efektiv të ligjit, përmirësimin e infrastrukturës universitare, transparencë në përzgjedhjen e pedagogëve, fushata ndërgjegjësimi mbi vlerat, mbi moralin-etikën, fushata për përmirësim të trajtimit dhe statusit të personave me nevoja të veçanta, avancim të grupeve të marginalizuara, projekte bilaterale të bashkëpunimit, shfrytëzimin e programeve akademike ndërkombëtare etj.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Në takimin e parë të organizuar në kuadër të projektit «Vlerat demokratike në arsim dhe aplikimi i tyre në shoqëri», ishin prezent Jonuz Abdullai, Ali Pajaziti, Lulzim Dragidella, Myqereme Rusi, Agron Rustemi dhe Afrim Tresi. Ky takim u mbajt me datë 25.04.2016 në Universitetin e Evropës Juglindore.

Profesoresha Nikoleta Mita për shkaqe shëndetësore nuk kishte mundësi të merr pjesë në takim dhe e njëjta na lajmëroi për këtë paraprakisht përmes e-mailit.

Në këtë takim u diskutua në përgjithësi për projektin duke u përqendruar në:

- datën e mbajtjes së seminarit dyditor në Tetovë,
- agjenda e seminarit dyditor
- kriteret për përzgjedhjen e studentëve pjesëmarrës në projekt,
- Përgatitja e temave të cilat do të prezantohen në seminarin në Tetovë

Në fund të takimit u miratuan konkluzat të cilat i prezantojmë në vijim:

- Data e mbajtjes së seminarit u caktua të jetë më 30. – 31. Maj, 2016 në UEJL – Tetovë.
- Agjenda e seminarit u rishqyrtua dhe e njëjta u miratua nga anëtarët prezent me disa ndryshime të vogla.

U caktuan kriteret për përzgjedhjen e studentëve edhe atë:

- Të jenë student të shkencave shoqërore
- Të kenë sukses të dalluar
- Sipas mundësisë të jenë nga lokalitete të ndryshme të vendit prej nga vijnë,
- Të parashihet barazia gjinore dhe
- Të kenë shkathtësi dhe aftësi për punë në teren.
- Temat të përcillen me kohë në mënyrë që për të njëjtat të bëhet përgatitja e tyre.
- Si pikë e veçantë dhe e fundit u diskutua për punën e pyetësorit që duhet realizuar nga ana e studentëve, ku secili student pjesëmarrës të realizojë nga 15 anketa, me çrast do të përmbushen kushtet për të pasur rezultate të besueshme.

Me 30 dhe 31 Maj 2016 u organizua seminari 2 ditor në Tetovë ku morrën pjesë 30 student nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia (nga 10 studentë nga secili vend), si dhe stafi i angazhuar për ligjërimin dhe mbajtjen e punëtorive / trajnimit.

Seminari kaloi në frymë të bashkëpunimit të ndërsjellë dhe ishte shumë konstruktiv. Ligjeratat dhe punëtoritë u realizuan dhe në të njëjtat studentët morrën pjesë aktive duke parashtruar pyetje dhe duke demonstruar interesim dhe motiv për pjesëmarrje në këtë projekt hulumtues.

Në këtë seminar fillimisht u realizuan ligjëratat para studentëve nga stafi i angazhuar për ligjëratat të cilat ngërthenin tema të cilat kishin të bëjnë me fokusin dhe qëllimet e projektit.

Prof. Myqereme Rusi foli mbi «Vlerat personale dhe të përbashkëta: rasti Zvicër dhe Maqedoni», prof. Merita Xhumari ligjëroi mbi «Të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore të gruas në një shoqëri maskiliste», ndërsa prof. Lulzim Dragidella ligjëroi dhe prezantoi temën «E drejta për dallueshmëri dhe lufta kundër diskriminimit në Kosovën e pavarur».

Të gjitha këto tema ngjallën diskutim dhe debat mbi temat e prezantuara, gjë e cila më pastaj pasoi me punëtori interaktive me studentët lidhur me vlerat demokratike, edhe atë të ndarë në 4 grupe të përziera nga një moderator (Jonuz, Nikoleta, Myqereme, Lulzim). E gjithë kjo përfundoi me raportim, diskutim dhe debat nga grupet e punës, gjë e cila ishte koordinuar dhe udhëhequr nga Adelina Marku.

Ditën e dytë të konferencës u bë TRAJNIM METODOLOGJIK PËR APLIKIMIN E PYETËSORIT nga ana e prof. Veli Krecit, prof. Agron Rustemit dhe prof. Ali Pajazitit.

E gjithë kjo përfundoi me përmbyllje të pyetësorit. Në kohën e mbetur, studentët dhe mysafirët nga Kosova dhe Maqedonia kishin mundësi të kryejnë vizitë të organizuar të monumenteve kulturore-historike të Tetovës (Xhamia e Larmë, Harabati Baba Teqe dhe pranim tek qendra e gjuhëve pranë Universitetit të Evropës Juglindore, ku të njëjtit u njoftuan me funksionimin e qendrës për gjuhë të huaja dhe ndërkulturalizëm dhe funksionimit të kampusit multikulturor nga drejtoresha e qendrës prof. Veronika Kareva dhe asistentit administrativ të qendrës Mujdin Livoreka). Në fund të ditës u organizua një darkë solemne në Gostivar (Vrutok), ku të gjithë pjesëmarrësit ishin prezent.

Më pastaj u bë edhe realizimi i hulumtimit me studentë të fakulteteve gjegjëse (vendi gjegjës, Kosovë, Shqipëri, Maqedoni) përmes anketimit të studentëve të tjerë (kolegë), duke u bazuar në përvojat e fituara nga trajnimi për nivelin e njohurive mbi demokracinë të realizuar në Tetovë, (përfshirë këtu pjesëmarrësit në trajnim dhe përgjegjësit nga vendet përkatëse si realizues). Rezultatet nga pyetësorët e realizuar u përpunuan nga grupi punues (Jonuz Abdullahi, Veli Kreci, Agron Rustemi, Ali Pajaziti dhe Afrim Tresi) dhe në bashkëpunim me kolegët nga Universiteti i Tiranës (Nikoleta Mita), ai i Prishtinës (Lulzim Dragidella) dhe ai Shtetëror i Tetovës (Myqereme Rusi) u përpilua teksti final për publikim.

Të gjitha këto përvoja si dhe tekstet e bashkangjitura nga pjesëmarrësit në konferencë, u botuan në një tërësi e cila për shkaqe të ndikimit dhe përdorimit sa më të gjerë u përkthye edhe në gjuhën gjermane dhe e njëjta u lektorua nga lektor profesional.

Pas publikimit të tekstit final në gjuhën shqipe dhe gjermane, grupi nga Maqedonia (Jonuz Abdullahi, Ali Pajaziti, Agron Rustemi dhe Afrim Tresi) bënë prezentimin e rezultateve nga hulumtimi në Universitetin e Tetovës, UEJL Tetovë, Universitetin e Prishtinës dhe në Universitetin e Tiranës nga ku pranuan feedbackun pozitiv nga pjesëmarrësit e seminarit 30 – 31 Maj Tetovë.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtare

Duke pranuar informatën kthyesë nga seminari si dhe nga debati i zhvilluar gjatë prezantimit dhe shpalosjes së rezultateve, mendojmë se do të ishte e udhës që projekte të tilla të ngjashme të realizohen edhe më tej me qëllim të forcimit të vlerave demokratike në mesin e të rinjve shqiptar të të gjitha trojeve. Me këtë besojmë se do të mënjanohej dallimet dhe stereotipet mbi të rinjtë të cilat vijnë nga vende dhe kultura të ndryshme, edhe pse të njëjtit i takojnë të njëjtit komb.

Vazhdim të rrjetit NEZI si dhe forcim të bashkëpunimit në mes të vendeve, gjithnjë duke u bazuar në vlerat demokratike si shtylla e forcimit të shoqërisë dhe të përafrimit të vlerave të përbashkëta.

Të gjitha përpjekjet e partnerëve tanë Zvicëran duhet përsëritur, ndërsa përvojën e fituar pjesëmarrësit në këto projekte duhet ta përdorin në zhvillimin e mëtejshëm të vlerave demokratike në shoqëritë përkatëse, të japin kontributin e tyre në përmirësimin e kushteve dhe cilësisë së mësimdhënies nëpër institucionet përkatëse të veprimt.

Kjo praktikë u dëshmua si e suksesshme pasi që u shk[mb]yten përvoja të ndryshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek të rinjtë me çka mbulohen zbrazëtirat nga mësimi formal duke përdorur një metodologji të mësimi joformal.

3 Javë studimore për temën «Diversiteti në fushën e konfliktit shkollë, familje dhe kolegë si sfidë për punën sociale»

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesja i Projektit (Përgjegjësja kryesore):

- Dr. Brigit Allenbach, Shkolla e Lartë Pedagogjike PH Cyrih /IPE

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Kosova:

- Prof. Dr. Dr. Lulzim Dragidella, Universiteti i Prishtinës, Departamenti i Punës Sociale

Zvicër:

- Dr. Brigit Allenbach, bashkëpunëtore shkencore PH Cyrih
- Renate Stohler, docente ZHAW, punë sociale
- Dr. Hans-Peter von Aarburg, docent HES-SO Valais-Wallis, Shkolla e Lartë për Punë Sociale

Buxheti:

- Fr. 17'000.-

Qëllimet e Projektit

Ideja qendrore është se diversiteti në fushën e konfliktit mes shkollës, familjes dhe kolegëve është sfidë kyçe për punën sociale.

Prandaj në trajnimin e punonjësve socialë kanë rëndësi kyçe njohuritë e debatit të diversitetit aktual, si edhe reflektimi i koncepteve të veta për diversitetin. Një prej problemeve është koncepti i vjetër për kulturën, që kulturën, besimet i kupton si blloqe unike, të cilat kufizohen qartë nga njëra-tjetra.

Kjo perspektivë e brendshme etniko-kombëtare pengon një të kuptuar të thellë të situatave, në të cilat janë të rëndësishme përfytyrimet e ndryshme të vlerës dhe të normës. Pluralizimi i vlerave nuk do të thotë që vlera dhe norma të ndryshme të ekzistojnë pranë njëra-tjetrës, por vë si kusht, që të gjithë pjesëmarrësit në një masë të lartë të jenë të gatshëm për kompromis.

Në kuadrin e një udhëtimi studimi, një grup i vogël i studentëve të punës sociale të Universitetit të Prishtinës, shoqëruar nga një docent, fiton njohuri në projektet e përzgjedhura të punës sociale në rajonin e Cyrihut dhe të Wallis. Këtu para së gjithash, bëhet fjalë për punë sociale në shkollë, projekte integrimi, mbështetje të hershme si edhe punë sociale në terren. Në qendër është shkëmbimi midis miqve kosovarë, specialistëve dhe studentëve të punës sociale nga Cyrihu dhe Wallisi gjermanofolës. Gjithashtu, nëse është e mundur, duhet të tërhiqen për pjesëmarrje edhe shqiptarë/e të brezit të dytë a të tretë në Zvicër. Një vizitë dyditore në Täsch/Zermatt duhet që t'i sjellë studentët dhe docentët shoqërues në një shkëmbim kolegial informalo- shoqërues.

Në radhë të parë, me vizitën studimore në Zvicër ndiqen objektivat e mëposhtme:

- Pjesëmarrësit e vizitës studimore fitojnë njohuri në fushat e përzgjedhura të punës sociale në Zvicër.
- Pjesëmarrësit e vizitës studimore njihen me aspekte bazë të debatit të diversitetit aktual.
- Pjesëmarrësit e vizitës studimore reflektojnë konceptet e tyre të diversitetit.
- Pjesëmarrësit e vizitës studimore marrin pjesë aktive në shkëmbimin ndërkulturor.
- Pjesëmarrësit e vizitës studimore në fund të vizitës studimore diskutojnë përvojat e tyre dhe njohuritë me një publik të gjerë, në Universitetin e Prishtinës.

Në pjesën 2 do të specifikohen përfundimet e vizitës studimore (në veçanti vizita e një delegacioni zviceran në Prishtinë, si dhe idetë për bashkëpunim të mëtejshëm).

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

- Konfrontimi me normat e ndryshme dhe sistemet e vlerave
- Shkëmbimi kulturor Zvicër & Kosovë

Plani kohor, agjenda

Prill – maj 2016:	Caktimi i programit të detajuar dhe si edhe përcaktimi i pjesëmarrësve të Projektit.
4. – 9. shtator 2016	Kryerja e javëve studimore në Zvicër
20. – 23. nëntor 2016	Takim për shkëmbim në Prishtinë
Deri në 31 mars 2017	Raporti përmbyllës është i përfunduar.

Pjesa 2: Përshkrimi i pyetjeve dhe të përfundimeve të projektit

Përmbledhje e shkurtër

Si pikënisje e vizitës studimore ishte tema «Diversiteti në fushën e konfliktit midis shkollës, familjes dhe kolegëve».

Për shkak të lidhjeve tona profesionale në trajnimin e mësimeve, në njërin anë dhe në punën sociale në anën tjetër, lindi ideja për t'u mundësuar studentëve nga Kosova njohje me projektet e punës sociale që veprojnë në kufirin mes familjes dhe shkollës.

Në qendër të vizitës studimore ishte shkëmbimi me specialistë në kuadër të inputeve të ekspertëve si dhe vizitat në «lëm». Ne kemi njohur, për shembull, organizatat e mëposhtme, projektet dhe fushat profesionale:

- Hyrje në punën sociale të shkollës me Renate Stohler dhe Bujare Ibrahimin, Shkolla e Lartë e Cyrihut për Shkencat e Aplikuara ZHAW, Departamenti i Punës Sociale
- Takim me Nick Lulgjuraj, punonjës social shkolle në ndërtesën e shkollës Kappeli, Cyrih.

- Inputi dhe guida «Zhvillimi Social Urban në Quartier Hard» nga Stefan Roschi, Drejtor i Qendrës, Qendra Sociale Ausstellungstrasse dhe drejtues & drejtues i departamentit të specialistëve të jetës sociale të qytetit, Cyrih
- Takim me të dy bashkëpunëtorët sociale të shkollës, Eva Franke dhe Dolores Rovina, si edhe me presidentin e shkollës dhe të deleguarës së integritimit Eva Jenni, Zermatt
- Vizita e njësisë për mbështetjen e hershme dhe të njësisë për ndihmën ndaj viktimave në Winterthur (në bashkëpunim me Luljeta Krasniqin).

Përveç pesë studentëve nga Prishtina dhe të drejtimit të Projektit, në vizitën studimore morën pjesë edhe dy studentë të ZHAW nga departamenti i punës sociale.

Në vizitën dyditore në Zermatt u bashkua një ekip prej tre anëtarësh nga HES-SO Valais Wallis. Në total ishin 27 persona që ishin të përfshirë në përgatitjen dhe zhvillimin e vizitës studimore në Zvicër. (Shih progamin në shtojcë).

Objektivat – Çfarë kemi arritur?

1. Pjesëmarrësit e vizitës studimore fitojnë njohuri në fushat e përzgjedhura të punës sociale në Zvicër

Stacionet individuale të vizitës studimore në Zvicër u mundësuan pjesëmarrësve një pasqyrë më të thellë në ofertën e përzgjedhur të punës sociale në marrëdhëniet shkollë-familje, por edhe në tema të tjera si zhvillimi urban-social dhe integrimi i familjeve të emigrantëve.

Vëzhgimet tona përfshijnë katër fushat e mëposhtme:

1. Puna sociale në shkollë në Kantonin Cyrih
 2. Zhvillimi social-urban në qytetin e Cyrihut
 3. Rajoni i turizmit Zermatt dhe Täsch
 4. Njësia për Mbështetjen e Hershme/ndihma për viktimat në qytetin Winterthur
2. Pjesëmarrësit e vizitës studimore njihen me aspektet themelore të debatit të diversitetit aktual.
Ideja qendrore është që pjesëmarrësve të mund t'u transmetohet më mirë debati aktual profesional për diversitetin, në të cilën të diskutohen shembuj konkretë të sjelljes me diversitetin, në këtë rast shembuj nga puna sociale.
Kjo nxit të kuptuarit se fenomeni diversitet duhet të konsiderohet gjithnjë me kontekstin specifik.

Ishte shumë e rëndësishme për ne, që studentëve nga Kosova t'u paraqitej jo vetëm «metropoli» Cyrih, por edhe zonat rurale dhe të përfshihej me këtë diversiteti i brendshëm i Zvicrës. Kështu pra, lindi ideja e një ekskursioni për në Zermatt.

Në fillim në program ishin dy inpute për diversitetin dhe punën sociale në shkollë në Kantonin e Cyrihut (nga Renate Stohler dhe Bujare Ibrahim). Nick Lulgjura na mundësoi një paraqitje të shkurtër të veprimtarisë së tij si punonjës social në shkollë në ndërtesën Chappeli në qytetin e Cyrihut.

Stefan Roschi, Drejtor i Qendrës Sociale Ausstellungsstrasse, na transmetoi gjatë shoqërimit në Quartier Hard të qytetit të Cyrihut, se sa e rëndësishme është për të kuptuar diversitetin si një detyrë të zhvillimit social-urban.

Qasja për qytetin e Cyrihut niset nga fakti që diversiteti nuk vjen vetvetiu, por duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë aktive nga autoritetet e qytetit

Krahasimi me rajonin turistik të Zermatt-it dhe të Täsch-it atëherë ishte shumë emocionues. Për shkak të çmimeve të ngitura në qendrën turistike Zermatt, në periferinë «Tasch» jetojnë shumë nga familjet më pak të privilegjuara, që në këtë mënyrë është bërë një pikë kyçe sociale.

Komunat Zermatt dhe Täsch për këtë arsye janë shembuj të mirë për procesin e ndarjes lokale të segmenteve të ndryshme të popullsisë: Këtu elita kozmopolite e pasur dhe atje kryesisht punëtorët pak të kualifikuar.

Kjo situatë është perceptuar lokalisht si «mbingarkesa me të huajën». Përqendrimi i familjeve më pak të privilegjuara ndikon në përbërjen e klasave.

Propocioni i lartë i fëmijëve të huaj ndikon në atë që familjet e mbetura vendase të kenë gjithashtu tendencë për t'u larguar. Një rreth vicioz.

3. Pjesëmarrësit e vizitës studimore reflektojnë disa koncepte të diversitetit.
Në fund të javës së studimit, studentët dhe palët e tjera të interesuara u takuan për input dhe për diskutim në PH Cyrih. Në fokus ishte shkëmbimi për vëzhgimet midis pjesëmarrësve të javës studimit.
4. Pjesëmarrësit e vizitës studimore morën pjesë aktive në një shkëmbim ndërkulturor.
Për shkak të përbërjes së pjesëmarrësve të javës studimit, shkëmbimi ndërkulturor ishte në një masë të madhe. Në veçanti, ekskursioni në Zermatt mundësoi një shkëmbim social midis të gjithë pjesëmarrësve, por sidomos midis studentëve nga Kosova dhe Zvicra.
5. Pjesëmarrësit e vizitës studimore në fund të vizitës së tyre, diskutuan në Universitetin e Prishtinës, me një publik të gjerë, përvojat dhe njohuritë e tyre. (Krahaso kërkesën e Projektit).
Shiko paragrafin e mëposhtëm për vizitën e delegacionit zviceran në Prishtinë në nëntor 2016.

Përfundime, «produkti» I projektit tonë

Nga 20.11 – 23.11.2016 një delegacion zviceran vizitoi partnerët e Projektit në Prishtinë. Delegacioni zviceran përbëhej gjithsej nga tetë persona (gjashtë profesionistë si edhe dy studentë të ZHAW). Ekspertët pjesëmarrës: Brigit Allenbach dhe Kai Felkendorff (PH Cyrih), Renate Stohler dhe Bujare Ibrahim (ZHAW punë sociale), Hanspeter von Aarburg dhe Genti Ramadani (HES-SO Valais-Wallis).

Në fokus ishin pikat e mëposhtme të programit:

- Pritja në Ambasadën e Zvicrës: Shkëmbimi i mendimeve me z. Soland Bernhard për përparësitë e SDC në Kosovë, si edhe të një bashkëpunimi të mundshëm.
- Pritja e Dekanit të Fakultetit të Filozofisë (Prof. Dugolli)
- Takim me studentët dhe bashkëpunëtorët e departamentit të punës sociale, Universiteti i Prishtinës. Input dhe diskutim mbi temat e mëposhtme: Zhvillimi i shërbimeve sociale dhe arsimimi punë sociale në Kosovë (Lulzim Dradigella); Punë sociale në shkollë-në cilën hapësirë sociale? (Hans-Peter von Aarburg)

Delegacioni zviceran mori njohuri për shërbimet psiko-sociale të shkollave në Kosovë:

- Vizita në shkollën e mesme «Xhevdet Doda» në Prishtinë (E hënë, 11.21.)
- Vizita në shkollën e mesme multietnike në Prizren (E martë, 22.11.)

Vizita e delegacionit zviceran në Kosovë ishte shumë e rëndësishme për të thelluar dhe zgjeruar kontaktet e filluara në javën e studimit (Shih gjithashtu pjesën 3, pikat fillestare për punën e mëtejshme).

Highlights (momentet kulmore)

Ekskursioni në Zermatt dhe udhëtimi në Gornergrat nuk ishin e vetmja Highlight, por një kusht i rëndësishëm për shkëmbimin social midis studentëve nga Kosova dhe Zvicra. Për studentët nga Kosova, ishte veçanërisht interesante, kontakti me specialistët në Zvicër, të cilët kanë një sfond shqiptar, qofshin këta persona, që kanë emigruar vetë në Zvicër ose shqiptarë të brezit të dytë a të tretë në Zvicër, të cilët punojnë ose studiojnë në shkolla profesionale.

I tillë ishte shkëmbimi me një punonjës social në një shkollë në Cyrih, i cili flet shqip, veçanërisht i gjallë. Ishte e dukshme se sa i madh qe kureshtja për të mësuar më shumë për punën dhe karrierën e tij. Po ashtu u vlerësua shumë nga studentët vizita e njësisë për mbështetje të hershme në Winterthur nën drejtimin e Luljeta Krasniqit.

Për mendimit tim është e mundshme, që disa nga pjesëmarrësit do të përpiqen të iniciojnë në çfarëdo forme mbështetjen e hershme në Kosovë.

Mundësia për të ndjekur shkollat në Kosovë dhe për të biseduar me kompetentët në lidhje me mënyrën se si ata merren me problemet sociale të nxënësve dhe familjeve të tyre, ishte jo vetëm shumë interesante, por edhe na tregoi se sigurisht mbetet interesi për një bashkëpunim të mëtejshëm.

Por një Highlight ishte veçanërisht edhe përbërja e delegacionit ku mund të merrnin pjesë gjithsej tetë persona (Në buxhetin fillestar ishin parashikuar vetëm 3).

Kjo ishte e mundur vetëm për shkak se java e studimit në Zvicër kushtonte më pak se parashikimi. Ne mundëm që në fjetje dhe në ushqim të kursenim në mënyrë të veçantë, sepse i strehuam privatisht studentët. Gjithashtu kishim mikpritës bujarë, të cilët na ftuan për darkë. Kai Felkendorff na priti ditën e mbërritjes në banesën e tij në Cyrih për një barbeky (Me gjithë motin me shi!) dhe Zyra për Mbështetjen e Hershme të qytetit Winterthur, na financoi një drekë në këmbë në ambientet e saj.

Probleme, rishikim kritik

Megjithëse Projekti në çdo kuptim është i arrirë mirë dhe objektivat u arritën plotësisht, megjithatë problemi kryesor është që ato duhet të punojnë, për të planifikuar, kryer dhe përfunduar Projektin.

Në një kuadër të tillë as pagat nuk mund të paguhen, po ashtu mungon edhe baza për zhvillimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit (Shih kapitullin tjetër.).

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me Projektin, pikënisjet për punën e mëtejshme dhe kërkime të mëtejshme

Gjatë vizitës në Kosovë u shqyrtuan mundësi të ndryshme të bashkëpunimit të mëtejshëm midis partnerëve të Projektit. Një ide ishte për të kontrolluar përshtatjen e konceptit të punës sociale në shkollë në nivelin e mesëm të I ose II për situatën në Kosovë. Renate Stohler nga ZHAW ka hartuar tashmë një koncept në vija të përgjithshme më 11.30.2016.

Në Universitetin e Prishtinës ofrohet vetëm që prej pak vitesh një studim në punë sociale. Studentët fitojnë një diplomë Bachelor. Përveç trajnimit teorik, studimi përfshin gjithashtu një praktikë prej 100 ditësh. Deri më tani në Republikën e Kosovës, puna sociale është pak e implementuar si një profesion dhe për këtë arsye koncepti i punës sociale në

shkollë nuk është i njohur. Zbatimi i punës sociale në shkollë mund të jetë një burim shitesë për shkollat dhe i mundëson të diplomuarit e programit Bachelor në Universitetin e Prishtinës një perspektivë profesionale (Shih. Renate Stohler, koncept i përafërt i 30.11.2016).

Aktualisht është e paqartë nëse burimet për të ndjekur këto plane ekzistojnë nga ana e partnerëve të projektit.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvoja e bashkëpunimit dypalësh ose shumë-kombësh

Bashkëpunimi gjatë kohëzgjatjes së Projektit (mars deri nëntor 2016) në çdo kuptim ishte produktiv dhe i mbështetur nga një interes i madh reciprok. Angazhimi i ekspertëve të përfshirë në përgatitjen dhe zhvillimin e javës studimore në Zvicër ishte i madh dhe mundësoi një shkëmbim intensiv, të gjallë dhe profesionalisht shumë interesant.

Këtu, supozimi ynë është konfirmuar, se shkëmbimi informal është i rëndësishëm para së gjithash për krijimin e besimit si bazë për bashkëpunim të mëtejshëm. Me këtë Projekt ia kemi arritur që të nisim kontakte midis studentëve të punës sociale në Universitetin e Prishtinës dhe ZHAW. Ne gjithashtu mundëm të krijojmë lidhje midis specialistëve shqipfolës në Zvicër dhe partnerëve të Projektit në Kosovë.

Pjesa 5: Rekomandime për faza të ngjashme të thellimit dhe konsolidimit në lidhje me projektet shumëkombëtare

Bazuar në Projektin vijues NEZI «Diversiteti në fushën e konfliktit shkollë-familje dhe kolegë si sfidë për punën sociale» nuk mund të bëhen këtu rekomandime konkrete.

Shtojcë:**Programi i javës studimore «Diversiteti në fushën e konfliktit shkollë, familje dhe kolegë si sfidë për punën sociale»**

E diel, 4.9.16	Çfarë	Ku	Kush
17.00	Pritje në aeroportin e Cyrihut, më pas darkë e përbashkët në Cyrih (me pritësit)		BAL
E hënë, 5.9.			
09.00 – 10.00	Input. Puna sociale në shkollë nga Renate Stohler RST (Mjedisi 6.T62)	ZHAË	RST
10.00 – 10.30	Pushimi		
10.30 – 11.30	Input. Migracioni dhe puna sociale në shkollë nga Bujare Ibrahim		RST
11.30 – 12.45	Dreka	ZHAË	RST
13.30 – 15.00	Takimi me Nick Lulgjuraj, punonjës social në shkollë Kappeli	Kappeli	BAL
15.30 – 17.30	Zhvillimi Social Urban në Quartier Hard Soziale – Input dhe guida me Stefan Roschi SRO, drejtues i Qendrës, Qendra Sociale Ausstellungsstrasse dhe & drejtues i departamentit të specialistëve të jetës sociale të qytetit	Hardau	BAL/ SRO
Në mbrëmje	Kohë e lirë në dispozicion, sipas dëshirës darkë e përbashkët (në varësi të motit p. sh. Kiosk Josefswiese apo Bäckeranlage)		BAL
E marta, 6.9.			
09.02	Nisja Cyrih HB		
12.13	Mbërritja Zermatt		
	Mittagessen in Zermatt		

14.00 – 17.00	Takim me dy punonjëse sociale në shkollë Eva Franke dhe Dolores Rovina si edhe me të deleguarën e integritit Eva Jenni, e cila njëkohësisht është edhe drejtuesja e shkollës së Täsch. Të tre specialistët kanë rënë dakort. Vijimi i mbasdites është ende i hapur.	Schulzentrum Zermatt	HPA
19.30	Darka në Jugendherberge Zermatt, Fjetja në Jugendherberge		
E mërkura, 7.9.			
Mëngjes	Eksursion Gornergrat		
14.37 apo 15.37	Kthimi për në Cyrih		
17:58 apo 18:58	Mbërritja Cyrih HB		
Në mbrëmje	Kohë e lirë		
E enjte, 8.9.			
09.00 – 12.00	Njësia Mbështetje e Hershme në Winterthur – Vështrim në mënyrë graduale në Projekt me Luljeta Krasniqi LKR; Vizita e zyrës ndihma për viktimat		LKR
12.00 – rreth. 13.45	Drekë e përbashkët me drejtimin e KJZ e sektorit familje dhe rini në qytetin Winterthur		
14.30 – 15.45	Input për debatin aktual të diversitetit dhe shkëmbim mendimesh për vëzhgimet e pjesëmarrësve të javës studimore	PHZH	
15.45 – 16.15	Kafe		
16.15 – 17.30	Sinteza dhe perspektiva		
17.30 – 19.30	Kohë e lirë		
19.30	Aperitiv dhe darkë në qendrën 'Karl der Grosse', në qytetin e vjetër të Cyrihut. P Christoph Schneider, drejtor Karl der Grosse, jeta sociale e qytetit, qyteti Cyrih.		
Prej orës 22.00	Dalja, jetë e nate e qytetit (sipas mundësive)		

4 Demokracia në praktikë – Trajnim pilot për versionin në gjuhën shqipe të uebsajtit www.living-democracy.al për Shqipërinë dhe Maqedoninë

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesi i projektit (përgjegjësi kryesor):

- Astrit Dautaj, Shqipëri

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Shqipëri:

- Astrit Dautaj, Përgjegjës i Sektorit të Zhvillimit të Kurrikulës pranë Institutit të Zhvillimit të Arsimit
- 14 mësues të shkencave shoqërore nga Shqipëria

Maqedoni:

- Myqereme Rusi, Universiteti Shtetëror i Tetovës
- Jonuz Abdullai, Universiteti i Evropës Jug-Lindore
- 14 mësues të shkencave shoqërore nga Maqedonia (me kombësi shqiptare)

Zvicër:

- Rolf Gollob, Shkolla e Lartë Pedagogjike, Cyrih/IPE

Buxheti:

- Fr. 18'000.-

Qëllimet e Projektit

Projekti dhe veprimtaritë që përbëjnë përmbajtjen e tij u panë dhe duhet të shihen në kuadrin e Projektit NEZI të Universitetit të Edukimit të Mësuesve në Cyrih.

Projekti dhe veprimtaritë e tij u propozuan nga vendet pjesëmarrëse në të, që janë Shqipëria dhe Maqedonia dhe institucionet e tyre përkatëse, Instituti I Zhvillimit të Arsimit në Tiranë, dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Jug-Lindore në Maqedoni. Po kështu, partner i rëndësishëm ishte edhe Shkolla e Lartë Pedagogjike në Cyrih.

Projekti u mbështet në dy shtylla kryesore:

1. Arritjet e projektit të Këshillit të Evropës për Edukimin për Qytetari Demokratike dhe Edukimi për të Drejtat e Njeriut (EDC/HRE), që janë 6 vëllime për nxënësit dhe mësuesit e Edukimit për qytetari demokratike dhe krijimi i sitit Living-democracy.
2. Përkthimi në gjuhën shqipe i të gjithë paketës prej 6 vëllimesh si dhe përkthimi në gjuhën shqipe i uebsajtit <http://www.living-democracy.al/>

Projekti synon të qartësojë konceptin e qytetarisë në shoqëritë pluraliste dhe të theksojë dhe të vërë në zbatim idenë që Edukimi i kompetencave të qytetarisë fillon në klasë.

Për këtë arsye, projekti synon të ofrojë edhe idetë për qasjen që duhet të përdoret për shfrytëzimin e uebsajtit si dhe të vetë edukimit për qytetari demokratike në shkollë dhe jashtë saj.

Projekti pati si objektiva të parë:

- Trajnimin tre ditor të 28 mësuesve të të gjitha cikleve të arsimit nga Shqipëria dhe Maqedonia
- Organizimin e një seminari reflektimi dhe zhvillimi 6 muaj pas trajnimit bazë.
- Përrurimin e faqes së EQD në gjuhën shqipe për komunitetin e gjerë shqipfolës.
- Qartësimin e konceptit të qytetarisë në shoqëritë pluraliste.
- Botim i informacionit të plotë për seminarin.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

Projekti është në lidhje të ngushtë me qëllimet e Rrjetit Nezi në drejtimet e mëposhtme:

- **Shkëmbim përvoja ndërmjet grupeve pjesëmarrëse:** Projekti përshin mësues nga Shqipëria dhe Maqedonia, të cilët vijnë në këtë projekt me histori të ndryshme përvojash dhe realitetesh arsimore dhe kulturore.

- **Të mësuarit e mëtejshëm përmes kontakteve ndërkulturore:** Vetë metodologjia e zbatimit të projektit krijoi kushtet e duhura për lehtësimin e procesit të shkëmbimit, të njohjes, pranimit dhe respektimit të këtyre përvojave si dhe të pasurimit të tyre të mëtejshëm.
- **Ndërkulturalizmi dhe të mësuarit ndërkulturore:** Objektivat e projektit dhe përmbajtja e tij lidhen me objektivat më të lartë të edukimit ndërkulturore, si dimension i rëndësishëm i Edukimit për qytetari demokratike dhe për të drejtat e njeriut. Prezantimi i uebsajtit „living-democracy.al“ dhe puna me të, krijoi një bazë të qëndrueshme burimore për trajnimin dhe vettrajnimin e mësuesve të qytetarisë.
- Përmbajtja e materialeve burimore të uebsajtit dhe pedagogjia e sugjeruar për edukimin ndërkulturore do të rritin shanset për përfitimin e njohurive, aftësive dhe qëndimeve të nevojshme për një shoqëri demokratike.

Plani kohor, agjenda

Projekti kishte planifikuar të realizohej në dy faza kryesore:

I Faza e parë: Shkurt – prill 2016

Në këtë fazë trajnerët kanë qenë në kontakte të vazhdueshme për përgatitjen e trajnimit. Po kështu, gjatë kësaj faze janë realizuar bashkëpunimet ndërmjet përgjegjësit të projektit dhe koordinatorit për Shqipërinë, Astrit Dautaj, me koordinatorët nga Maqedonia, Myqereme Rusi dhe Jonuz Abdullahi, për përcaktimin e kriterëve të përzgjedhjes së mësuesve pjesëmarrës në seminarin e Shqipërisë dhe të përzgjedhjes së pjesëmarrësve në bazë të këtyre kriterëve të parapërgatitura.

II Faza e dytë: maj 2016 – janar 2017: përgatitja dhe zhvillimi i seminarit

Gjatë kësaj faze, në muajin qershor:

- u zhvillua takimi i trajnerëve për përgatitjen e seminarit në datat 20-21 qershor
- u zhvillua seminari në datat 22 – 24 qershor
- u zhvillua takimi për reflektimin e rezultateve të seminarit dhe përgatitjen përfundimtare të tij themelore. Po kështu, u përcaktuan hapat vijuese të projektit në vendet pjesëmarrëse: Shqipëri dhe Maqedoni

Pjesa 2: Përshkrimi i çështjeve dhe përfundimet e Projektit

Trajnimi u përqendrua në aftësitë mësimdhënëse dhe në reflektimet e tjera për rezultatet e projektit dhe të veprimtarisë më konkretisht. Në trajnim u përdor metoda induktive, e cila ishte e re për shumë nga pjesëmarrësit në trajnim. Megjithatë, pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e përqafuan atë me kënaqësi, gjë që u shoqërua me vlerësime shumë pozitive në fund të trajnimit.

Seminari u zhvillua në fund të vitit shkollor dhe në të njëjtën kohë në mes të Maturës shtetërore dhe të periudhës së Ramazanit, pra në një kohë të papërshtatshme për veprimtari me intensitet të lartë informacioni dhe përqendrimi. Megjithatë pjesa më e madhe e pjesëmarrësve u përfshinë aktivisht dhe me përkushtim në veprimtaritë e seminarit, madje, një prej tyre u shpreh se «Energjia u bë edhe më e madhe në veprimtarinë e fundit».

Seminari filloi me një prezantim hyrës nga Astrit Dautaj dhe vijoi menjëherë me veprimtarinë me titull «Zgjedhja e Milanit», e shkëputur nga Vëllimi III, Njësia 6.

Diskutimet e zhvillura pas veprimtarisë, pra pas një modeli të ri të mësimdhënies pohan se kjo qasje e trajnimit të mësuesve në punë dhe materialet e reja të mësimdhënies dhe të mësuarit janë shumë të përshtatshme për qëllimin e tyre dhe njëherazi të mirëpritura prej pjesëmarrësve.

Risi të seminarit ishin:

1. Fakti që pjesëmarrësit nuk ishin trajnuar më parë në mësimdhënien me njësi të vogla (micro teaching).
2. Fakti që përgatitja për të do të realizohej vetëm përmes përdorimit të websitit.

Për këtë arsye sigurimi i një rrjeti funksional interneti ishte kusht i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve të këtij trajnimi. Vetëm një pjesë e vogël e pjesëmarrësve kërkuan librat dhe theguan disa caste padurimi.

Metodologjia e zgjedhur nga ekspertët për të realizuar mësimdhënien me njësi të vogla, si qasje e bazuar në të mësuarit në bazë detyre dhe rezultate shumë të mira. Çdo pjesëmarrës duhet të realizonte një plan të kësaj mësimdhënieje në një hapësirë të kufizuar kohe. Kjo krijoi pak presion në gjetjen e informacionit të duhur nga uebsajti, të domosdoshëm për përgatitjen e mësimit dhe duke u mbështetur në të. Meqë kjo lloj mësimdhënieje bazohet qartësisht në informacionin nga uebsajti, mund të themi që trajnimi i realizuar pa përdorimin e letrave dhe i materialeve të tjera trajnuese të ngjashme me to, rezultoi shumë i suksesshëm.

E njëjta procedurë u zbatua në ditët e tjera të seminarit, kur pjesëmarrësit duhet të përgatisnin 9 projekte për të drejtat e fëmijëve, Vëllimi V.

Në seminar u provua që mësuesit e përzgjedhur zotëronin aftësi të mira mësimdhënëse. Për këtë arsye ata u treguan të shpejtë dhe të efektshëm në të kuptuarit dhe realizimin e mësimdhënies në bazë detyre. Këtu duhet të theksohet edhe fakti që modeli i punës së ditës së parë rezultoi të ishte parakusht për suksesin e punës së ditës në vijim.

Po kështu, duhet të dalë në pah aftësia e mësuesve për të paraqitur shkurt dhe qartë detyrën, duke u dhënë më shumë kohë nxënësve për të mësuarit e tyre aktiv.

Kjo ishte qasja që ekspertët përdorën gjatë gjithë seminarit, duke u përpjekur të ofrojnë një model për punën edhe në klasën e tyre, megjithëse për ta ishte i qartë fakti që përgjegjësia qëndron gjithmonë tek mësuesi.

Në seminar, pjesëmarrësit provuan të jenë të suksesshëm edhe në fazën e kalimit nga marrësi pasiv në vepruesin aktiv.

Puna me EQD/EDNJ përmes burimeve online tregoi që:

1. Ueb sajti LivDe është i konceptuar dhe strukturuar shumë mirë.
2. Ueb sajti LivDe u pranuar mirë dhe i shërben qëllimit të tij.
3. Trajnimet që bazohen në burimet online duhet të marrin parasysh garantimin e kushteve teknike (uairless, kompjuter etj.) si dhe kohën e nevojshme për pjesëmarrësit të cilëve u mungojnë njohuritë dhe aftësitë paraprake për të punuar me burimet dhe materialet online.

Në takim u krijua mundësia e një takimi të shkurtër me Minsitrin e Arsimit të Maqedonisë, Z. Pishtar Lutfiu, i ndodhur në Durrës në kohën e trajnimit, i cili garantoj mbështetjen e ministrisë për promovimin e uebsajtit. Ai u ineresua për kohën e hyrjes në funksionim të uebsajtit për t'ua bërë atë të ditur shkollave.

Në seminar u vendos të zbatoheshin edhe hapat e mëtejshëm:

- Mbledhja e adresave të e-mail-it të pjesëmarrësve
- Integrimi i rezultateve të këtij trajnimi në raportin e përgjithshëm të KE.
- Vijimi me uebsajtin e Maqedonisë dhe informimi i Ministrisë së Arsimit.
- Planifikimi i një fushate informimi për uebsajtin në Shqipëri.
- Prezantimi dhe pranimi i uebsajtit si një ndër burimet kryesore për trajnimin dhe vettrajnimin e mësuesve të qytetarisë, përmes uebsajtit të Institutit të Zhvillimit të Arsimit në Shqipëri.

Një ndër rezultatet e seminarit ishte edhe krijimi i një grupi pilot mësuesish, të cilët do të shërbenin si shembull i parë pozitiv për hapat në vijim. Këta mësues, jo vetëm do të zbatojnë të parët rezultatet e projektit, por do të jenë të parët që edhe do t'i përhapin ato në mjediset e tyre mësimore dhe më gjerë. Përveç kësaj, ata mund të shërbejnë edhe si baza e fillimit të një fushate informacioni.

Pjesa 3: Çështje të hapura në lidhje me projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Projekti hodhi një hap të rëndësishëm në ndihmë të mësuesve të përshtirë në projekt, për rritjen e profesionalizmit të tyre në fushën e mësimdhënies së qytetarisë.

Ai jo vetëm konfirmoi vlerën e kësaj pedagogjie që është tërësisht në shërbim të nxënësit, por ofroi modele konkrete e të shumta për realizimin e saj në praktikë.

Mësuesit në seminar pranuan njëzëri vlerën e saj.

Por, në të njëjtën kohë, projekti hodhi më shumë dritë në disa nga kushtet e domosdoshme që duhet të krijohen në çdo mjedis arsimor për përmbushjen e qëllimeve të arsimit në përgjithësi dhe të objektivave të fushave ose të fazave të caktuara, në mënyrë të veçantë.

1. Kështu, një çështje që lindi ose u mendua gjatë projektit ka të bëjë me standardet e shkollës në përgjithësi dhe me mundësië e mësuesve të veçantë në zona të ndryshme të vendeve të përfshira në projekt për të punuar në kushtet e projektit. Këto kushte mund të jenë:

materiale dhe kanë të bëjnë me:

- mundësinë e shkollës për një linjë interneti dhe me mundësitë ekonomike të saj për të pajisur klasat me kompjuter, për të shfrytëzuar internetin.
- praninë në çdo kohë, pra me qëndrueshmërinë e kushteve në fjalë dhe me cilësinë e qëndrueshmërisë së tyre në kohë dhe në hapësirë.

njerëzore dhe kanë të bëjnë me:

- praninë e mësuesve që mund të përdorin internetin
- shkallën e kualifikimit të mësuesve në fushën e përdorimit të internetit
- gatishmërinë e mësuesve për të shfrytëzuar burime shtesë përveç tekstit të nxënësit etj.

Një çështje tjetër me interes është përgjegjësia e ndjerë e institucioneve arsimore, qendrore ose vendore, për të mbështetur nisma dhe mundësi të tilla si dhe gatishmërinë e tyre për t'i bërë ato realitet.

- a Së pari, institucionet arsimore (Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Instituti për Zhvillimin e Arsimit, Drejtoritë Arsimore rajonale dhe Zyrat arsimore duhet të bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e përdorimit të burimeve të ndryshme për kualifikimin e mësuesve.

- b Së dyti, institucionet arsimore që janë përgjegjëse për trajnimin dhe kualifikimin e mësuesve duhet të krijojnë të gjitha kushtet për bërjen të njohur tek mësuesit e të gjitha burimeve.
- c Së treti, gatishëmria e institucioneve arsimore që janë përgjegjëse për kualifikimin e mësuesve për t'i kthyer këto burime në burime të rëndësishme dhe bazë të kualifikimit dhe të vetkualifikimit të mësuesve. Kjo do të thotë se këto burime, pra edhe uebsajti www.living-democracy.al të jetë pjesë e listës së burimeve zyrtare të sugjeruara për kualifikimin dhe atestimin e mësuesve në punë.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Ideja e këtij projekti lindi në kuadrin e zbatimit dhe të detyrave të projektit NEZI të Universitetit të Edukimit të Mësuesve në Cyrih.

Projekti dhe veprimtaritë e tij u propozuan nga vendet pjesëmarrëse në të, që janë Shqipëria dhe Maqedonia dhe institucionet e tyre përkatëse, Instituti i Zhvillimit të Arsimit në Tiranë, dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Jug-Lindore në Maqedoni. Po kështu, partner i rëndësishëm ishte edhe Shkolla e Lartë Pedagogjike në Cyrih.

- Së pari, në fillim, vendet propozuese (dhe pjesëmarrëse) u përpoqën të konkretizojnë idenë e një bashkëpunimi ndërmjet dy vendeve, Shqipëria dhe Maqedonia, me pjesëmarrës që megjithëse flasin gjuhën shqipe, kanë histori të ndryshme ekonomike, sociale, politike dhe kulturore. Në këtë kuptim, ky bashkëpunim do të kishte njëherazi si dimensionin dykombëtar ashtu edhe atë shumëkombëtar. Këtë dimension të dytë, ky bashkëpunim do ta fitojë me pjesëmarrësin në të të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Cyrih.
- Së dyti, ky bashkëpunim do të kishte edhe objektiva të karakterit trajnues dhe kualifikues, pra synimi i palëve bashkëpunuese ishte që këtij dimension t'i jepte një peshë kryesore. Në këtë mënyrë, lindi dhe u kristalizua ideja e këtij projekti, që shfrytëzoi çastin e duhur për të bërë të njohur uebsajtin www.living-democracy.al, si një bazë e rëndësishme burimore për kualifikimin dhe vetkualifikimin e mësuesve, por edhe për të siguruar trajnimin e mësuesve të dy vendeve të përfshirë në projekt, si përfituesit e parë të tij.

Projekti ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet Astrit Dautaj (Shqipëri), Jonuz Abdullai (Maqedoni) dhe Myqereme Rusi (Maqedoni). Ideja e tij u përpunua në proces deri sa u arrit në variantin e fundit edhe në konsulencë me ata që u propozuan si trajnerë në këtë projekt z. Rolf Gollob nga Instituti i Lartë Pedagogjik në Cyrih. Astrit Dautaj ishte edhe personi përgjegjës për realizmin e këtij projekti.

Ideja e këtij Projekti gjeti mbështetjen e menjëherëshme nga pjesëmarrësit në të, për shkak të nevojës së madhe të mësuesve të vendeve për trajnime në fushën e edukimit për qytetari demokratike, për pasuri të burimeve që ofrojnë material për trajnim dhe vettrajnim si dhe të nevojës së përgjithshme të pjesëmarrësve për bashkëpunime për të ndarë përvojat në fushën e arsimit dhe atë njerëzore e kulturore, si faktorë të rëndësishëm të veprimit të përbashkët shoqëror në të mirë të demokracisë.

Rëndësinë e sipërpërmendur e dëshmon edhe fakti që megjithë vështirësitë dhe kohën e papërshtatshme të zhvillimit të seminarit dhe të projektit për disa arsye objektive, pjesëmarrësit morën pjesë dhe u përfshinë me përkushtim në të.

Veprimtaria kryesore e projektit, seminari, u realizua në Durrës, në një mjedis që ofronte kushte të mira për përmbushjen e objektivave të tij, por edhe një mjedis të këndshëm dhe mikëpritës për pjesëmarrësit në seminar.

Për këtë arsye, ky projekt e bashkëpunim, është një model për bashkëpunime e projekte të tjera në të ardhmen.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtare

Së pari duhet të theksojmë që ideja e këtij projekti ishte në kohën e duhur. Kjo kushtëzoi edhe lehtësinë me të cilën ajo u konkretizua në ide të tjera vijuese që ishin bazë e projekteve të ndryshme që përbëjnë përmbajtjen dhe historinë e fazës së parë të Projekti NEZI.

E quajmë fazë të parë, pasi ky projekt jo vetëm shtroi disa rrugë që jo vetëm meritojnë të vazhdoen, por krijoi edhe modele pozitive të vazhdimësisë së tyre të sigurtë e të suksesshme. Në këtë kuadër, e vlerësojnë të sukseshëm të gjithë projektin NEZI.

Ne mendojmë që përvoja dhe modeli i krijuar në këtë projekt, të mund të shumëfishohet në të ardhmen, pasi nevoja e shoqërisë për mirekuptim ndërkulturor dhe e arsimi për të mundur atë në mënyrë cilësore është më se domosdoshme.

5 Shkolla Verore Rajonale në Edukim

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesi i Projektit:

- Prof. Dr. Nikoleta Mita, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Shqipëri:

- Nikoleta Mita, Universiteti i Tiranës
- Merita Xhumari, Universiteti i Tiranës
- Astrit Dautaj, Instituti i Zhvillimit të Arsimit

Kosovë:

- Shqipe Gashi, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Melinda Mula, Qendra për Arsim e Kosovës

Maqedoni:

- Jonuz Abdullai, Universiteti i Evropës Juglindore
- Myqereme Rusi, Universiteti Shtetëror i Tetovës

Zvicër:

- Mirëlinda Shala, Shkolla e Lartë Pedagogjike e Cyrihuth

Buxheti:

- Fr. 11'000.-

Objekti i Projektit

Vlerësimi i nevojave për ngritjen e një shkolle verore rajonale në edukim.

Qëllimi i projektit

Qëllimi i projektit është vlerësimi i nevojave, mundësive dhe burimeve për ngritjen e një shkolle verore në edukim me fokus në fushat e edukimit për demokraci, pedagogjisë ndërkulturore, pedagogjisë së socializimit e cila do të synojë avancimin në zhvillimin profesional të mësuesve dhe specialistëve të edukimit nga vendet e rrjetit NEZI dhe hartimi i një platforme për ngritjen e shkollës verore e cila parashikohet të hapet në vitin 2018 dhe të funksionojë çdo vit.

Përmbajtja e projektit

Projekti pati në fokus vlerësimin e nevojave për ngritjen e një shkolle verore rajonale në edukim. Në këtë kuadër u krye vlerësimi i nevojave të mësuesve për zhvillim profesional në pesë fusha kryesore: edukimi për demokraci, edukimi ndërkulturore, pedagogjia e socializimit, kompetencat e nxënësit në shekullin e 21-të dhe kompetencat e mësuesit në shekullin e 21-të. Përveç tri fushave të parapara në projekt, në vlerësim u përfshinë edhe dy fusha të tjera që lidhen me kompetencat e nxënësit dhe mësuesit në shekullin e 21-të, të cilat u sugjeruan gjatë fokus grupeve me mësues dhe studentë të mësuesisë. U krye vlerësimi i nevojës së ngritjes së shkollës verore si një alternativë për zhvillim profesional. Vlerësimi u krye edhe për infrastrukturën mbështetëse për ngritjen dhe funksionimin e shkollës verore. Në kuadër të projektit u krye vlerësimi për burimet njerëzore, përzgjedhja e ekipit të lektorëve potencialë për shkollën verore. Përmbajtja e programit të shkollës verore, identifikimi i temave kyçe dhe i formatit të kursit ishin çështje të tjera të përmbajtjes së projektit. Përlogaritja e kostos së shkollës ishte një pikë tjetër e rëndësishme e projektit.

Projekti parashikoi këto pritshmëri:

- Identifikimi i nevojave për trajnim të mësuesve dhe kandidatëve për mësues për zhvillim profesional.
- Shkolla verore do të ishte një mundësi për avancim në zhvillimin profesional, për zgjerim dhe thellim të njohurive, për zhvillimin e aftësive që u duhen mësuesve për të dhënë mësim në mënyrë të efektshme dhe për të përballuar sfidat arsimore në një shoqëri globale.
- Shfrytëzimi i sinergjisë së ekspertizës dhe përvojës së profesorëve dhe ekspertëve të arsimit nga Zvicra, vende të tjera të Evropës dhe Ballkani.
- Përgatitja e një raporti vlerësimi për nevojat, mundësitë dhe burimet e ngritjes së një shkolle verore në edukim me pjesëmarrës nga vendet e rrjetit NEZI.
- Përgatitja e planit të veprimit për ngritjen e shkollës verore.
- Përgatitja e programit paraprak të shkollës verore. Përgatitja e një programi trajnimi që jo vetëm do t'i pajisë pjesëmarrësit e shkollës verore me një formim nga shkencat e edukimit, por do t'i nxisë ata të përdorin plotësisht njohuritë dhe aftësitë e fituara.
- Përgatitja e listës së lektorëve.
- Përgatitja e buxhetit paraprak për shkollën verore.

Produkte dhe rezultate të parashikuara të projektit

- Broshura e Shkollës Verore Rajonale të Edukimit.
- Raporti i vlerësimit për nevojat, mundësitë dhe burimet e ngritjes së një shkolle verore në edukim me pjesëmarrës nga vendet e rrjetit NEZI.
- Plani i veprimit për ngritjen e shkollës verore.
- Programi i shkollës verore.
- Lista e lektorëve sipas vendeve dhe tematikës.
- Përgatitja e buxhetit për shkollën verore.
- Përgatitja e raportit përfundimtar të projektit.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

Idea për projektin «Shkolla Verore në Edukim» lindi si rezultat i analizës dhe diskutimeve të kryera në konferencën e V-të të Tiranës të Rrjetit NEZI në vitin 2015, ku temë qendrore ishte përgatitja dhe trajnimi i mësuesve për edukimin qytetar dhe ndërkulturor. Pjesëmarrësit vunë në dukje se formimi dhe trajnimi i mësuesve në këto aspekte nuk është i mjaftueshëm dhe i efektshëm. U ra dakord që për arsye të specifike të tre vendeve (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni) të propozohet një projekt për ngritjen e një shkolle verore nëpërmjet dy fazave, fillimisht që të vlerësojë nevojat dhe të krijojë një tablo reale për nevojat dhe burimet dhe vitin e ardhshëm të fillojë zbatimin e aktivitetit të shkollës verore nëpërmjet një projekti tjetër.

Projekti lidhet ngushtë me qëllimet e mëposhtme të dokumentit bazë të rrjetit NEZI

- Shkëmbimi tematik i përvojave, teorive, koncepteve dhe ideve dhe përkrahja e dialogut shkencor midis ekspertëve të fushave të edukimit për demokraci, pedagogji ndërkulturore, pedagogji e socializimit nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra.
- Projekti mundësoi shkëmbimin tematik të përvojave, teorive dhe zhvilloi dialogun ndërmjet ekspertëve anëtarë të rrjetit NEZI. E gjithë veprimtaria për realizimin e projektit u shoqërua me një dialog konstruktiv pasi një sërë çështjes ishin shumë të diskutueshme, veçanërisht ato të organizimit dhe të funksionimit të shkollës. Duke qenë se vendet pjesëmarrëse kishin përvoja të ndryshme lidhur me zhvillimin profesional të mësuesve dhe shkollën verore, ndarja e këtyre përvojave bëri që të paraqiten alternativa që mund të funksionojnë në dobi të mësuesve dhe studentëve në të tre vendet.
- Shfrytëzimi i përbashkët i sinergjive dhe informacioneve.
- Shkëmbimi i përvojave të grupeve pjesëmarrëse nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra për nevojat e zhvillimit profesional të mësuesve, për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të shkollës verore ndihmon në krijimin e një vizioni të qartë, realist dhe të mundshëm për t'u zbatuar. Sinergia e këtij bashkëpunimi çoi në një

efektivitet më të lartë të produktit të projektit. Ndërtimi i programit të shkollës verore mban parasysh kapacitetet njerëzore dhe botimet e profesorëve nga Zvicra dhe kapacitetet e partnerëve nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia.

- Zhvillimi i qëndrueshëm i bashkëpunimit mes ekspertëve zviceranë dhe atyre nga vendet shqipfolëse.
- Bashkëpunimi i ngushtë në kuadrin e projektit të shkollës verore ndërmjet ekspertëve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Zvicra është parë si një vijimësi e projektit kryesor të NEZI-it, si një pasurim i përvojës së fituar dhe si një garanci për realizimin me sukses të projektit. Pjesëmarrja e ekspertëve të rinj si bashkëpunëtorë të projektit nga vendet e përfshira në projekt ndihmon zhvillimin e qëndrueshëm të bashkëpunimit dhe vazhdimin e bashkëpunimit në vitet në vijim.
- Njohja më e mirë me çështje aktuale, teori, rezultate hulumtuese dhe modele nga Evropa Perëndimore
- Bashkëpunimi ndërkombëtar mundësoi njohjen e përvojave për zhvillimin profesional të mësuesve, për organizimin e shkollës verore, për modelet e trajnimit, për llojet e punimeve që pritet të realizohen nga pjesëmarrësit në shkollën verore. U hulumtuan përvoja nga Britania e Madhe, Hungaria, Çekia, Gjermania, Finlanda, por edhe SHBA. Njohja e përvojave dhe e modeleve mundësoi përzgjedhjen e modeleve që mund të funksionojnë në kontekstin e Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë.

Plani kohor i zbatimit të projektit, agjenda

I Janar – mars 2016: Përgatitja e projektit

- Ideimi i projektit
- Diskutimi i skicë-idesë së projektit
- Shkrimi i projekt-propozimit
- Fidbek për projekt- propozimin
- Paraqitja e kërkesës së projektit për miratim

II Prill – dhjetor 2016: Realizimi i projektit

- Miratimi i projektit
- Modifikimi i projektit sipas buxhetit të miratuar
- Fillimi i zbatimit të planit të veprimit
- Ngritja e grupeve të punës për secilin vend
- Njohja e përvojave ndërkombëtare për shkollën verore në edukim
- Përgatitja e instrumenteve të vlerësimit të nevojave
- Përgatitja e pyetjeve të fokus grupeve
- Përgatitja e pyetësorit për vlerësimin e nevojave të mësuesve/kandidatëve për mësues për zhvillim profesional dhe shkollën verore
- Përgatitja e skedës për vlerësimin e infrastrukturës
- Marrja e fidbekut për instrumentet e vlerësimit
- Përmirësimi i instrumenteve në bazë të fidbekut të dhënë
- Organizimi i fokus grupeve me mësues dhe studentë të mësuesisë në Tiranë
- Organizimi i takimeve të grupeve të punës sipas vendeve
- Plotësimi i pyetësorëve në të tre vendet: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni
- Përpunimi i të dhënave të pyetësorëve dhe analiza e gjetjeve
- Shkrimi i raportit të vlerësimit rreth nevojave të mësuesve/kandidatëve për mësues për zhvillim profesional në pesë fusha të përcaktuara dhe për shkollën verore
- Kontakte on line të grupit të punës nga të tre vendet për ecurinë e projektit
- Njohje e përvojave bashkëkohore për programin e kursit të shkollës verore
- Hartimi i linjave kryesore të programit të shkollës verore
- Përgatitja e programit të shkollës verore; identifikimi i temave kyçe
- Ideimi i strukturës së organizimit të shkollës verore
- Vlerësimi i mundësive të infrastrukturës mbështetëse për ngritjen dhe funksionimin e shkollës verore në tre vendet
- Vlerësimi i burimeve njerëzore dhe përgatitja e listës së lektorëve potencialë sipas vendeve dhe tematikës
- Përllogaritja e koston për shkollën verore

III Janar – mars 2017 Përmbyllja e projektit

- Përgatitja e broshurës së shkollës verore
- Fidbek për broshurën
- Takimi përmbyllës i projektit me grupin e punës së projektit në Tiranë
- Hartimi i raportit përfundimtar të projektit

Pjesa 2: Përshkrimi i veprimtarive; produktet dhe përfundimet e projektit

Në këtë pjesë të raportit do të përshkruajmë veprimtaritë që janë kryer në kuadër të projektit, do të prezantojmë produktet dhe do të paraqesim përfundimet.

1. Përcaktimi i pyetjeve kryesore për projektin

Siç e përmendëm edhe më lart, Projekti «Shkolla Verore në Edukim» u inicua mbi sugjerimin e pjesëmarrësve të konferencës së V-të të Rrjetit NEZI të organizuar në Tiranë në nëntor 2015 për ngritjen e një shkolle verore rajonale në edukim pasi pjesëmarrësit dhe disa vlerësime vendore kishin konstatuar se nevojat e mësuesve për zhvillim profesional ishin të mëdha dhe se potencialet infrastrukturore dhe akademike për të ngritur një shkollë verore rajonale ekzistonin. Në këto kushte lindën disa pyetje që kërkonin përgjigje dhe që projekti u dha përgjigje.

- a** Sa përqind e mësuesve kanë nevojë për zhvillim profesional?
- b** Sa të përgatitur janë mësuesit për të përballuar çështje që lidhen me fushat: edukimi për demokraci, edukimi ndërkulturore, pedagogjia e socializimit, kompetencat e nxënësit të shekullit të 21-të, kompetencat e mësuesit të shekullit të 21-të?
- c** Në ç'nivel shprehet nevoja e mësuesve për zhvillim profesional në fushat: edukimi për demokraci, edukimi ndërkulturore, pedagogjia e socializimit, kompetencat e nxënësit të shekullit të 21-të, kompetencat e mësuesit të shekullit të 21-të?
- d** Në ç'nivel shprehet nevoja e mësuesve për zhvillim profesional në çështje specifike që lidhen me fushat: edukimi për demokraci, edukimi ndërkulturore, pedagogjia e socializimit, kompetencat e nxënësit të shekullit të 21-të, kompetencat e mësuesit të shekullit të 21-të?
- e** Sa përqind e mësuesve kanë marrë pjesë në shkollë verore në edukim?
- f** Sa përqind e mësuesve e shikojnë shkollën verore rajonale si një mundësi për zhvillim profesional?
- g** Cilët faktorë shikohen si pengesë nga mësuesit për pjesëmarrje në shkollën verore?
- h** Cilat janë pritshmëritë nga shkolla verore?
- i** Cilat janë mundësitë infrastrukturore për mbështetjen e shkollës verore në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni?
- j** A ka potenciale akademike që mundësojnë realizimin e programit të shkollës verore?
- k** Çfarë kursesh mund të ofrojë shkolla verore?
- l** Të ç'formati mund të jenë kurset që do të ofrohen?
- m** Cila do të jetë struktura organizative e shkollës verore rajonale?

Këtyre pyetjeve iu dhanë përgjigje nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga fokuset grupe dhe organizuara në Shqipëri, nga anketimi i mësuesve të organizuar në tre vendet, nga

studimet dhe vlerësimet e kryera në tre vendet për zhvillimin profesional të mësuesve, nga hulumtimi i përvojave ndërkombëtare, nga vlerësimi i potencialeve akademike të vendeve të Rrjetit NEZI, nga vlerësimi i infrastrukturës në tre vendet.

2. Hulumtimi i përvojave ndërkombëtare të shkollave verore

Grupi i punës i projektit hulumtoi përvoja të shumta bashkëkohore për organizimin e shkollave verore, si përvojën e shkollave të verës në Evropë dhe SHBA, si të Shkollës së Verës në Edukim të Universitetit të Notinghamit; të Shkollës Verore të Pragës që organizohet nga Prague SCHOLA EMPIRICA, një OJQ e vendosur në Pragë; të Universitetit Veror të Universitetit të Evropës Qëndrore, Hungari; të Shkollës Verore Ndërkombëtare të Universitetit të Glaskout; të Shkollës Verore të Helsinkit të Universitetit të Helsinkit; të Shkollës Verore Ndërkombëtare Georg Arnhold për edukimin e qëndrueshëm; të Shkollës së Verës të Universitetit të Harvardit; të Universitetit të Prishtinës. Hulumtimi i përvojës u bë si për të njohur mënyrën e organizimit të shkollës verore, ashtu edhe për konceptimin e përmbajtjes së kursit. Përvojat e shumta e ndihmuan grupin e punës të kristalizojë vizionin për shkollën, të konceptojë formatin e kurseve dhe të strukturës organizative. Në hulumtimin e përvojave ndërkombëtare u përfshinë Nikoleta Mita, Merita Xhumari, Astrit Dautaj, Shqipe Gashi, Melinda Mula, Jonuz Abdullahi dhe Myqereme Rusi.

3. Hartimi i instrumenteve të vlerësimit

Për të realizuar vlerësimin e nevojave u përgatitën tre instrumente: pyetjet për fokus grupet, pyetësori për mësuesit dhe kandidatët për mësues, skeda e vlerësimit të infrastrukturës. Instrumentet u përgatitën nga ekipi i Shqipërisë nën drejtimin e Nikoleta Mita. Ekipet e Kosovës dhe të Maqedonisë dhanë fedback vlerësues për instrumentet. (Instrumentet gjenden në Broshurën e SHVRE)

3.1 Përgatitja e pyetjeve për fokus grupin

Pyetjet për fokus grupin janë pyetje orientuese për të bërë një listë me nevojat për zhvillim profesional dhe nevojat për shkollën verore. Ky instrument u parapa që të përdorej me mësues dhe studentë të mësuesisë.

3.2 Përgatitja e pyetësorit

Pyetësori për vlerësimin e nevojave për zhvillim profesional dhe ngritjen e shkollës verore u ndërtua si një instrument që i drejtohej mësuesve të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar, kandidatëve për mësues dhe studentëve të mësuesisë. Pyetësori përbëhet nga dy pjesë: pjesa e informacionit të përgjithshëm dhe pjesa që përmban pyetje për zhvillimin profesional nëpërmjet shkollës verore.

3.3 Përgatitja e skedës për infrastrukturën

Skeda për infrastrukturën e mundshme në shërbim të shkollës verore mbledh informacion për qytetin, lokalitetin për mësim, lokalitetin për akomodim, mundësitë për veprimtari sociale e kulturore.

4. Përdorimi i instrumenteve të vlerësimit

Tre instrumentet e përgatitur për të mbledhur informacion për projektin u përdorën në këtë mënyrë.

U zhvilluan dy fokus grupe. Një fokus grup u realizua me 12 mësues nga Tirana, ndërsa fokus grupi i dytë u realizua me 10 studentë të programit Master i Shkencave për Mësimdhënie në Shkencat Sociale në Universitetin e Tiranës. Informacioni i mbledhur shërbeu për të orientuar ndërtimin e pyetësorit për anketimin. Në bazë të diskutimit në fokus grupe u shtuan edhe dy fusha të zhvillimit profesional të argumentuara si fusha të nevojshme trajnimi për shkak të reformës së kurrikulës të bazuar në kompetenca, të ndërmarrë dy vitet e fundit. Pra, tri fushave të përcaktuara paraprakisht për shkollën verore iu shtuan edhe dy fusha të tjera: kompetencat e nxënësit të shekullit të 21-të dhe kompetencat e mësuesit të shekullit të 21-të.

Pyetësori u përdor me 180 mësues nga Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia me një shpërndarje të barabartë prej 60 mësues nga secili vend. Kampioni u përcaktua si një kampion me kuotë dhe ai përfshiu mësues të arsimit fillor, mësues të arsimit të mesëm të ulët, mësues të arsimit të mesëm të lartë dhe studentë të programeve të mësuesisë. Brenda numrit prej 60 mësuesish, secila kategori u përfaqësua me 15 të anketuar.

78% e kampionit janë femra dhe 22% janë meshkuj.

Përsa i përket grupmoshës së kampionit, 43% janë 20 – 33 vjeç; 30% janë 34 – 44 vjeç; 24% janë 45 – 55 vjeç dhe vetëm 3% janë midis 56 – 65 vjeç.

Ndërsa në lidhje me kohën e punës si mësues/mësues kandidat rreth 34% kanë nga 1 – 5 vjet; 15% e kampionit kanë 6 – 10 vite punë; rreth 28% kanë 11 – 20 vite dhe rreth 23% kanë mbi 20 vjet.

Pjesa më e madhe e tyre janë mësues me kohë të plotë (rreth 65% e kampionit), 25% janë kandidatë për mësues, 8% janë mësues me kontratë dhe 2% janë mësues me kohë të pjesshme.

Përsa i përket nivelit të arsimit, pjesa më e madhe e të anketuarve (46%) janë me arsimin e nivelit Bachelor; 30% janë me Master Profesional; 22% me Master të Shkencave dhe rreth 2% me Doktoratë.

Për procesin e anketimit në ndihmë të ekipit të secilit vend u aktivizuan nga dy bashkëpunëtorë të cilët kontaktuan të anketuarit, i udhëzuan sesi të plotësonin pyetësorin, administruan procesin e anketimit dhe regjistruan të dhënat sasiore në skedën përkatëse.

5. Përpunimi i të dhënave të pyetësorit për shkollën verore dhe analiza e të dhënave

Të dhënat e mbledhura nga pyetësorët u përpunuan nga ekipi i Shqipërisë, ku kontributin kryesor e dha Livia Nano, një bashkëpunëtoe e ekipit të Shqipërisë e cila bëri përpunimin e të dhënave me programin SPSS, përgatiti tabelat dhe grafikët si dhe bëri analizën dhe interpretimin e të dhënave. (Raportin e vlerësimit do ta gjeni në Broshurën e Shkollës Verore, ndërsa të dhënat statistikore i gjeni në Shtojca të këtij raporti).

6. Vlerësimi i infrastrukturës

Vlerësimi i infraskuturës u bë mbi bazën e skedës që plotësoi çdo vend dhe u ndërtua një tabelë me informacionin e sjellë nga tre vendet. (Shih tabelën për infrastrukturën në Broshurën e Shkollës Verore)

7. Vlerësimi i burimeve njerëzore

Vlerësimi i burimeve njerëzore përfshiu dy aspekte:

- a** Përcaktimin e kriterëve vlerësues për përzgjedhjen e lektorëve. Kriteret për përzgjedhjen e lektorëve ndodhen në Broshurën e Shkollës Verore.
- b** Identifikimin e lektorëve të mundshëm nga secili vend i Rrjetit NEZI të përfshirë në projekt dhe krijimin e listës së lektorëve sipas vendeve dhe tematikës së kurseve. Ekipi i secilit vend bëri një listë me kandidatët e mundshëm dhe më pas duke iu përmbajtur edhe kriterëve përzgjedhëse përzgjodhi 6 lektorë potencialë për shkollën e verës. Secili lektor prezantohet me foto dhe një CV të përmbledhur sipas një formati të njëjtë. Për listën e lektorëve nga Zvicra hasëm vështirësi pasi lektorët që u kontaktuan kishin shumë angazhime dhe nuk mund të angazhoheshin edhe në këtë projekt. Ne patëm gatishmërinë për t'u angazhaur në shkollën veore vetëm të tre lektorëve nga Zvicra. Por besojmë se ekipi nga Zvicra do të plotësohet në kohën e përgatitjes së projektit të zbatimit të shkollës së parë verore. Lista e lektorëve ndodhet në Broshurën e Shkollës Verore.

8. Hartimi i linjave kryesore të programit akademik dhe i formatit të programit të shkollës verore

Për hartimin e linjave kryesore të programit akademik të shkollës së verës, ekipi i tre vendeve u bazua në përvojën e hulumtuar të disa shkollave verore të ofruara nga universitete, organizata dhe agjenci të ndryshme, në gjetjet nga anketimi i mësuesve, në rekomandimet e dhëna nga anëtarët e ekipit dhe veçanërisht të Astrit Dautaj.

Pas diskutimeve të çështjeve parimore për programin, ekipi përgatiti tematikën për pesë kurse të shkollës së verës: edukimi qytetar demokratik, edukim ndërkulturor, pedagogjia e socializimit, kompetencat e nxënësit të shekullit të 21-të, kompetencat e mësuesit të shekullit të 21-të. Informacion më të zgjeruar do të gjeni në Broshurën e Shkollës Verore.

Bazuar në përvojat bashkëkohore të konsultuara dhe në nevojat e grupeve të mësuesve, studentëve dhe specialistëve që pritet të jenë pjesëmarrës, grupi i punës formuloi tre formate të kursit që kanë në fokus: zhvillimin profesional, zhvillimin e interesave kërkimore të pjesëmarrësve gjatë kursit, ndërtimin e platformave të politikave arsimore. Informacion më të hollësishëm për programin e kurseve, për formatin, metodologjinë do të gjeni në Broshurën e Shkollës Verore.

9. Skicimi i strukturës organizative të shkollës verore

Skicimi i strukturës organizative nuk ishte një çështje e lehtë. Dy pikat e vështira ishin statusi ligjor i shkollës dhe struktura organizative e saj. Pas diskutimeve të disa alternativave, grupi i punës e ideoi shkollën verore si Shkolla Verore Rajonale në Edukim (SHV-RE), si një bashkëpunim të pjesëmarrësve të Rrjetit NEZI dhe institucioneve të tilla si Shkolla e Lartë Pedagogjike e Zyrihut; Universiteti i Tiranës, IZHA (Shqipëri); Universiteti i Prishtinës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (Kosovë); Universiteti i Evropës Juglindore, dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës (Maqedoni). Vullneti i këtij bashkëpunimi mendohet të formalizohet nëpërmjet dokumentit të themelimit të Shkollës Verore Rajonale në Edukim dhe dokumentit të Memorandumit të Bashkëpunimit që do të formulohen si dokumente kur të konstituohet ky bashkëpunim. Në këto dokumente do të përcaktohet statusi ligjor i shkollës si dhe përgjegjësitë e të gjitha palëve për themelimin dhe funksionimin e Shkollës Verore Rajonale në Edukim. Hartimi i këtyre dy dokumenteve është parashikuar të kryhet në një fazë tjetër, që lidhet me projektin e themelimit të SHVRE.

Bazuar në përvojat bashkëkohore, ekipi ka përcaktuar edhe strukturën organizative të SHVRE sipas së cilës shkolla do të ketë një bord akademik, grupin e lektorëve dhe grupin e organizimit. Bordi akademik është organi drejtues i shkollës i cili merr vendimet më të rëndësishme, ndërsa grupi i lektorëve realizon programin akademik dhe grupi i organizimit merret me çështjet e menaxhimit të shkollës. Informacion më të detajuar do të gjeni në Broshurën e Shkollës Verore.

10. Hartimi i Broshurës së Shkollës Verore

Broshura e Shkollës Rajonale Verore është produkti kryesor i këtij projekti.

Ky dokument përmban raportin e vlerësimit të nevojave për shkollën verore rajonale, argumentimin e ngritjes së shkollës verore rajonale në edukim, statusin e kësaj shkolle, misionin, kriteret për programin akademik, formatin e kurseve, metodologjinë e kursit, tematikën e pesë kurseve të propozuara, orarin paraprak të kursit, informacion për certifikatën e kursit, procedurat e aplikimit për pjesëmarrje në shkollën verore, vlerësimin e mundësive infrastrukturore, kriteret për përzgjedhjen e lektorëve, një listë të lektorëve potencialë, buxhetin e parashikuar.

Ky dokument ka një informacion bazë i cili ndihmon për ngritjen e shkollës, por që mund të zhvillohet dhe të detajohet më tej në disa çështje që lidhen me statusin ligjor,

me programin mësimor të kurseve si dhe me procedurat e aplikimit të pjesëmarrësve kur të përgatitet projekti për hapjen e shkollës verore.

Për përgatitjen e broshurës së shkollës verore u angazhuan të gjithë anëtarët e grupit të punës. Në mënyrë të veçantë dhanë sugjerime të dobishme për çështje përmbajtësore Nikoleta Mita, Merita Xhumari, Shqipe Gashi, Jonuz Abdullahi dhe Mirëllinda Shala.

11. Përgatitja e buxhetit të shkollës verore

Grupi i punës punoi për hartimin e buxhetit të shkollës duke mbajtur parasysh mbulimin e të gjitha shpenzimeve me fonde të garantuara si dhe nivelin e jetesës së mësuesve dhe të studentëve në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Megjithatë, do të jetë Bordi akademik i SHVRE që do të marrë vendime lidhur me buxhetin konkret të shkollës verore në kohën e përgatitjes së projektit për hapjen e shkollës verore në edukim.

12. Përfundime dhe rekomandime

Përfundime nga anketimi:

a Nga analiza e të dhënave të pyetësorëve rezultoi se përqindje të larta të mësuesve kanë nevojë për zhvillim profesional në pesë fushat e përcaktuara të edukimit dhe më konkretisht:

- rreth 76% raportojnë se kanë një nivel mesatar dhe të lartë të nevojës për të marrë trajnime për kompetencat e nxënësit të shek. 21-të.
- 74% e mësuesve të anketuar kanë nivel mesatar dhe të lartë të nevojës për zhvillim profesional përsa i përket kompetencave të mësuesit të shek. 21-të.
- 68% e mësuesve raportojnë se kanë nivel të lartë dhe mesatar të nevojës për zhvillim profesional përsa i përket edukimit ndërkulturor dhe pedagogjisë së socializimit.
- rreth 67% janë mësuesit që raportojnë se kanë nevojë mesatare dhe të lartë për zhvillim profesional për edukimin për demokracinë.

Fushat e edukimit ku mësuesit kanë nevoja më të larta për trajnim renditen si më poshtë:

- kompetencat e nxënësit të shek. 21-të,
- kompetencat e mësuesit të shek. 21-të,
- edukimi ndërkulturor dhe pedagogjia e socializimit,
- edukimi për demokracinë.

b Mësuesit e lëndëve nga fushat: shkenca juridike, biznes, administrim, shkenca të natyrës, matematikë, statistikë, teknologji informacioni, kompjuter, elektronikë, konstruksion, mekanikë, punime dore, njohuri për bujqësinë, blegtorinë, peshkim, pyjet, kujdesi për shëndetin, shërbime kanë nevoja më të larta për zhvillim profesional në pesë fushat e përcaktuara të edukimit.

- c** Ka dallime në nevojat e mësuesve për zhvillim profesional sipas vendeve. Mësuesit e Shqipërisë rendisin në vend të parë nevojën për trajnim në fushën e kompetencave të nxënësit të shek. të 21-të dhe në vend të dytë nevojën për edukimin ndërkulturor. Mësuesit e Kosovës rendisin në radhë të parë nevojën për trajnim për kompetencat e mësuesit të shek. të 21-të, ndërsa në radhë të dytë vendosin nevojën për trajnim për kompetencat e nxënësit të shek. të 21-të. Mësuesit e Maqedonisë shprehin si nevojë të parë trajnimin për edukimin ndërkulturor dhe si nevojë të dytë edukimin për demokraci.
- d** Opinione të studentëve të programeve të mësuesisë dallojnë në disa aspekte nga ato të mësuesve në shërbim. Ata dëshmojnë përvoja të ndryshme nga ato të mësuesve për nevojën e trajnimit sipas fushave, për pjesëmarrjen në veprimtari të zhvillimit profesional, për pengesat për pjesëmarrje në shkollën verore dhe ky dallim diktohet nga formimi që ofron programi i studimit, vjen nga përvoja e pakët praktike, nga statusi civil i tyre si dhe nga këndvështrimi i tyre për çështjet.
- e** Vetëm 12% e të anketuarve raportojnë se kanë marrë pjesë në shkollë verore si veprimtari të zhvillimit profesional.
- f** Të anketuarit paraqesin si pengesa kryesore për pjesëmarrje në shkollë verore realizimin e shkollës gjatë pushimeve, organizimin e shkollës larg vendbanimit, angazhimet familjare, mungesën e mbështetjes nga drejtoria e shkollës dhe mungesën e një motivi për pjesëmarrje në shkollë verore.
- g** Të anketuarit e shikojnë shkollën verore si një mundësi për njohjen me praktikën më të mirë në edukim të cilat mund të përdoren në kontekstin e shkollës dhe të klasës dhe si një mundësi bashkëpunimi.
- h** Të anketuarit vlerësojnë si një alternativë me përfitime të shumfishta organizimin e një shkolle verore rajonale në edukim.
- i** Të anketuarit preferojnë kohëzgjatjen prej një jave si të përshtatshme për shkollën verore.
- j** Të anketuarit vlerësojnë se shkolla verore u sjell atyre përfitime që lidhen me njohjen e praktikave më të mira, me ndërmarrjen e roleve të reja për nismat për zhvillimin e shkollës dhe për përmirësimin e veprimtarisë mësimdhënëse.

Përfundime të tjera

- a** Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia kanë kapacitete infrastrukturore mjaft të mira me disa alternative për organizimin e shkollës verore.
- b** Rrjeti NEZI ka kapacitete humane për ta mbështetur programin akademik, drejtimin dhe menaxhimin e shkollës. Por për programin akademik mund të ftohen edhe lektorë nga vende të tjera jashtë Rrjetit NEZI.
- c** Është e nevojshme që SHVRE të aplikojë për njohje të programeve akademike nga autoritetet zyrtare të arsimit në mënyrë që certifikata dhe kreditet që ajo do të japë të mund të përdoren lehtësisht sipas interesave të pjesëmarrësve.

Rekomandime

1. Në bazë të vlerësimit të nevojave, kryer përmes pyetësorit, informacionit të mbledhur nga fokus grupet dhe përfundimet e raporteve kombëtare të kërkimit dhe vlerësimit, rekomandojmë hapjen e Shkollës Verore Rajonale në Edukim (SHVRE) si një alternativë për të nxënë të vazhdueshëm për mësuesit, kandidatët për mësues, specialistët e arsimit dhe studentët e mësuesisë dhe të shkencave të edukimit.
2. SHVRE të jetë një organizim i Rrjetit NEZI me partneritetin e institucioneve të tilla si Shkolla e Lartë Pedagogjike e Zyrihut; Universiteti i Tiranës, IZHA (Shqipëri); Universiteti i Prishtinës, Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë e (Kosovë); Universiteti i Evropës Juglindore dhe Universiteti Shtetëror i Tetovës (Maqedoni). Ajo të shfrytëzojë sinergjinë e të gjithë bashkëpunëtorëve të këtij rrjeti dhe të institucioneve që ata përfaqësojnë.
3. SHVRE të realizohet çdo vit në një nga vendet: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni.
4. Tematika për të cilën mësuesit e anketuar të një vendi kanë shprehur nevojën më të madhe për trajnim, të jetë objekt i kursit veror të SHVRE në atë vend.
5. Programi konkret i SHVRE të përgatitet duke patur parasysh kategorinë e pjesëmarrësve. Kështu një program mund të përgatitet për mësuesit në shërbim dhe specialistët e edukimit, ndërsa një program tjetër mund të përgatitet për studentët e programeve të mësuesisë dhe shkencave të edukimit, ndërsa një program i tretë mund të përgatitet për studentët doktorantë në fushën e edukimit.
6. SHVRE të përdorë disa lloje formatesh: për zhvillim profesional, për zhvillim të interesave kërkimore të pjesëmarrësve, për ndërtimin e platformave të politikave arsimore.
7. Organizmi i SHVRE të bëhet mbi bazën e dokumenteve ligjore dhe pedagogjike.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me Projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Projekti e realizoi qëllimin e tij për identifikimin e nevojave për zhvillim profesional dhe ngitjen e një shkolle verore në edukim. Në sajë të projektit u konceptua ngritja e shkollës verore dhe u hodhën piketa për shumë çështje të themelimit, funksionimit dhe menaxhimit të saj. Por, mendohet se ka disa çështje të hapura.

1. Çështja e statusit të shkollës. Kërkohej që të përcaktohet qartë se cili do të jetë roli i NEZI-it dhe i institucioneve partnere për themelimin dhe funksionimin e SHVRE.
2. Çështja e dytë lidhet me hartimin e detajuar të programeve akademike të kurseve të shkollës. U mendua që programet e detajuara të hartohen vit pas viti në varësi të përcaktimit të tematikës dhe audiencës të cilave do t'u kushtohet shkolla verore. Kështu programet do të jenë më të aktualizuara dhe më të përshtatshme. Ky është një vendim që do të merret nga Bordi akademik i SHVRE.
3. Çështja e tretë lidhet me zgjedhjen e tematikës së shkollës së parë. Është e rëndësishme që të zgjidhet tematika e cila mund të realizohet me sukses të plotë në mënyrë që të jetë garanci për vijimin e kurseve të tjera të SHVRE.
4. Çështja e katërt që është e hapur është ajo e grupit të lektorëve. Natyrisht që një listë me lektorët potencialë ekziston, por ajo duhet plotësuar me lektorë nga Zvicra dhe vende të tjera të Evropës, pse jo edhe më gjerë.
5. Çështja e pestë lidhet me njohjen zyrtare të programit dhe të certifikatës së kursit nga vendet prej të cilave vijnë pjesëmarrësit. Njohja zyrtare do ndihmojë njohjen e certifikatës dhe transferimin e krediteve.
6. Politika dhe kriteret për pranimin e pjesëmarrësve nga vende të tjera është një çështje që duhet të ketë një zgjidhje.
7. Buxheti është një pikë tjetër që kërkohej të përcaktohet konkretisht kur të hapet shkolla verore në bazë të kostove të vendit ku do të zhvillohet shkolla dhe të kategorisë së pjesëmarrësve. Çështja e tarifës së pjesëmarrjes kërkon diskutim të mëtejshëm, veçanërisht nëse do të pranohen pjesëmarrës nga vende të tjera.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Veprimtaria për zbatimin e projektit është realizuar sipas tri fazave të paraqitura në pjesën e parë të këtij raporti:

I Faza e parë, e përgatitjes së projektit

Gjatë kësaj faze grupi i punës punoi për hartimin e projektit.

II Faza e dytë – zbatimi i projektit

Faza e dytë është faza kryesore e kryerjes së vlerësimit, e mbledhjes së informacionit nëpërmjet instrumenteve të ndryshme, e skicimit të linjave kryesore të shkollës si organizëm dhe të programeve të kurseve që pritet të ofrojë.

Gjatë kësaj faze u krye hulumtimi i përvojave bashkëkohore për shkollat verore në edukim, u përgatitën instrumentet e vlerësimit të nevojave dhe të mundësive infrastrukturore. Instrumentet u përgatitën nga grupi i Shqipërisë, ndërsa u recensionuan nga grupi i Kosovës dhe i Maqedonisë. Gjatë kësaj faze u krye vlerësimi i nevojave të mësuesve për zhvillim profesional dhe për ngritjen e shkollës verore. U vlerësuan kapacitetet infrastrukturore dhe akademike. I gjithë grupi i punës skicoi elementet kryesore të përmbajtjes dhe të organizimit të shkollës verore.

Gjatë kësaj faze anëtarët e grupeve të punës nga të tre vendet Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni zhvilluan takime brenda vendit, mbajtën një komunikim on-line intensiv për shkëmbimin e literaturës, për përzgjedhjen e modeleve për shkollën verore, për dhënien e fidbekut për instrumentet, për mbledhjen e të dhënave, për përzgjedhjen e lektorëve dhe për përzgjedhjen e infrastrukturës mbështetëse. Bashkëpunimi ishte intensiv dhe i frytshëm.

III Faza e tretë, e përmbylljes së projektit

Gjatë kësaj faze u hartua Broshura e Shkollës Verore Rajonale në Edukim, si produkti kryesor i projektit. Në hartimin e projektit mori pjesë i gjithë grupi duke përgatitur pjesë të caktuara të broshurës dhe duke recensionuar punën e kryer. Pra, të gjithë u përfshinë në të dyja proceset në role të ndryshme. Secili vlerësoi punën e kryer nga kolegu. Në këtë fazë u krye takimi përmbyllës i projektit në Tiranë.

Mund të vëmë në dukje se ndarja e roleve dhe detyrave të grupeve dhe brenda grupeve ishte e efektshme dhe funksionoi shumë mirë. Kjo përvojë dëshmoi se ne mund të punojmë shumë mirë në ekip, të plotësojmë njëri-tjetrin, të vlerësojmë punën e kryer objekti-visht dhe profesionalisht

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtarë


Përvoja e këtij projekti dëshmon se:

- Ideja e Rrjetit NEZI për të ndërmarrë projekte të vogla rajonale rezultoi e qëlluar. Projektet që janë kryer nga pjesëmarrësit e këtij rrjeti kanë qenë të suksesshme, kanë krijuar sinergji, kanë zhvilluar kapacitete, kanë sjellë ndryshime, kanë hapur vizione të reja, kanë vendosur dhe konsoliduar bashkëpunime.
- Mendojmë se suksesi i projekteve të realizuara është garanci për vazhdimin e projekteve të filluara. Kjo do të bëjë të mundur që ndikimi i projekteve të shtrihet më gjerë e më thellë për të sjellë ndryshime më të mëdha në cilësinë e arsimit. Kjo do të bëjë të mundur të rritet numri i përfituesve nga projektet. Kjo do të bëjë të mundur që bashkëpunimi të konsolidohet dhe të bëhet më i efektshëm.
- Si projektet midis dy vendeve edhe ato midis tre ose më shumë vendeve janë të mirëpritura. Për mendimin tonë projektet me pjesëmarrjen e shumë vendeve janë më të efektshme pasi përfituesit janë më të shumtë, krijojnë mundësi për njohje të më shumë përvojave, krijojnë mundësi për ndërveprim më të gjerë.
- Ne do të rekomandonim fort mbështetjen e projektit të ngritjes së Shkollës Verore Rajonale në Edukim, si një projekt që do të mirëpritej, që do të ofronte një alternativë që i mungon, por që i duhet si Shqipërisë, Kosovës dhe Maqedonisë. Mendojmë se mbështetja e këtij bashkëpunimi si një bashkëpunim i disa vendeve është e dobishme, pasi veçmas asnjëri nga vendet nuk do të kishte aq sukses. Projekti me pjesëmarrjen e shumë vendeve ka si çelës suksesi sinergjinë.

SHTOJCA

Kopertina e broshurës për Shkollën Verore Rajonale në Edukim

PDF-I integral I broshurës mund të kërkohet te prof. dr. Nikoleta Mita (nikoleta.55@yahoo.com) ose te prof. dr. Rolf Gollob (rolf.gollob@phzh.ch)



6 Ngritja e një partneriteti ndërkombëtar (IPATE)

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuksi i Projektit (Përgjegjësi kryesor):

- Miriam Aegerter, docente IZB, Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug
- Shukrije Ramadani, Drejtoreshë e Qendrës Kulturore Shqiptare, Zvicër dhe Kosovë

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Zvicra:

- Miriam Aegerter, docente IZB, Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug
- Andrea Müller, bashkëpunëtorë shkencorë IZB, Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug
- Oxana Ivanova-Chessex, bashkëpunëtorë shkencorë IZB, Shkolla e Lartë Pedagogjike Zug

Kosova/Zvicra:

- Shukrije Ramadani, Drejtoreshë e Qendrës Kulturore Shqiptare, Zvicër dhe Kosovë

Shqipëria:

- Prof. Dr. Nikoleta Mita, Universiteti i Tiranës

Shënim:

Oxana Ivanova-Chessex së bashku me Shukrije Ramadanin në maj 2016 shkuan në Kosovë dhe Shqipëri për të njohur institucione të mundshme për partneritet me shkollat e larta. Andrea Müller ishte përfshirë në vizitën e kthimit në nëntor 2016 në PH Zug dhe mori përsipër zhvillimin e mëtejshëm të partneritetit (partneriteteve), si pasardhësie e Miriam Aegerter. Përveç kësaj në Projekt ishin të përfshirë rektorë, profesorë, koordinatorë të zyrave ndërkombëtare si edhe docentë të tjerë.

Buxheti:

- Fr. 10'000.-


Qëllimet e Projektit

Shënim paraprak, hyrje

Raporti përmbyllës i paraqitur përmbledh arsyet dhe aktivitetet (kapitulli 1) si edhe përfundimet e Projektit (Kapitulli 2) «Ngritja e një partneriteti ndërkombëtar të shkollave të larta (IPATE)», i cili është rezultat i Projektit vijues nga «Rrjeti i kulturës së parë, së dytë dhe ndërkulturës: Për dinamikën e rritjes në dhe midis sistemeve të ndryshme normash dhe referimi» (shkurt: NEZI). Përveç kësaj, në kapitullin e tretë, raporti përmbyllës përfshin çështjet e pazgjidhura si dhe vazhdimin e Projektit dhe në kapitullin 4 merret me përshkrimin e procesit të punës. Së fundi, jepen propozime për faza të ngjashme thellimi dhe konsolidimi në lidhje me projekte shumëkombëshe.

Miriam Aegerter, Shukrije Ramadani dhe Nikoleta Mita ishin pjesëmarrëse të NEZI-it dhe në konferencën e fundit, që u zhvillua në nëntor 2015 në Tiranë, vendosën për të nisur së bashku një Projekt vijues me titullin «Ngritja e një partneriteti ndërkombëtar për shkollat e larta – International Partnership in Teacher Education (IPATE)».

Më poshtë gjeni draftin e parë të ideve që lindi në Konferencën e Tiranës.



Në fund, kjo shfaqje e mendimeve u diskutua dhe u përpunua dhe së fundi Miriam Ae-gerter dhe Shukrije Ramadani në fund të janarit 2016 i paraqitën një kërkesë për projekt Qendrës për Projektet Ndërkombëtare në Arsim (IPE) të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih. Kjo kërkesë për projekt u miratua nga fundi i shkurtit 2016 nga IPE..

Qëllimet e Projektit, lidhje me qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

Qëllimi kryesor i Projektit ishte eksplorimi i interesave dhe mundësive për një partneritet me shkollat e larta midis një institucioni kosovar dhe/apo shqiptar për arsimimin e mësuesve dhe të Shokollës së Lartë Pedagogjike Zug dhe së fundi përfundimin e një Memorandumi të Mirëkuptimit midis universiteteve «të duhura». Ky Memorandum i Mirëkuptimit (më poshtë e përmendur edhe si «Marrëveshja e Përgjithshme») duhet të përmbajë ide të mundshme të bashkëpunimit, për shembul aktivitetet e shkëmbimev, projekte të përbashkëta kërkimore, etj.

Në Projekt-kërkesën u përshkrua po ashtu lidhja me qëllimet e Projektit NEZI. Nga njëra anë, Ideja e formuluar e Projektit duhet të mbështeste shkëmbimin e fokusuar dhe, nga ana tjetër, të inicioje një bashkëpunim të qëndrueshëm (të dyja qëllimet e NEZI-t). Përveç kësaj, duhet të mbështetej të kuptuarit reciprok të vendit, të njerëzve, shkollës, mësimit, metodave të mësimdhënies etj. Nga Projekti pritej që partneritetet ndërkombëtare të shkollave të larta të kishin një ndikim të rëndësishëm në dialog, që është me rëndësi vendimtare për jetën në shekullin XXI si edhe tregojnë respekt të ndërsjellë.

Plani kohor, agjenda

Plani kohor dhe agjenda mund të realizohej, me rregullime të vogla në kohë, në përputhje me kërkesën (Shih tabelën më poshtë).

Kush	Kur	Çfarë
Miriam & Shukrije (Nikoleta)	04.12.2015 deri në fund të janarit 2016	Përgatitjet e Projekt-kërkesës diskutimi, kërkesa (në Cyrih, Altstetten), Kërkesa gjermanisht/shqip
Miriam	30.1.2016	Dorëzimi i kërkesës së Projektit Rolf Gollob & Basil Schader (PHZH)
Shukrije	26.1.2016	Shukrija shkon për sqarimet e para në Kosovë (Gjilan), diskuton idetë/kërkesën me Rektorin, Ministrinë apo partnerë të tjerë të mundshëm
IPE (Rolf)	28.2.2016	Vendimi për pranimin e kërkesës së Projektit
Shukrije, Nikoleta, Miriam	Pas vendimit pozitiv	Sqarime të mëtejshme: Cilët mund të jenë partnerët e përshtatshëm? P. sh. Universiteti i Tiranës, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Gilanit apo të tjerë.
Miriami (personi i IZB), Shukrija apo Nikoleta, si edhe persona të tjerë	Mars/prill 2016	Fillimi i realizimit të Projektit Vendimi me kë bëhen sqarime të tjera (→ Universiteti i Gilanit, Universiteti i Tiranës, Universiteti i Durrësit), planifikimi i vizitave reciproke
Shukrije & Oxana	Maj 2016	Vizita e universiteteve në Gjilan, Tiranë dhe Durrës
Personat e Universitetit të Gilanit dhe Tiranës	Dhjetor 2016	Vizitë e ndërsjelltë në PH Zug
Andrea & personat e Universitetit të Gilanit	Dhjetor 2016 / janar 2017	Drafti dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Përgjithshme
Miriam & Andrea	20 mars 2017	Dorëzimi i raportit përmbyllës tek Rolf Gollob (IPE, PHZH)
PH Zug dhe shkolla e larta partnere në Gjilan	Gjatë 2017	Aktivitetet e para
PH Zug dhe Uni-versiteti i Tiranës	Gjatë 2017	Hartimi i mundshëm dhe nënshkrimi i një Memorandumi

Pjesa 2: Përshkrimi i pyetjeve dhe përfundimet e projektit

Pyetjet

Siç u përmend në pjesën 1, në qendër të Projektit qëndronte eksplorimi i interesave dhe mundësive për një partneritet universitar midis një institucioni kosovar dhe/apo shqiptar për trajnimin e mësuesve dhe të Shkollës së Lartë Pedagogjike të Zug-ut.

Prandaj, është thënë që në një hap të parë të nxirret, se cilat shkolla të larta kosovare dhe/apo shqiptare, ofrojnë kurse për trajnimin e mësuesve dhe kështu mund të konsiderohen si institucione partnere. Përveç kësaj u mor edhe me pyetjen se në cilat fusha, për aq sa mund të përputhet përshtatja, mund të bashkëpunohet (në Memorandumin e Për-bashkët të marrëveshjes është e dukshme).

Përfundimet e Projektit

Projekti mund të vlerësohet në përgjithësi si shumë pozitiv. Plani i Projektit mundi të zbatohej siç ishte planifikuar dhe si edhe u zhvilluan vizita të ndërsjella të përfaqësuesve të shkollave të larta përkatëse.

Në maj Oxana Ivanova-Chessex dhe Shukrije Ramadani vizituan Universitetin Kadri Zeka të Gjilanit, universitetet në Tiranë (University of Tirana) dhe të Durrësit (Universitetin «Aleksander Xhuvani» Durrës). Karakteristikat që janë krijuar për shkak të këtyre vizitave, treguan që bashkëpunimi me të tri universitetet e vizituara paraqet pa dyshim një përfitim për Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug.

Diskutimet e brendshme në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug, krijuan mundësi për partneritet me universitetet e Gjilanit dhe të Durrësit, por u pa edhe nevoja për të ruajtur bashkëpunimin me Nikoleta Mitën nga Universiteti i Tiranës, meqë ajo është një aktore e njohur dhe me përvojë në (peizazhin) e arsimit në Shqipëri dhe Kosovë.

Miriam Aegerter përpiloi në vjeshtë të 2016, në dakortësi me të ftuarit, një program të vizitave, për vizitën e kthimit në PHZ, që u zhvillua nga 1–2 dhjetor 2016. Qëllimi i vizitës ishte njohja reciproke personale si edhe njohja me Shkollën e Lartë Pedagogjike si institucion për kualifikimin e mësuesve në Zvicër. Përveç kësaj duhet të bëheshin negociata për një marrëveshje të mundshme midis Zug-ut dhe Gjilanit si edhe të përcaktohej një udhërrëfyes për veprime të mëtejshme.

Qëllimet u arritën, nëpërmjet asaj që bashkëpunëtorë të ndryshëm të PH Zug i shkëmbyen me miqtë dhe në këtë mënyrë i njohën. Përveç kësaj, gjatë vizitës dyditore ka pasur inpute të ndryshme (p.sh. për sistemin arsimor zviceran, për të trajnuar në PH Zug, për shkollën e planifikuar verore dhe «serinë e leksioneve» në Universitetin e Gjilanit, për fushat kryesore të hulumtimit në Universitetin e Tiranës.). Përveç kësaj, miqtë e ftuar kishin mundësi të vizitonin një shkollë fillore lokale si edhe të organizonin disa takime (p.sh. në Universitetin e Cyrihut).



Bruno Leutwyler (drejtor F&E, PH Zug), Shukrije Ramadani, Bajram Kosumi (rektor i Universitetit Kadri Zeka, Gjilan), Brigit Eriksson (rektoreshë PH Zug), Nikoleta Mita (Universitet Tirana), Miriam Aegerter, Luljeta Berisha (Head of International Office Universitët Kadri Zeka), Dukagjin Leka (Vize-Rektor Universiteti Kadri Zeka)

Me interes të veçantë ishte informacioni nga Nikoleta Mita, Universiteti i Tiranës, që në fushën e arsimit të fëmijërisë së hershme dhe të arsimit fillor janë duke u ngritur programe të reja studimi në Bachelor dhe Master. Sapo të kenë filluar këto programe, mund të merren me përgatitjen e një Memorandumi të Përbashkët për Mirëkuptim. Lucia Amberg (Drejtuese për studimet bazë në PH Zug) vazhdon shkëmbimin profesional me Nikoleta Mitën.

Lidhur me universitetin e Durrësin nuk mundën të arriheshin qëllimet, meqë Rektorja e Universitetit (Kseanela Sotirofski) për arsye personale, nuk mundi të marrë pjesë në vizitën e kthimit dhe ndërkohë nuk ka pasur kontakte të tjera, bashkëpunimi i mundshëm është i pezulluar përkohësisht.

Si përfundim i kësaj vizite të kthimit mund të përmblihet se të gjithë pjesëmarrësit e vlerësuan programin e zhvilluar dhe morën shumë inpute interesante. Përveç kësaj, çështjet për diskutim, të formuluara në program, mundën të diskutoheshin në detaje. Në vizitën e kthimit u ra dakort për hapa të mëtejshëm, si më poshtë, për zhvillimin e një «Marrëveshjeje të Përbashkët të Përgjithshme» midis Universitetit Kadri Zeka (Gjilan) dhe PH Zug:

1st draft → 12th of Dec 2016
prepared by
UKZ
PH Zug → 1st part Jan 2017
feedback

30th Jan → final version
of MoU between
UKZ & PH Zug
↳ to Albania FYI

Ndërkohë është paraqitur «Marrëveshja e Përgjithshme» (Memorandumi i Mirëkuptimit) midis të dy shkollave të larta dhe është nënshkruar nga të dy universitetet.

Nga të dy anët u identifikuan më tej ide për projekte të mundshme, që mund të përpunoheshin së bashku në periudhën kohore të tri viteve të ardhshme. Hapat e ardhshëm janë tani një planifikim i përbashkët, tek i cili do të jetë përfshirë edhe Zyra për Marrëdhëniet Ndërkombëtare e PH Zug. PH Zug synon ngritjen e një shkollë verore me partnerë të ndryshëm në Evropën Juglindore. Një Workshop i përbashkët për planifikim, në të cilin mund të identifikoheshin dhe diskutoheshin ide të ndryshme, duket se është një fillim i përshtatshëm për procesin e bashkëpunimit të mirë dhe të qëndrueshëm.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Pyetja zotëruese, e cila u kristalizua nga bashkëpunimi në këtë Projekt ishte: Si mund të ndërtohet një partneritet në një shkollë të lartë, të marrë jetë, dhe që të mos zhvillohet sipas një modeli të njohur? Presioni për të justifikuar pse pikërisht ky partneritet që ende, «nuk po përshtatet në mënyrë ideale», kjo për shkak se atje nuk ka ofertë në gjuhën angleze. Përparësi dhe kusht kyç për një ngritje dhe zbatim të një partneriteti të tillë.

Një pyetje ngacmuese do të ishte, se çfarë ndryshimesh duhet të kalojnë nëpër një shkollë të lartë në Zvicër në mënyrë që të «përballet» me një partneritet të tillë dhe që kjo mundësi partneriteti, të mund të përdoret me kuptim për të dyja palët.

Hapat e parë drejt një partneriteti me Universitetin e Gjilanit janë bërë dhe ka edhe ide për bashkëpunim në hapësirë. Kështu është hedhur themeli dhe kështu do të duket se si mund të zbatohen partneritetet në praktikë. Zbatimi i ideve dhe fushat e bashkëpunimit ekzistojnë së pari në letër, vullneti për të bashkëpunuar është, megjithatë është ende e paqartë, se në cilat fusha bëhet me të vërtetë një bashkëpunim. Në raundin e parë të grumbullimit të ideve ka dalë, se jo vetëm brenda të dy institucioneve, por edhe midis institucioneve parapëlqehen qasje të ndryshme. Kështu duhet të hartohet një kalendar i përbashkët për projekte dhe ndërkohë nuk mund të lihet jashtë vëmendjes mundësia që rrugët institucionale në dy institucionet mund të jetë ndoshta me gjatësi të ndryshme.

Një pyetje tjetër, që është pezull, është ajo e interesit: Si është kërkesa sipas ofertës së përpunuar tek studentët dhe docentët? A ka interes tek institucionet për një vizitë studimore apo një shkollë verore? A janë ata të gatshëm për të bërë përpjekje shtesë dhe për të marrë përsipër aktivitete ekstra-kurrikulare? Si mund të jetë më tërheqëse pjesë-marrja në këto projekte të shkëmbimit? Meqë partneriteti me universitetet në fjalë nuk do të zhvillohej sipas një modeli të njohur, në fillim rezistuan disa aktorë të Shkollës së Lartë Pedagogjike në Zug dhe duhej të bindeshin midis tyre.

Edhe me nënshkrimin e «Marrëveshjeve së Përgjithshme» me shkollën e lartë, partneriteti ekziston vetëm në letër dhe ka ende shumë punë për ta mbushur me aktivitete këtë partneritet. Gjithashtu këtu mbeten ende pezull shumë pyetje: për shembull duhet të kërkohen mënyra të reja për mbikëqyrjen e studentëve dhe të mundësohet një integrim kuptimplotë kurrikular i aktiviteteve të partneritetit.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Elementët thelbësorë në procesin e punës ishin vizitat e ndërsjella: Oxana Ivanova-Chessex dhe Shukrije Ramadani vizituan në maj 2016 Universitetin e Gjilanit (Universitetin Kadri Zeka) si edhe universitetet në Tiranë (Universiteti i Tiranës) dhe në Durrës (Universitetin «Aleksandër Moisi» Durrës). Vizita e kthimit të delegacionit nga Gjilani dhe Nikoleta Mita nga Tirana ishte një gur i dytë bazë, i rëndësishëm për suksesin e Projektit.

Në vazhdim të vizitave u hartuan profilet për shkolla e larta përkatëse, për të vlerësuar në mënyrë sistematike perspektivat për bashkëpunim. Doli që një fokus ose një theksim në varësi të prioritetëve, është i kuptueshëm partneriteti me universitetet përkatëse. Kështu Universiteti i Gjilanit tregoi një interes të madh për një shkëmbim studentësh dhe docentësh. Për shkak të përputhjeve të profilit të të dy shkollave të larta (të dy arsimojnë ndër të tjera mësues për nivelin e kopshtit / shkalla e ulët dhe për shkolla fillore), ky drejtim i bashkëpunimit u provua si një prioritet.

Ndërsa Universiteti i Tiranës u shfaq si një shkollë e lartë me një profil të fortë në hulumtimin e shkencave sociale dhe arsimore. Për këtë arsye, këtu u diskutuan bashkëpunimet e hulumtimit si një drejtim i veçantë. Në Universitetin e Durrësit u diskutuan zhvillimet e reja nën mbikëqyrjen e studentëve gjatë fazave të praktikës si një drejtim shumëpremtues për bashkëpunim, në të cilin mund të bëhej një mësim reciprok.

Vizita nga njëra anë hedh prioritetet e përbashkëta të zhvillimit dhe të punës si edhe motivimin reciprok për një bashkëpunim. Por në të njëjtën kohë, sugjeron një sfidë, e cila është karakteristike për partneritete të tilla në shkolla të larta dhe shpesh përjetohet si një pengesë për ngritjen e partneritetit: Në të tri shkollat e larta, mësimi ofrohet në gjuhën e vendit përkatës, gjë që vështirëson pjesëmarrjen e ndërsjellë të studentëve në këto oferta për arsimim dhe po ashtu një llogaritje të rregullt të rezultateve. Përkundrajt këtij sfondi, gjatë vizitave të para si edhe gjatë vizitave të kthimit, u kërkua sipas formateve, vendeve dhe hapësirave, që do të mundësonte një bashkëpunim të arrirë partneriteti (edhe në këto kushte të vështira). Kështu u diskutuan vizitat shqëruese studimore të lidhura me tema për grupe të ndryshme qëllimi, shkolla të përbashkëta verore për studentët, oferta të përbashkëta për kualifikimin dhe aktivitete të Projektit.

Këto parashqyrtime krijuan një bazë të mirë për një vlerësim të shëndoshë në lidhje me bashkëpunimin e mundshëm të të dyja palëve.

Në verën e vitit 2016 u zhvilluan diskutime të brendshme në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug me përgjegjësit për arsimimin, me Zyrën për Ndërnacionalizimin dhe Zyrën për Marrëdhënit Ndërkombëtare. Karakteristikat u sqaruan dhe u diskutuan në aspektin e potencialeve për një bashkëpunim me PH Zug. U vendos që partneritetet mund të zgjidhen vetëm në nivelin e mobilitetit të personelit (Universiteti i Tiranës) fillimisht nuk

mund të vazhdohet. Me të dy shkollat e larta të Gjilanit dhe Durrësit duhet të kryhen sqarime të mëtejshme. Bindëse dhe e mundur dukej në shikimin e parë një bashkëpunim në kuadrin e vizitave studimore (javën e zgjedhjeve), vizita studimore si ofertë në kuadrin të ofertave për kualifikimin apo aktivitetet e përbashkëta në kuadrin e një shkolle verore apo të leksioneve me specialistë.

Në dhjetor 2016 u realizua vizita e kthimit, në të cilën duhet të zhvilloheshin negociata të mëtejshme për një bashkëpunim. Vizita ishte një mundësi e mirë për të përfshirë persona të tjerë në Shkollën e Lartë Pedagogjike, e cila ishte e përfshirë në një partneritet të mundshëm. Nga ana e PH Zug u shfrytëzua rasti për të paraqitur dhe përfshirë Andrea Müller, bashkëpunëtore shkencore në IZB, e cila e mori përsipër përgjegjësinë për vazhdimin e Projektit, që nga 1 nëntori. Vizita e delegacioneve nga Kosova dhe Shqipëria ishte koha ideale për këtë transferim. Së bashku, mund të zhvilloheshin hapat e ardhshëm për partneritetet. U pa se një takim personal është një bazë e rëndësishme për bashkëpunim konstruktiv. Universiteti i Gjilanit dërgoi tre përfaqësues në Zug.

Përveç Rektorit ishte prezent edhe zëvendës-Rektori, si edhe znj. Luljeta Berisha, që është përgjegjëse për Zyrën me Marrëdhëniet Ndërkombëtare. Ky përfaqësim i nivelit të lartë mund të interpretohet si një shprehje e rëndësisë së Projektit për Universitetin „Kadri Zeka“ në Gjilan. Me znj. Shukrije Ramadani ishte përfshirë një ndërmjetës i mirë, që e njeht shumë mirë si Kosovën dhe Shqipërinë dhe që gëzon një besim të lartë nga të gjitha palët. Nga ana e PH Zug mund të fitohej Rektori për një input, si edhe Lucia Amberg, drejtore të Studimeve për Arsimin. E rëndësishme ishte edhe paraqitja e përgjegjësit të Zyrës për Marrëdhëniet Ndërkombëtare të PH Zug, Patrick Pfeuffer.

Patrick Pfeuffer është në bashkëpunim të mëtejshëm krahas Andrea Müller, përgjegjëse për partneritetet me shkollat e larta dhe do të marrë një rol të rëndësishëm në nivelin administrativ. Një kontakt i parë personal, i cili del nga të shkruarit me Email, është shumë i rëndësishëm për një bashkëpunimin të mëtejshëm. Siç përkthehet më sipër, këto kontakte personale janë veçanërisht të rëndësishme, meqë në institucione shumë gjëra kërkohen me punë bindëse dhe krijuese për të mundur këto partneritete, të cilat nuk mund të realizohen në kuptimin tradicional të një shkëmbimi të studentëve.

Vizita e kthimit në PH Zug ka treguar se Projektit nga ana e institucioneve i jepet rëndësi e ndryshme. Në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug internacionalizimi si edhe partneritetet me universitetet në Evropën Juglindore kryesisht nuk konsiderohet si një projekt i të gjithë institucionit, por i është dhënë Institutit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në çështjet e arsimit IZB dhe Zyrës për marrëdhënie ndërkombëtare.

Në të kundërt Universiteti i Gjilanit ka dërguar me Rektoren dhe zëvendës-rektorin të gjithë personelin e të gjithë universitetit. Është treguar që ftesa e përfaqësuesve të zgjedhur nga PH Zug nga fusha të ndryshme (Rektori, Drejtoria për Studimet, Arsimin, Drejtoria i Institutit për Hulumtim dhe Zhvillim) ishin të rëndësishme për t'i krijuar kuadrin e nevojshëm vizitës.

Një prirje për të tilla shenja të nënkuptuara i shërbejnë bashkëpunimit, sepse kështu mund të parandalohen keqkuptimet dhe zhgënjimet. Në të ardhmen është e rëndësishme të përfshihen aktorë të ndryshëm të PH Zug në aktivitete formale dhe joformale, për të lehtësuar takimin dhe dialogun me partnerët dhe për të implementuar gjerësisht partneritetin edhe në institucion.

Vizita u realizua nga kontakti me email, i cila ka funksionuar në mënyrë të përkryer. Gjithashtu, në vijim të vizitës u shkëmbyen mesazhe falënderimi që tregojnë një vizitë të suksesshme si edhe marrëveshjen e ndërsjellë për bashkëpunim të mëtejshëm.

Plani kohor, i rënë dakort për krijimin e «Marrëveshjes së Përgjithshme», u respektua dhe kështu Marrëveshja mundi të nënshkruhej menjëherë. Vetëm me Rektorin e Universitetit të Durrësit komunikimi u ndërpre. Pas anulimit në minutën e fundit për vizitën në Zug, komunikimit nuk është rifilluar deri tani.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtarë

Për procesin e mësipërm të punës dhe pyetjet e hapura, nxjerrim dy elemente, që nga perspektiva jonë janë të dobishme për suksesin e Projektit. Këto mund të interpretohet si propozime.

Për procesin e mësipërm të punës dhe pyetjeve të hapura, nxjerrim dy elemente. Shpesh komunikohet përmes emailit në projekte shumëkombëshe, shpesh në gjuhën angleze, gjë që në rastin tonë, për të dy partnerët, nuk është gjuha e parë. Projekti ka treguar se ky komunikim me shkrim ka funksionuar shumë mirë. Bazën për këtë shkëmbim me shkrim e krijuan kontaktet personale që Miriam Aegerter me Shukrije Ramadani dhe Nikoleta Mitën mundën të krijonin nëpërmjet rrjetit NEZI. Për më tepër Oxana Ivanova-Chessex vizitoi shkollat e larta dhe mundi të lidhte kontakte, mbi të cilat më pas do të mund të kryhej përgatitja për vizitën e kthimit.

Edhe vizita e kthimit mundëson shkëmbimin formal si dhe joformal dhe njohjen e aktorëve të ndryshëm. Sipas mendimit tonë kjo ngritje sistematike e besimit dhe e kujdesit për kontakt, luante një rol të rëndësishëm për suksesin e Projektit dhe për përgatitjen në kohë dhe për nënshkrimin e një marrëveshjeje.

Për bashkëpunimin e mëtejshëm duhet që të vazhdojnë të merren parasysh kjo pikë. Nga ana e Shkollës së Lartë Pedagogjike Zug si qëllim për të ardhmen është një projekt i përbashkët me partnerë të ndryshëm në Evropën Juglindore.

Mënyra e punës duhet të ruhet, për të gjetur dhe për të shkëmbyer në një takim/workshop personal mënyrën e përbashkët të punës. Nga kjo, ne shpresojmë një bazë të mirë për një Projekt afatgjatë me partnerët e rinj që të përhapet në të gjithë shkollën e lartë.

Si rekomandimin e dytë shohim procedurën për ngritjen e një partneriteti të shkollave të larta në kuptimin e një «praktike të mirë». Përfshirja institucionale e partneritetit të shkollave të larta me Universitetin e Gjilanit në hapësirën tashmë ekzistuese, «grupi migracionit» që në Shkollën e Lartë Pedagogjike Zug përfshin një radhë prej partneriteteve të Shkollave të Larta që plotësojnë kriteret e taktuara, që është një faktor i rëndësishëm, për të kontribuar në suksesin e Projektit.

Meqë Universiteti i përgjigjet kriterive të grupimit «Migrimi», (një destinacion në vendet e origjinës e shumë emigrantëve që jetojnë dhe veprojnë në Zvicër, që janë përfshijë me stereotipe të ngritura në Zvicër), mund të gjenden argumente të mira, se përse ka kuptim ky partneritet i shkollave të larta.

Vendimmarrësit mund të fitohen për këtë partneritet, në faktin që u shfaqën partneriteti i ri në lidhje me qëllimet strategjike të grupimit. Përfshirja në grup ndihmon gjithashtu vetë institucionit për të klasifikuar partneritetin dhe për t'i lidhur direkt me qëllimet e synuara, të cilat janë në lidhje me grupimin. Më tej, nëpërmejt kësaj lidhjeje mund të përdoren sinergji me partneritete të tjera, si për shembull në shkollën e synuar verore në bashkëpunim me shkolla të ndryshme të larta në Evropën Juglindore.

7 Dokumentimi videografik për mësimin shqip të gjuhës së prejdardhjes (MGJP) në katër vende

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesi i Projektit (Përgjegjësi kryesor):

- Prof. Dr. Dr. Basil Schader, PH Cyrih

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Kosova:

- Nuhi Gashi, Prishtinë; përgjegjës për mësimin shqip të gjuhës së prejdardhjes në Ministrinë e Arsimit të Republikës së Kosovës

Zvicra, grupi pa origjinë shqiptare:

- Basil Schader, PH Cyrih/IPE

Zvicra, grupi me origjinë shqiptare:

- Nexhat Maloku, ish-Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Mësuesve dhe Prindërve «Naim Frashëri» në Zvicër, koordinator i mësimin shqip të gjuhës së prejdardhjes në Kantonin e Cyrihut, bashkëpunëtor i Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih

Buxheti:

- Fr. 8'000.-

Qëllimet e Projektit

Objekti i Projektit është ngritja e përmbledhjes të sekuecave të videove për MGJP-në shqip në Zvicër (dy nënprojekte, në Zvicrën gjermanisht- si dhe frëngjishtfolëse), në Gjermani, Austri, Angli dhe Suedi.

Qëllimi është që kjo përmbledhje e sekuecave të videove të mund të përdoret për ilustrimin dhe diskutimin e aspekteve të ndryshme në aktivitetet kualifikuese dhe informuese të shoqatave të mësuesve dhe të prindërve dhe të ministrive të arsimit të Kosovës dhe të Shqipërisë (p. sh. Vështrim në jetëshkrimet e mësuesve të MGJP-së, në sekuecat tipike të mësimit, në të sjellurit në mësimin me shumë klasa, në përdorimin e dygjuhësisë etj.).

Përmbledhja e shtrirë në çdo kohë, përfshin tani 50 sekuenca filmash të renditura mirë tematikisht dhe të shtjelluara në një udhëzues. Ato shkojnë deri në rreth 30 regjistrime të gjata, prej të cilave fragmente pjesërisht tematike, u bënë të disponueshme si dosje më vete.

Sigurisht u morën lejet e përdorimit dhe të filmimit të mësuesve dhe nxënësve pjesëmarrës. Dokumentacioni, në rast nevojë, u vihet në dispozicion me një USB përgjegjëse të interesuar për arsimin nga hapësira shqipfolëse. (Për hapësirën gjermanofolëse u referohemi skenarëve kualifikues etj. Përmbledhjes së zgjeruar «Materiale hyrëse dhe shoqëruese për materialet e MGJP –së», të cilat janë të disponueshme tek IPE (<https://phzh.ch/de/ipe/>).

Në bazë të kërkesës, përdorimi i përmbledhjes mund t'u jepet drejtuesve të kurseve dhe hulumtuesve të interesuar, nëpërmjet IPE-së. Duke pasur parasysh të drejtat personale të nxënësve të regjistruar nuk është e mundur një qasje e lirë, jo e autorizuar nga IPE-ja.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

(Referuar kapitullit 3 (Qëllimet dhe pikat e forta të rrjetit) të dokumentit bazë të 23.7.2013.)

Projekti është në lidhje të ngushtë me qëllimet e mëposhtme të dokumentit bazë:

- Shkëmbim përvoja etj. midis grupeve pjesëmarrëse: Përmbledhja e planifikuar e shembujve videografikë dhe e impulseve për diskutim, lejon shkëmbimin e përvojave, madje përtej kuadrit të vërtetë të rrjetit. Të disponueshme janë si impulse për ilustrim dhe diskutim, shembuj autentikë nga pesë vende apo shtatë mësues të MGJP-së.

- Projekti është në lidhje të ngushtë me qëllimet e Konferencës IV të NEZI-t në Cyrih, në qendër të së cilës qëndronte edhe mësimi i gjuhës së prejardhjes. Kërkesat e kësaj Konference të pranuar pozitivisht, thellohen fort nëpërmjet Projektit të paraqitur.
- Qëllimet «Të njohurit e thelluar reciprok», «Qëndrueshmëria» dhe «Lidhja», mbështeten nëpërmjet Projektit të paraqitur dhe tejkalohen të paktën në vështrim të aspektit të MGJP-së, sepse këtu ftohen edhe grupe të reja të përparuara.

Përveç kësaj, nga Projekti rezultojnë edhe sinergji me hartimin e një baze të të dhënave të ngjashme, por të profilizuara ndryshe për përdorimin në aktivitetet kualifikuese të institucioneve arsimore zvicerane (dhe të tjera të Evropës Perëndimore) (Kalimi nëpërmjet IPE-së në Shkollën e Lartë Pedagogjike Cyrih, shiko sipër)..

Plani kohor, agjenda

I Janar – mars 2016

Hartimi i konceptit për regjistrimet: Përcaktimi i pikave tematike kyçe, të cilat duhet të dokumentohen. Gjetja e mësuesve të MGJP-së tek të cilët mund të filmohet apo të organizohet vetë regjistrimet, sipas përcaktimeve të qarta.

II Prill – nëntor 2016

Regjistrimi dhe hartimi i sekuencave të videove, duke pasur parasysh punët e mëposhtme:

- Përkthimi/titrat, atje ku janë të nevojshme.
- Montazhi i filmave, sqarimi se cilat sekuenca do të regjistrohen të përmbledhura në përmbledhje dhe cilat pjesë sekuencash duhet të përzgjidhen më tej si dokumenta të izoluar të temave të përcaktuara.
- Hartimi i një vështrimi/ ndihmëhyrëse, komentuar për sekuencat me udhëzimet për kryerjen e aktiviteteve kualifikuese dhe informuese. (Vendin e një vështrimi vetjak e përfaqëson këtu udhëzuesi për përmbledhjen e gjerë të materialeve për broshurat e reja të MGJP-së, për një përkthim shqip, u hoq dorë duke pasur parasysh para së gjithash, përdorimin në kontekstin gjerman të MGJP-së dhe për njohuritë e gjermanishtes të partnerit kosovar Nuhi Gashi, si edhe për arsye shpenzimesh.

III Dhjetor 2016 – janar 2017

Punime përmbledhëse, vënia në dispozicion e produkteve të gatshme (USB, komentare për hapjen dhe kryerjen) Raport përmbledhës për Projektin.

Pjesa 2: Përshkrimi i pyetjeve dhe përfundimet e projektit

Përmbledhje e shkurtër

Si pikënisje ishte pyetja, se si mund të sigurohej një media e realizueshme ndërkombëtarisht, që t'u shërbej aktiviteteve informuese dhe kualifikuese për mësuesit e mësimit shqip të gjuhës së prejdardhjes dhe, për rrethe të tjera të interesuara, ilustrimit të diskutimit të fokusuar në stimulim.

Si një zgjidhje shumë e mirë u provua sistemi i një përmbledhjeje të sekuencave të videove për aspekte të ndryshme të MGJP-së. Në këtë kuptim u bënë rreth 50 regjistrime në Zvicër, Gjermani, Austri, Angli dhe Suedi, të cilat janë të përfshira nëpërmjet një udhëzuesi apo broshure. Punët e para në aktivitete të ndryshme tregojnë, që një media e vlefshme dhe stimuluese është në dispozicion dhe që kontribuon për reflektimin kritik dhe përmirësimin e mësimit të gjuhës së prejdardhjes nëpërmjet konkretësisë dhe autenticitetit.

Pyetjet

Si pyetje qëndrore të Projektit vijues NEZI «Dokumentimi i videos për mësimin shqip të gjuhës së prejdardhjes» janë për t'u përmendur si më poshtë:

1. Si mund të sigurohet një media dhe material, që të provojnë të jetë autentikë dhe stimulues për ilustrimin, dokumentimin dhe diskutimin e aspekteve të ndryshme të mësimit shqip të gjuhës së prejdardhjes (MGJP), në kuadrin e aktiviteteve kualifikuese dhe informuese?
2. Si mund të merren në konsideratë kontekste të ndryshme kombëtare, të lidhura me sisteme shkollore dhe kulturore, në të cilat MGJP-ja shqip zhvillohet në vende të ndryshme të migrimit? (Vetëm nëse kjo kërkesë është e shpenguar, media e planifikuar mund t'ia adresojë sfondin e përvojës mundësisht shumë mësuesve të mësimit të gjuhës së prejdardhjes dhe të përshtatet për një përdorim të gjerë në vende të ndryshme).
3. A mund të përdoren në Projektin e përmendur sinergji me materiale të ngjashme konkretizimi, si të ishin të dobishme dhe të dëshirueshme në Zvicër (por dhe në Gjermani dhe Austri), në kontekstin e aktiviteteve informuese dhe kualifikuese për MGJP-në në përgjithësi (që do të thotë pa u kufizuar në MGJP-në shqip)?
4. Dhe së fundi: Si mund të sigurohet një media e tillë me një çmim dhe material në një farë mase të favorshëm me gjithë pretendimet e listuara sipër?

Duke pasur parasysh pyetjet e përmendura, u kristalizua shpejt si e dobishme që një dokumentim videografik i MGJP-së shqip në vendet e përzgjedhura, plotësuar me një dokument të komentuar përmbljedhës, të çon në rastin më të mirë, në një përgjigje të mirë para së gjithash të pyetjeve 1 dhe 2 si edhe për zgjidhjen e qëllimeve të bëra të njohura (për pyetjet 3 dhe 4, shiko poshtë)

Qëllimet

Qëllimet e kësaj përmbljedhjeje apo të Projektit - pjesë të paraqitur mund të përmblidhen si më poshtë (shiko edhe sipër pjesa 1):

Duhet të kryhet një përmbljedhje e sekuencave të videove të renditura tematikisht për mësimin shqip të gjuhës së prejardhjes (MGJP).

Këto sekuenca duhet t'u shërbejnë ilustrimit dhe konkretizimit të aspekteve pedagogjike, didaktike dhe metodologjike përkatëse në aktivitetet informuese dhe kualifikuese për dhe nga mësuesit shqiptarë të MGJP-së. Njëkohësisht ato duhet t'i ofrojnë një publiku të gjerë (ministrive, autoriteteve të arsimit, specialistëve në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, prindërve etj.), një vështrim të përgjithshëm në MGJP-në shqiptare, pikat e saj kyçe si edhe fushat e saj problematike. Duke vështruar në pyetjen 3, në përgjithësi duhet të përdoren sinergji në mënyrë intensive dhe me kosto të shpëtuar me një projekt të ngjashëm për MGJP-në, që Shkolla e Lartë Pedagogjike Cyrih/IPE e ka filluar paralelisht (shiko poshtë). Dhe në funksion të pyetjes 4 (shpenzimet) duhet që shumica e të ardhurave të bëhet natyrisht në bazë të udhëzimeve të qarta, mundësisht autonome, prej mësuesve të MGJP-së në vend.

Këto qëllime janë të lidhura ngushtë me qëllimet e përgjithshme të rrjetit NEZI (shih edhe më lart), por MGJP-ja mund të kontribuojë në mënyrë pozitive të konsiderueshme në krijimin e dinamikës së rritjes brenda dhe në mes të dy kulturave, do të thotë në kuptimin e një identiteti të balancuar dykulturore-dygjuhësh.

Thellë u fut në këtë temë Konferenca IV e NEZI-t (7–8 maj 2015 Cyrih), ku ndër të tjera vizita në shkollë, në klasat e MGJP-së siguruan njohuri autentike dhe mbresëlënëse. Përmbljedhja e sekuencave të videove për MGJP-në, së bashku me mjetet e siguruar nën drejtimin e IPE-së, mund të japë një ndihmesë të vlefshme para së gjithash në aktivitetet informuese për reflektimin dhe ngritjen e MGJP-së.

Procedura, zbatimi

Në hapin e parë janar deri mars 2016 ekipi i drejtimit të Projektit (Basil Schader, grupi CH pa origjinë shqiptare; Nuhi Gashi, Kosovë, Nexhat Maloku, grupi i Zvicrës me origjinë shqiptare), zhvilloi një koncept përmbajtësor (se çfarë duhet të dokumentohet, shiko poshtë). Pastaj u kërkuan mësuesit e duhur të MGJP-së në Zvicrën gjermanofolëse dhe frankofone, në Gjermani, Austri, Suedi dhe Angli. Këtu u treguan si të vlefshme veçanërisht kontaktet e mira personale dhe njohuritë e Nuhi Gashit si kompetent për MGJP-në për pjesën e Ministrisë kosovare të Arsimit dhe të Nexhat Malokut, si përgjegjës i MGJP-së në Zvicër. Në të gjitha këto vende apo rajone gjuhësore mundën të gjendeshin mësuesit, të cilët u deklaruan të gatshëm për regjistrimin dhe që nga një katalog kërkuan përmbajtjet që u përshtateshin atyre (për shembull, përqendrimi «trajnim i integruar gjuhësor», «përdorimi i dygjuhësisë»).

Në përparësitë e zgjedhura, mësuesit pjesëmarrës merrnin një «skenar» të detajuar me sugjerime, se në çfarë mënyre dhe në çfarë hapësire kohore mund të dokumentohej në film. Përveç sekuencave të dokumentuara të mësimit, iu kërkua të regjistrohej një koment i shkurtër i jetëshkrimit së tyre dhe i punës së tyre si mësues i MGJP-së. Të gjithë mësime të pjesëmarrës morën një buxhet prej 1250 franga për blerjen e një video-kamere, këmbalec për videokamerën dhe një kartë memorieje, për të mbuluar pagesën e një kameramani të trajnuar apo të një kameramaneje, si edhe shpërblimin personal. (Përfundim: Regjistrimet në kantonin e Cyrihut (Wallisellen) u bënë prej një kameramani të Shkollës së Lartë Pedagogjike)

Para fazës aktuale të filmimit duhej që të gjithë mësuesit të merrnin pëlqimin me shkrim të prindërve të nxënësve të tyre dhe të shikonim se çfarë paraqiste probleme. Faza aktuale e zbatimit (regjistrimi i filmit) zgjaste nga prilli deri në tetor 2016, pra pak më e gjatë se sa ishte planifikuar fillimisht. Arsyeja për këtë është se pas arritjes së sekuencave filmike nga Anglia, Suedia dhe Austria, u pa se për disa aspekte të përshtatshme (diferencimi i brendshëm, të sjellurit me situatën e shumë klasave), ishte i dëshirueshëm një dokumentacion konciz apo shembuj të tjerë. Sekuencat përkatëse janë marrë në vjeshtën e vitit 2016 në Këln dhe në Bern, ku Basil Schader ra dakord në mënyrë të detajuar për regjistrimet me mësuesit e përfshirë dhe madje vetë ka punuar si një kameraman.

Nga tetori 2016 ishin të gjitha regjistrimet dhe filloi editimi. Sekuenca të gjata të ndryshme mund të ndaheshin mirë në pjesë sekuencash të fokusuara shkurt tematikisht, kështu që pothuajse munda të mbulohej e gjithë gama e përparësive të deklaruara fillimisht. Paralelisht me prerjen sekuencave u përgatitën me titra edhe në gjermanisht, jo me pamje nga projekti ekzistues, vijues NEZI (i cili është me të vërtetë i orientuar drejt një publiku shqipfolës), por në kontekstin e Projektit të Shkollës së Lartë Pedagogjike/ IPE «Materiale për mësimin e gjuhës së prejardhjes», të cilit duhet t'i vihen në dispozicion të njëjtat materiale (shih më poshtë) dhe që kontribuoi ndjeshëm në financim.

Në periudhën nga dhjetori dhe deri në janar 2017 pasuan punimet përmbledhëse, përfundimi i materialeve, bërja e disponueshme në USB, udhëzuesi i komentuar (vetëm në gjermanisht), sqarimi i konteksteve të para të përdorimit dhe prezantimet, raporti përmbyllës.

Përfundime, «Produkti» i projektit

Si rezultat i Projektit - pjesë të NEZI-t është tashmë në dispozicion një përmbledhje e shumëllojshme e 49 sekuencave të videove, të cilat japin një pasqyrë shembullore për MGJP-në shqiptare, të shtatë mësuesve në pesë vende (Zvicra, Gjermania, Austria, Anglia, Suedia). Kjo përmbledhje plotësohet me tetë imputet me informacione në sfond, këto sekuenca u regjistruan me rastin e Kongresit të NEZI-t në 8 maj 2015 në Cyrih. Përmbledhja (që e kemi në dispozicion në një USB tek drejtuesit e Projektit dhe në IPE të

Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih) ndahet në fushat e mëposhtme tematike:

Pjesa I: Informacionet në sfond (Sekuencat prej 5 – 25 minutash, të inçizuara gjatë takimit IV të grupit NEZI, maj 2015)

1. Sistemi shkollor zviceran dhe MGJP-ja në Zvicër (Regina Bühlmann, EDK)
2. Kujtime të një ish -nxënëses së MGJP-së (Melani Alilaj)
3. MGJP-ja shqiptare në Zvicër: historia, organizimi, planifikimi (Nexhat Maloku, mësues i Shoqatës Shqiptare të Mësuesve dhe të Prindërve)
4. Rëndësia e MGJP-së nga këndvështrimi i vendit të prejardhjes. (Nuhi Gashi, Kosovë)
5. Kur, deri në çfarë mase dhe për çfarë qëllimi është e suksesshme MGJP-ja? (Anja Giudici, Universiteti i Cyrihut).
6. Kurrikula e Shkollës së Lartë Pedagogjike (Claudia Ulbrich, Drejtoria për Arsimin Cyrih dhe Nexhat Maloku)
7. Për organizimin e MGJP-së në Suedi (Rizah Sheqiri, Suedi)
8. Mendimet për profesionin e mësuesit të MGJP-së (Rizah Sheqiri, Suedi)

Pjesa II: Shembuj nga praktika për aspekte të përzgjedhura (në shumicën e rasteve sekuenca të shkurtra)

1. Mësuesit e MGJP-së prezantohen (6 sekuenca)
2. Vështrim në një sekuençë MGJP-je (6 sekuenca)
3. Fokusi. Lidhja me botën e nxënësve (1 sekuençë)
4. Fokusi. Përkrahja e gjuhës së integruar / puna me gjuhën në gjuhën e parë (11 sekuenca).
5. Fokusi. Rrjeti i gjuhës së parë/së dytë (6 sekuenca)
6. Fokusi. Qortimi i orientuar për përkrahje (3 sekuenca)
7. Fokusi. Të sjellurit ndaj pyetjeve, drejtimi i bisedës dhe kultura (5 sekuenca).
8. Fokusi Strategjitë e të mësuarit (1 sekuençë).
9. Fokusi. Mësimi me shumë klasa, organizimi i mësimit (5 sekuenca)
10. Fokusi. Individualizimi (2 sekuenca)
11. Fokusi. Alfabetizim (dygjuhësh) (1 sekuençë).
12. Fokusi. Ritmi gjatë mësimit/integrimit i momenteve me lojë (2 sekuenca).

Një mjet ndihmës i rëndësishëm për përdorimin e materialeve është doracaku («Materiale për mësimin e gjuhës së prejardhjes: Materialet hyrëse dhe shoqëruese»). Për çdo sekuençë ai përmban të dhënat për gjatësinë, origjinën dhe një përmbledhje të shkurtër të përmbajtjes, si edhe, aty ku është e nevojshme, vërejtje të mëtejshme ose referenca. Në mënyrë të ngjashme çdo sekuenca i janë shtuar pyetjet dhe impulset për diskutim dhe thellim.

Këto mund të përdoren direkt në aktivitetet informuese dhe kontribuojnë në një angazhim më të thellë dhe më të fokusuar me sekuenat e videove. Doracaku është i disponueshëm vetëm në gjuhën gjermane, për arsye financiare është hequr dorë nga përkthimi në shqip. Meqë përmbledhja duhet të përdorej në radhë të parë në hapësirën gjermanofolëse apo në Kosovë, ku bashkëpunëtori i Projektit Nuhi Gashi po ashtu zotëron gjermanishten, duke i përligjur ky kursim.

Për të plotësuar mbetet që doracaku përmban, krahas teksteve të lartpërmendura për hapjen e sekuenave të videos, gjithashtu edhe skenarë për aktivitetet informuese dhe kualifikuese, prezantime PowerPoint etj. Këto janë të lidhura ngushtë me serinë e materialeve didaktike për MGJP-në, të cilat IPA në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Cyrih, i ka botuar nën drejtimin e Basil Schader dhe që janë të pranishme edhe në përkthimet për pesë gjuhë të mëdha të migrimit (shqip, gjuhë boshnjake / kroatisht / serbisht, turqisht, portugalisht, anglisht).

Në rezultatet përfundimtare të Projektit- pjesë llogariten tashmë edhe përdorime konkrete të përmbledhjes së sekuenave të videove të kryera apo të planifikuara për vitet 2017/18. Për t'u përmendur këtu janë aktivitetet shumëpjesëshe për mësuesit shqiptarë të MGJP-së në Zvicër dhe Austri (në kontekstin e serisë së re mësimore, një aktivitet infor-

mues për specialistë dhe për ministritë në Kosovë (Shkurt 2017) dhe simpoziumi i madh i përvitshëm i organizuar nga Ministria e Arsimit e Republikës së Kosovës i mësuesve shqiptarë të MGJP-së në një prej vendeve shqipfolëse (prezantimi dhe diskutimi i vitit 2017).

Në mënyrë të veçantë përdorimet e sekuencave filmike në aktivitetet kualifikuese për mësues të MGJP-së dëshmojnë që regjistrimet në fakt janë një mjet i vlefshëm, kur vjen puna për konkretizimin e aspekteve të caktuara dhe kur është fjala për impulse për diskutimet në fjalë.

Sinergji me Projektin e PH / IPE «Materiale për mësimin e gjuhës së prejardhjes»

NEZI Projekti vijues «Dokumentimi i videove për MGJP-në shqip në katër vende» ka përfituar në mënyrë të plotë nëpërmjet përdorimit të sinergjive me Projektin IPE-së, financuar nga Zyra Federale për Kulturën dhe Fondi Lotari i Kantonit të Cyrihut «Krijimi i materialeve didaktike për mësimin e gjuhës së prejardhjes».

Në kuadrin e këtij Projekti dhe të projekteve të tij vijuese, u krijua nga njëra anë një doracak me bazat e pedagogjisë aktuale të Evropës Perëndimore dhe Veriore, të didaktikës, të metodologjisë si edhe pesë libra me sugjerime konkrete për fusha të ndryshme përkatëse të punës të MGJP-së si edhe u përkthyen në pesë gjuhë të mëdha të migrimit (shih <https://phzh.ch/de/ipe/Projekte-und-Mandate/Europaweite-Projekte/Materialien-fur-den-herkunftssprachlichen-Unterricht/>).

Në të njëjtën kohë kanë qenë dhe janë ofruar aktivitete informuese dhe kualifikuese shumëpjesëshe për këto materiale. Meqë edhe në këtë kontekst shembuj ilustrues dhe impulset për reflektimin dhe diskutimin e tyre ishin një dëshirë urgjente, u bënë një sinergji e frytshme me Projektin vijues NEZI dhe në të njëjtën kohë, ishin një lehtësim i konsiderueshëm financiar për këtë: Sekuencat e videove të regjistruara në klasat e MGJP-së shqip së bashku me udhëzuesit përkatës, përbëjnë një themel të fortë për përdorimin e aktiviteteve kualifikuese me mësuesit e grupeve të tjera gjuhësore, të cilët shihen të balafuar me të njëjtat sfida të pavarura nga gjuha.

Natyrisht, duhet dhe do të zgjerohet përmbledhja duke parë rrethin e zgjeruar si edhe sekuencat e grupeve të tjera gjuhësore të MGJP-së; Regjistrimet e para në klasat kroate dhe portugeze janë kryer tashmë 2016 nën drejtimin e Katja Schlatter dhe Rita Tuggener (PH Cyrih)

Probleme, shqyrtim kritik (vështrim prapakritik)

Pa dyshim, në përgjithësi Projekti ka qenë shumë i suksesshëm. Suksesin e tij e dëshmojnë edhe përdorimet e sekuencave të videove që janë bërë deri tani në kuadrin e aktiviteteve të ndryshme (shih më lart) që vazhdimisht u hasën me një rezonancë shumë pozitive. Rezultate jo krejtësisht të kënaqshme çuan në regjistrimet e hartuara nga mësuesit e pyetur të MGJP-së.

Edhe pse udhëzimet ishin shumë të detajuara dhe të qarta, disa sekuenca nuk dokumentojnë plotësisht atë që dëshirohej, disa do të ishin madje pak të përdorshme si shembuj negativë (për diskutim, megjithatë, mjaft pjellore). Që me procedurën e zgjedhur lidhej një rrezik i caktuar, kjo gjë ka qenë e qartë që në fillim. Megjithatë, një shoqërim i plotë i të gjitha regjistrimeve do të kishte tejkaluar plotësisht kuadrin financiar të Projektit. Një kufizim i regjistrimeve të shoqëruara vetëm në Zvicër, nuk diskutohej, pasi fokusi u vendos qëllimisht në vende të ndryshme të MGJP-së.

Si qortuese e mirë në fushat e dokumentuara jokënaqshëm, dolën në fund të Projektit regjistrimet e bëra në Bern dhe në Këln, ku drejtuesi i Projektit fillimisht kreu një plan të detajuar me mësimdhënësit në fjalë dhe ishte i pranishëm vetë në regjistrime apo i kreu këto si kameraman.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me Projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Projekti çoi në një përfundim të mirë dhe në disa njohuri metodologjike. Këtu mendohet sigurisht që në qendër të regjistrimeve të videove është i domosdoshëm një udhëzim mundësisht i plotë, por që në raste të veçanta nuk ofron asnjë garanci absolute të suksesit. Vazhdimisht vetëm regjistrimet e shoqëruara (diskutuar me detaje paraprakisht) të bëhen mundësisht me ndihmën e përdorimit të kamerës profesionale, do të ishte pa dyshim e parapëlqyer, por për fat të keq, është e lidhur edhe me kosto shtesë të konsiderueshme. Një sfidë tjetër metodologjike ishte dhe është formulimi i udhëzimeve mundësisht të qarta, por në të njëjtën kohë, nuk duhet të jetë manipuluese. Një diskutim i këtyre çështjeve (dhe e të tjerave) me përfaqësues të projekteve të ngjashme, do të ishte i frytshëm.

Lidhje pune në pritje direke, nuk ka, por kuptohet që përmbledhja e shembujve të videove mund dhe duhet të shtohet në mënyrë të qëndrueshme. Këtij qëllimi i shërben edhe doracaku, me shtojcën e tij, me qëllim të qartë, të drejtuar për shtrirje dhe zgjerim. Nëse jo, në kuadër të Projektit vijues aktual NEZI, atëherë në kontekstin e projekteve të IPE-së do të bëhet pa diskutim një zgjerim për MGJP-në dhe materialet e saj. (apo tashmë ka filluar, shih më lart). Pyetje dhe pikënisje nga Projekti dalin jo në një kuptim direkt,

megjithatë, është e qartë se përmbledhja e gjerë e videove mund të jetë një vend i vlefshëm dhe autentik për projekte të tjera.

Kjo ka të bëjë, nga njëra anë me projektet dhe problemet në të cilat bëhet fjalë për mësimin e gjuhës së preardhjes, për metodologjinë dhe didaktiken e tij për pozicionimin e tij në sisteme të ndryshme shkollore. Të frytshme janë regjistrimet në fokusin e përvetësimit të gjuhës së parë në mjedis shumëgjuhësh, dygjuhësh dhe orientimit në dhe ndërmjet të parës dhe gjuhës së vendit. Për këtë qëllim, përmbledhja ofron shembuj të panumërt shume stimulues dhe mbresëlënës nga vende të ndryshme dhe kontekste të sistemeve shkollore.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Në hapat e punës, shih më lart, paraqitja e detajuar në kapitullin 1 (plani kohor, agjenda). Tri fazat e punës së Projektit përfshinin a) konceptimin e procedurës (përcaktimin e përparësive tematike, konceptimin e udhëzuesit; gjetjen e mësimdhënësve të përshtatshëm të MGJP-së, përpunimin e të dhënave për të njëjtën gjë), b) Regjistrimet aktuale në klasa të ndryshme të MGJP-së në katër vende (nganjëherë të pashoqëruara, ndonjëherë të shoqëruara) dhe c) përgatitja dhe plotësimi i materialit së bashku me udhëzuesin përkatës. Projekti – pjesë u drejtua nga përfaqësues të grupit Zvicër pa origjinë shqiptare (Basil Schader, drejtuesi i Projektit), Nuhi Gashi (Kosovë) dhe Nexhat Maloku (grupi i Zvicrës me origjinë shqiptare). Bashkëpunimi i Nuhi Gashit, i cili përgjigjet nga ana e Ministrisë së Arsimit të Kosovës për MGJP-në shqiptare në tërë diasporën dhe për organizimin e konferencave të përvitshme kualifikuese të mësuesve shqiptarë të MGJP-së, garanton dhe mbështet para së gjithash përzgjedhjen e mësuesve të përshtatshëm të MGJP-së në Suedi, Gjermani, Austri dhe Angli dhe ndihmon për të lidhur kontaktet përkatëse. Nexhat Maloku, po ashtu si ish-president i Shoqatës Shqiptare të Mësuesve dhe Prindërve në Zvicër «Naim Frashëri», disponon kontakte të shkëlqyera dhe lidhje në Zvicër dhe mund të kontribuonte duke mbështetur përzgjedhjen e mësuesve të përshtatshëm. Bashkëpunimi i bashkëpunëtorëve të të tri grupeve u bë pjesë në tri fazat e para të projektit (konceptimi, kontaktet, etj.). Meqenëse të tre ata që përgjigjen njihen prej një kohe të gjatë dhe kanë bashkëpunuar në projekte të tjera të ndryshme, u krye sipas pritshmërisë shumë efiçiente dhe pa probleme.

Organizimi i regjistrimeve aktuale, si dhe përpunimi i sekuencave të videove u bë kryesisht nga Basil Schader. Kjo gjë argumentohej plotësisht me atë që në këto dy faza ishte

i nevojshëm një bashkëpunim i ngushtë me Projektin IPE «Krijimi i materialeve didaktike për MGJP-në» (shih më lart, kap. 2), përfaqësuar veçanërisht nga Katja Schlatter, Rita Tuggener dhe Zeliha Aktash dhe që në fazat e ndryshme të përpunimit mund të drejtohej tek laboratorët e medias të Shkollës së Lartë Pedagogjike Cyrih.

Një bashkim të burimeve dhe të arsyeve të të tri grupeve pjesëmarrëse, e ofron paraqitja e Projektit - pjesë «Dokumentimi i videove» në kuadrin e një konference në Prishtinë në shkurt 2017, në të cilën Nuhi Gashi, në të njëjtën kohë, paraqiti projektin e tij vijues «Shacat».

Që më tej do të dalin bashkëpunime të tjera informale në lidhje me Projektin «Dokumentimi i videove», është e qartë; kështu p.sh. prezantimet në simpoziumin vjetor të mësuesve shqiptarë të MGJP-së apo bashkëpunimet në kontekstin për materialet e MGJP-së.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtare

Duhet theksuar në radhë të parë, që vazhdimi i rrjetit "NEZI » në kuadrin e projekteve vijuese, paraqet në përgjithësi dhe kryesisht një hap të vlefshëm dhe tepër të frytshëm. Kjo gjë lejon që të zhvillohen më tej dhe të ruhen bashkëpunimet e filluara në rrjet si dhe shkëmbimi i atjeshëm i mendimeve. Kjo mund të bëhet në një kuadër më të vogël dhe në këtë mënyrë veçanërisht intensive të projekteve vijuese të fokusuara tematikisht, të vetëdijshme dy- apo shumëkombëtare, në të cilat mund të konsolidohet mendimi i rrjetit dhe t'i kundërvihet rrezikut, që bashkëpunimet të ndërpriteshin pas përfundimit të Projektit. Raporti për Projektin e NEZI-t trajton në mënyrë të detajuar mendimet përkatëse (Dok-vëllimi1, Cyrih 2016; V. A. Kapitulli 5.6.); Ne përqendrohemi këtu për këshillën urgjente, që edhe për projekte të tjera të llojit të NEZI-t, të parashikohet një fazë konsolidimi e llojit të projekteve vijuese për NEZI-n.

Do të ishte më e drejtë, që kjo të bashkëmendohej ndoshta më shpejt (edhe gjatë planifimit të buxhetit) dhe t'u komunikohet si perspektivë pjesëmarrësve. Tek NEZI kjo gjë mund të ndodhë për arsye të planifikimit dhe të buxhetit vetëm në gjysmën e dytë të Projektit (në rastet e konferencave IV dhe V).

Propozime të veçanta të vështuara në Projektin - pjesë "Dokumentimi i videove për MGJP-në shqiptare", ekziston më shumë në atë që përvoja e shkëlqyer dhe përdorimi i burimeve dhe perspektivave të grupeve të ndryshme duhet të mundësohen dhe zhvillohen domosdoshmërisht më tej edhe në projekte të tjera. Kjo mund dhe duhet të bëhet, ashtu siç është përmendur deri tani, që projekte përgjegjëse vijuese të planifikohen dhe të komunikohen herët.

8 Të rinjtë me prejardhje shqiptare midis identitetit kombëtar dhe fetar

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuesi i Projektit:

- Dr. Rifat Haxhijaj, Universiteti i Freiburg-ut, Zvicër

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Kosova:

- Prof. Dr. Dr. Lulzim Dragidella, Universiteti i Prishtinës, Kosovë

Maqedonia:

- Nadire Rexhepi, Universiteti i Tetovës, Maqedoni

Buxheti:

- Fr. 17'000.-

Qëllimet e Projektit

Pas ciklit të konferencave - Nezi- dhe shkrimeve në media në lidhje me besimin në përgjithësi, për të rinjtë me prejardhje shqiptare në veçanti, por edhe në bazë të debateve publike në vendet e Evropës Perëndimore për migrim, ndikimi i mundshëm i feve në formimin dhe identitetin e tyre, dhe pas konsultimeve me pjesëmarrësit e tjerë të Konferencës të cilët ishin të interesuar në këtë Projekt, kemi në plan shkrimin e një artikulli në lidhje me identitetin kombëtar dhe besimin e të rinjve me origjinë shqiptare.
Ndonjëri prej respondentëve të Zvicrës ka vërejtur refleksione të një lakmie a babëzie tregtarësh të Atdheut, të cilët mërgimtarin në përgjithësi e projektojnë shtrembër dhe përmes interesit financiar. Kështu është parë mërgimtari në narracionin/dialogun në vijim:

«Para një viti isha me një shok vendas në një lokal në Pejë, ku dy shitës po bisedonin:

- Është pazari, se erdhën këta të jashtit? – pyet njëri.
- Jo, ua kam kaptë nanën, krejt paret i kanë lanë në Ulqin, kanë ardhë me xhepa gollo-muq këtu, – thotë tjetri duke i nxjerrë duart dhe xhepat e zbrazët.

Unë kthehem e i shikoj me habi e ata zbehen. Ua sqaroj se unë jam i këtuhit, por u bëj me dije se nuk është mirë me i sha ata ...»

Por, nuk dihet nëse ky perceptim është vetëm nga shtresa tregtarësh, apo mos ka një shtrirje më të gjerë publike dhe atë ndikuar po nga sjelljet e ekzemplarëve / eksponentëve të grupit «shacat». Kjo është hetuar edhe te përgjigjet e respondentëve të tjerë të Zvicrës.

«... tjera që i mirëpresim kur të vinë e mirëpresim edhe më shumë kur të shkojnë nga Kosova.»

Përpjekjet e mia, për shkak të shumë kufizimeve që pat ky model i intervistës dhe të tjerave, për të gjetur respondentë /«shaca» tipikë në Zvicër pothuaj se nuk patën sukses. Askush nuk (vetë) identifikohet me këtë profil, me këtë emërtim. Çdo kush flet për të, por vetëm në vetën e tretë njëjës (ai/ajo ...). Megjithatë, edhe brenda një potencialiteti të të qenit «shac» apo të lidhjeve të ndryshme me fenomenin, konfirmohet të qenit e tyre, prania e tyre si një grup shoqëror me veçori kryesisht të kundërta apo të devijuara nga ato të kodit, normës a perceptimit të pranueshëm si në Kosovë, si në Zvicër.

«... i shoh si sillen. Nuk dinë të ndalen. Shëtisin me makina të shtrenjta, kryesisht nga 80 mijë EURO. Ke, je. S'ke, s'je. Kështu sillet bota sot. P.sh., para pushimit marrin rrogën ose një kredi 4000 CHF dhe shkojnë në pushime në Kosovë e sillen si të kamur... »

Aktualisht, parë së jashtmi, devijimet manifestohen zakonisht te moshat e reja (18 – 22 vjeç) dhe sigurisht me konsekuenca të caktuara të profilin kulturor. Respondentët emëtojnë e përshkruajnë saktësisht edhe një mori patologjish sociale, kulturore etj. tipike për këtë grup shoqëror, si:

- Në emër të një «emancipimi», shumica e «shacave» të moshës së re (brezi i tretë), mjerisht, edhe në ambiente shqiptare (shoqëri, familje, në atdhe) flasin gjermanisht ose i ngatërrojnë gjuhët (dhe atë një gjermanisht të keqe e sigurisht në përputhje me vetë standardin e tyre të ulët).
- Ndonjë respondent më depërtues ka bërë një përshkrim të «shacit» përmes rekuizitave të jashtme, si në vijim:

«... ulur në kafene, përpara ka një pako cigare, çelësat e makinës përpara, 2 telefona, po ashtu, kanunin e veçantë ose i ulur shtremtë etj. Në shitore nuk i heq fare syzet e zeza.»

Për respondentët e Zvicrës, mbase, për të hyrë më brenda mentalitetit të «shacit», prej nga, më pas, do të shikohej edhe roli i rrethanave e faktorëve të tjerë (të brendshëm e të jashtëm, familjarë e institucionalë, personalë e ndërpersonalë etj.), do të duhej që intervista të ishte me përgjigje paraprake alternative, gjegjësisht opcionale.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

Veprimi i parë që duhet bërë para se të përpiqemi të interpretojmë më thellë fenomenin «shacat», respektivisht «shacat» tipikë, është evitimi i rrezikut të rënies në kurthin e identifikimit të tyre me mërgimtarin e rëndomtë. Zakonisht identifikimi ndikohet a shkaktohet nga e ashtuquajtura gjuhë triviale e përditshmërisë, një diskurs ky po ashtu banal e trivial që mund të jetë me pasoja serioze e kulturalisht përjashtuese. Fundja, për të qenë hendikepi edhe më i madh, edhe kjo gjuhë, edhe ky diskurs, është pasojë e «invazionit» kulturor jo vetëm të «shacave» të diasporës, por edhe e homologëve/prototipave të tyre në atdhe², të cilët kanë një shtrirje shumë më të shprehur, më agresive, më lakmuese e pretenduese në «të drejtën» e tyre. Me sfond kulturalisht patologjik ndonjëherë shfaqen edhe politika të caktuara shtetërore/institucionale deklarativisht diferencuese e favorizuese. Ato nuk mund të fshihen prapa diskursit të deklaruar zhurmshëm për gjoja njohjen e vlerave ekonomike, kulturore, arsimore e deri patriotike të diasporës e të mërgatës dhe s'ka dyshim se ky klasifikim është i shpifur e me pasoja jo të mira për shëndetin moral e kulturor qytetar. Së këndejmi në rrethe kulturalisht më kompetente, më të përgjegjshme, përditë e më tepër shprehet brenga e mungesës së interesimit e përkujdesjes së mjaftueshme institucionale për mërgatën dhe e «favorizimit» të saj për konsum të përditshëm politik. E sigurisht kjo indolencë, kjo përkujdesje e pamjaftueshme hap shteg edhe për paraqitjen e patologjive të ndryshme, siç është puna me «shacat». Pastaj, përmes mundësive të shumta të teknologjisë së sotme për abuzime mediale dhe kontaminim të opinionit publik, modaliteteve të tjera të «lira» të komunikimit, krijohen edhe perceptimet e reagent stereotipe dhe rrjedhimisht i bëhet jehonë një perceptimi të gabuar për emigrantin.

2 Prototipa të tillë janë hetuar edhe në raportet familjare, në komunikimin publik, në raportet institucionale etj. Një si monopol patriotizmi shfaq shprehja jo dashamirëse e shumë e ulët, që zakonisht kumtohet në kontekste të caktuara e si reaksion afektiv: «Me pasë kanë t'mirë, ishin këtu!» (lexo në Atdhe)

Pothuaj se, në një masë a në një tjetër, të gjitha grupet e respondentëve të intervistuar e pohojnë se fenomeni «shacat» tashmë përbën një grup shoqëror me sfond migrator, të cilët diferencohen sipas faktorëve të ndryshëm të ndikimit (endogjen e ekzogjen, moshë/brez e gjini, përkatësi të tjera), të cilët identifikohen me veçori e veçanti të sjelljes, me raporte divergjente me normën qytetare, me sistemet etj. Po ashtu, shumica e respondentëve me këtë emërtim i përfshijnë kryesisht mërgimtarët që vijnë nga hapësira gjermanishtfolëse, të cilët jo vetëm përbëjnë shumicën aktuale të mërgatës shqiptare të Kosovës³, por gjeografikisht i përkasin pothuaj se një hapësire kompakte, hapësirë me ngjashmëri të shprehura të rrafshit ekonomik, kulturor, arsimor etj.

Nëse në Atdhe bie në sy një ngurrim për reagim personal, familjar, publik e institucional /sistemor, një indolencë në ndërtimin e politikave preventive e mbështetëse shtetërore e sisteme ndaj diasporës e mërgatës, një relativizim i potencialitetit të pasojave kulturore të përhapjes së mëtejshme të fenomenit «shacat», një pranim më shumë i heshtur e i msheftë (latent) i perceptimit apo i barazimit të emigrantit me të (pothuaj se në të gjitha rrafshet e nivelet), kjo nxjerr në sipërfaqe qartazi një mëdyshje, një preokupim se si dhe sa shoqëria shqiptare (prej personit, familjes e deri te institucioni), në veçanti në rrafshin kulturor (të zhvillimit të vlerave kulturore), është e (pa) standardizuar⁴. Pra, problemi në thelb është kulturor dhe lidhet edhe me shenja të shqiptarëve për të pranuar, krijuar e bile edhe «përligjur» me lehtësi perceptime stereotipe dhe sjellje devijante, gjithsesi të dëmshme, që e lëndojnë kohezionin shpirtëror e kompaktësinë kulturore brenda njësisë etnike.

Dhe, kur është fjali për krijimin e perceptimit publik të shtrembër dhe barazimin e «shacit» me profilin e emigrantit të rëndomtë, ndonjë respondent ka afishuar edhe një mori pasojash e paragjykimesh, të cilat, ndër të tjera, krijojnë edhe një distancë, një opsesion, një kompleks etj:

«Fjala «shac» është edhe një etiketë, është edhe një nënçmim. Njihet edhe muaji i «shacave». I marrin pak si budallenj. Rriten çmimet. Si të rritur jashtë, në vend se t'u thonë shqiptarë, ju thonë ja «shacat» etj. Kudo që hy, kam bindjen se potencialisht më trajtojnë si një «shac». Qëndrimi, të folurit e bëjnë këtë.»

Për fenomenin «shacat», në raport me gjininë, respondentët nuk kanë bërë ndonjë diferencim aq shënjesues. Bile shumica e tyre nuk e dallojnë shprehimisht «shacin» prej

3 Këtu përfshihet edhe mërgata shqiptare i hapësirave të tjera të ish Jugosllavisë

4 Është e ditur se standardizimi i mirëfilltë paraqet premisën e parë për përcaktimin, ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave themelore kulturore kombëtare e qytetare. Kjo është e rëndësishme në veçanti për shoqëritë (si jona) që karakterizohen nga një «brishtësi» pothuajse e përhershme e fragmentarizim resurcesh e vlerash shkaktuar nga faktorë të ndryshëm (ekonomik, politik, kulturor etj.).

emigrantit, qoftë ai femër apo mashkull. Megjithatë, për ndonjërin femrat (të brezit të parë e të dytë) vuajnë në izolimin e tyre kulturor, ngurojnë të integrohen në sistemin vendor të vlerave, kurse vlerat e tyre burimore (të prejardhjes) kanë humbur shumë nga karakteristikat e tyre përfaqësuese, janë aq shumë të fragmentarizuara ose të hermetizuara, fundja janë replika të zbehta e të deformuara të skemave të tejkaluara të përkatësisë. Dhe, s'do mend, duke mos qenë origjinale, ato s'janë as përfaqësuese. Por, në shfaqjet e tyre, si një plotësim a kompensim i të munguarës, si një replikë e keqe kulturore identitare, ato janë kompromituese, mashtruese. E lëndojnë shëmbëlltyrën reale dhe bëhen tipike për profilin e «shacit».

Ja një narracion diferencues gjinor:

a Portreti i një «shaci» mashkull: «Pëlqen pantallona të bardhë, në xhepin e pasmë ka një kuletë të fryrë (jo me para por me kartela të ndryshme pa vlerë, si të sigurimit shëndetësor, karta të telefonave, vizën e qëndrimit etj), syze dielli edhe në ambiente kur nuk ka diell, në qafë bart zinxhirë të trashë (e përdorin fjalën sllave llanec). Kanë dëshirë të tërheqin vëmendjen e të tjerëve. Me një fjalë shesin mend si njerëz të arritshëm. Në fakt nuk është aktiv në shoqërinë ku jeton dhe si i tillë nuk është pjesëtar pozitiv i saj. P. sh. një 35 vjeçar njoftohet me ndonjë vajzë të re në Kosovë dhe e mashtron duke i premtuar se do t'ia bëjë vizën e qëndrimit «brenda nate», kurse, në të vërtetë, e lë të presë me dy-tre vjet.»

b Portreti i një «shaci» femër: «Vesh pantallona të ngushë tej mase dhe të leckosur në gjunjë. Në buzë ka buzëkuq të ndezur, syzet jo në sy por mbi flokë (me lëvizje të shpeshta herë duke i hequr e herë duke i vënë). Shprehitë e veshjes gërshetohen vazhdimisht me shprehje të tjera negative. Biseda krejt të pavërteta, të pamundshme: «Si jam shkuar në Zvicër për çdo muaj më japin rrogë nga 1000 fr, hiq pa punuar». ... Thënia më e shpeshtë e «shacit» femër është: «Nëse nuk më dëgjon burri nga Kosova, e lëshoj menjëherë. »»

Në përgjithësi, devijimet a problemet që manifestojnë «shacat», që në njëfarë mënyre i bëjnë ata si një «entitet» në vete, burimin e kanë te shkaqe të shumta, ndër të cilët bien në sy:

- Këta njerëz kanë nevojë për afirmim e integrim normal në shoqërinë zvicerane, por këtë nuk e arritën dot, sepse, para së gjithash, nuk e posedonin një themel të mjaftueshëm kulturor e arsimor.
- Këta njerëz kanë ardhur në Zvicër (brezi i parë) me një mori kompleksesh, mungesash, motivesh e nevojash dhe statusi i tyre i përkohësisë (në kohëzgjatje të qëndri-

mit), etja e tyre për sa më shumë punë e fitim dhe atë sigurisht në punë të rënda e jo të favorshme (ndërtimtari, shërbime publike, gastronomi) ka shkaktuar një izolim kulturor, (vetë) margjinalizim etj., i cili në një masë të caktuar ka ndikuar në «tjetërsimin» e tyre edhe kulturor.

- Edhe te brezi i tretë (kryesisht të lindur në Zvicër) do të haset ky fenomen e që sigurisht është konsekuencë sa e problemeve kulturore të familjeve shqiptare dhe e kompleksitetit të integritetit në shoqërinë zvicerane, po aq edhe e politikave ekonomike, kulturore, arsimore, të integritetit etj. të shtetit dhe të shoqërisë zvicerane.
- Këta njerëz kanë probleme serioze të rrafshit të enkulturimit (në veçanti te ndërprerja e procesit të internalizimit kulturor, që rezulton edhe me probleme identitare) e akulturimit (janë të njohura manifestime të shumta deri te shoku kulturor), respektivisht nuk arrijnë ta krijojnë atë baraspeshën e nevojshme identitare/ndërkulturore dhe, rrjedhimisht, kanë probleme me profilin e vetë identitar/kulturor e manifestimet identifikuese si kompleksi/frika e asimilimit, përballja me dukuritë e (vetë) margjinalizimit a izolimit etj.;
- Kosova/Atdheu paraqet vendin e përshtatshëm ku «shacat» ndjehen të realizuar në maniret e tyre, vendin ku ata jo vetëm i «kompensojnë» mungesat e tyre, por edhe ku shprehin «epërsinë» në fusha të caktuara, vendin ku shumëçka nga ato që në Zvicër janë të ndaluara, këtu, përkundër ligjit, lejohen ose në perceptimin e tyre para-prak janë të pranueshme.

Devijime të tjera të natyrës së personalitetit e karakterizojnë «shacin»; prej shenjave të hapura ose latente narcisoide e deri te një shpifje a simulim i **të lumturit**, **të të kënaqurit** me statusin personal, i cili parë nga një këndvështrim më kompleks nuk është larg një mozohizmi.

Një perceptim më i diferencuar i «shacit» nga mërgimtari i rëndomtë duket të jetë më i shprehur në Kosovë, sado që në reagimet afektive dhe të kushtëzuara të shumtën e herave, si për «shaka»⁵, bëhet barazimi. Sipas përgjigjeve të respondentëve, pothuaj se të ngjashme me ato të diskursit publik, që shprehen përditë në medie e rrjete sociale, «shacit» i rëndojnë mbi supe një mori veçorish e sjelljesh patologjike nga më të pakëndshmet. Sipas respondentëve, profili i tyre ka këto karakteristika:

- Të papërgjegjshëm ndaj familjes dhe sidomos ndaj institucionit të martesës.
- Sillen ashtu siç nuk janë në të vërtetë.
- Bashkëbisedimi me ta sillet rreth blerjeve, modës, dasmave, të të pameve (ngushëllimeve), se si vuajnë për çdo gjë etj.

5 Sa kjo «shaka» është shaka e vërtetë, duhet gjurmuar e hulumtuar? Një aversion latent, një refuzim i mas-kuar, i kushtëzuara nga distanca dhe interesat, mund të jetë objekt diskutimi e hulumtimi!

- Paguajnë 50 EURO dhe nuk mërzhiten, ju duket gjobë e vogël në krahasim me gjobat në Zvicër!
- Jo, ato sende (librat) i kanë lënë!
- Ata dallohen edhe me një dukje prej të fortit. Ngasin (vozitin) makinën më shpejt. Gjobat janë të vogla, nuk brengosen.
- Meshkujt vishen më ndryshe, kanë një stil tjetër, me rroba më të ngushta. Femrat dëshirojnë të jenë më shumë të ekspozuara, vishen me ngjyra me të çelta, duan të jenë në qendër të vëmendjes etj.
- Nuk flasin gjithnjë shqip, i kombinojnë gjuhët.
- Përgjithësisht janë tipa të dashuruar pas vetes, pas veshjes dhe sjelljes së tyre.
- Mbajnë dy qëndrime, paraqesin një «dyfytyrësi», sepse ndryshe sillen kur janë në Zvicër dhe ndryshe në vendlindje – atdhe.
- Thënia më e shpeshtë e 'shacit' femër është: «Nëse nuk më dëgjon burri nga Kosova, e lëshoj menjëherë».
- Në një rast në zebër, kur unë po i jepja përparësi këmbësorit, tjetri prapa me tabela të Sant Gallenit e nervoz po i binte borisë që mos të ndalem etj.
- Në shitore nuk i heq fare syzet e zeza.
- Ulur në kafene, përpara ka një pako cigare, çelësat e makinës përpara, 2 telefona, po ashtu, kanunin e veçantë ose i ulur shtremtë etj.

Në këtë botë moderne, ku e keqja afirmohet shumë shpejt, në këtë botë ku mediet para së gjithash afishojnë patologjitë jetësore, «shaci» tipik në Zvicër me bagazhin e sjelljeve të tij patologjike, duke rënë ndesh me normën, kodin e sistemin vendor, pat ndikuar padrejtësisht në dëmtimin serioz të imazhit të shqiptarit me sfond migrator. Gjithsesi kjo ishte dhe është shqetësuese. Por, për fat të mirë, kohëve të fundit vërehet se ky perceptim përgjithësues dhe i gabuar gjithnjë e shumë po ia lë vendin atij realit, të mirëfilltit.

Kjo dëshmohet me tregues realë se shqiptari në Zvicër, në vend se të afishohet më tej përmes sjelljeve e manifestimeve devijante të «shacit» dhe të profileve të tjera socio-patologjike, të cilat si zakonisht nxisin reagime albanofobe dhe paraqesin pengesa të mëdha të integritimit, gjithnjë e më tepër (në veçanti brezi i tretë) po shpërfaq vlerat e tij në fushat normale të jetës; në ekonomi, në ndërmarrësi, në kulturë, në arsim, në sport etj. Shembuj të shumtë të viteve të fundit (ku prijnë sportet), për fat të mirë, po e zhvendosin atë nga të qenit në top listat e lajmeve të këqija dhe po e përmirësojnë dukshëm perceptimin për ta si qytetarë të ndërgjegjshëm e të përgjegjshëm në të gjitha raportet. Mbase, ky trend është premtues, këta shembuj të nxjerrjes në pah të vlerave kulturore, këta shembuj të raportit normal qytetar me veten, familjen, shtetin, mjedisin, ky stabilitet kulturor, ky ekuilibër identitar duhet mbështetur e inkurajuar në vazhdimësi, duke filluar nga përgjegjësitë personale, familjare, shoqërore, publike e deri te politikat e mençura institucionale/shtetërore.

Së këndejmi, mësimi i gjuhës dhe i kulturës së prejardhjes në Zvicër e gjetiu është një mjet i fuqishëm kulturor e arsimor, që, ndër shumë favore të tjera, krijon premiset themelore kulturore e arsimore për parandalimin e shfaqjeve devijante sociale, disa prej të cilave tashmë janë përshkruar gjatë hulumtimit të fenomenit «shacat». Hulumtimet krahasimtare psiko e sociolinguistike, sociologjike, pedagogjike etj. në Zvicër e gjetiu⁶, raportet e mësuesve/eve e prindërve shqiptarë, të mbështetura para së gjithash mbi përvojat konkrete didaktike si dhe ndonjë hulumtim empirik, të paraqitura edhe në takimet /seminaret e veprimtaritë didaktike, pedagogjike etj. (në Kosovë e në Zvicër) dëshmojnë se manifestime të sjelljes të profilit «shaci» nuk janë hetuar në përmasa shqetësuese të nxënësit shqiptarë që e kanë ndjekur këtë mësim. Ata, në shumicën absolute, duke qenë kulturalisht më të realizuar, duke qenë mjaftueshëm të ekuilibruar e me kompetenca solide në dy (e ndoshta diku edhe më tepër) kulturorësinë e tyre, nuk kanë probleme të rrafshit të përshtatjes, të sjelljes, të kodit, të normës, të integritetit etj.

Dokumentet themelore kurrikulare dhe tekstet e mjetet mësimore aktuale ofrojnë përmbajtje të mjaftueshme për ndërtimin e profilit të mirëfilltë kulturor/identitar e ndërkulturor të nxënësit. Por, mjerisht, numri i nxënësve që e ndjekin mësimin është aksidentalisht i vogël dhe ky, po ashtu, është problem në vete që kërkon përgjegjësitë në të gjitha nivelet dhe nga të gjitha subjektet. Është detyrë e çdo subjekti e institucioni të ofrojnë përkujdesjen e nevojshme kulturore e arsimore edhe për qytetarët me sfond migrator, të cilët rreziku i devijimeve kulturore e qytetare është më i madh. Fundja, rrjedhimisht, jeta në rrethana kulturore e arsimore të shëndetshme dhe të mjaftueshme do të kishte shumë më pak «shaca» e shumë më tepër SHACA.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

Një projekt ndërdisiplinar i udhëhequr e i financuar nga IPE (International Projects in Education) i SHLP të Cyrihut, i cili qe zhvilluar në periudhën 2013 – 2015 me një pjesëmarrje për fillim mjaftueshëm mikste profilesh të ndryshme intelektuale shqiptaro (Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, Zvicër)- zvicerane (Zvicër) deri në 30 pjesëmarrës/se, kryesisht specialistë e specialiste fushash të ndryshme (nga fushat e etnologjisë, sociologjisë, antropologjisë, didaktikës, pedagogjisë ndërkulturore, gjuhësisë, shkencave juridike, politikës, medieve etj.), i emërtuar dhe i njohur si një RRJET (NEZI) rreth e për temën «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura: Për dinamikën e rritjes brenda dhe midis normave dhe

6 Shih në veçanti studimet krahasimtare të prof. dr. Basil Schaderit etj. por, në një masë, edhe raportet e subjekteve të rrjetit NEZI, pjesë e të cilit është edhe ky hulumtim.

sistemeve të ndryshme të referimit⁷», në kontekste të caktuara diskutimesh e interpretimesh krahasimtare, pashmangshëm preku edhe fenomenin «shacat». Në të vërtetë ishte kjo prekje a përmendje, kryesisht kontekstuale, e cila më për së afërmi «provokoi» interesimin a idenë time të mëhershme për t'i hyrë një hulumtimi më të plotë në kuadër të komunikimit shumëplanësh ndërshqiptar dhe atë veçueshëm a kryesisht në linjën Zvicër-Kosovë.

Me kërkesën time ky interesim do të bëhet njëri nga projektet e pjesës së dytë të programit NEZI të IPE –së, i cili, duke qenë një hulumtim tematik kryesisht përmes intervistave me respondentë profilesh të ndryshme si dhe mbi bazën e përvojave të mia të përditshme të këmbimit të përvojave me qarqe të ndryshme në diasporë e për diasporën, mund të paraqesë një kontribut të çmuar në artikullimin e diferencimit e perceptimeve tipike për shacat si koncept e kategori, respektivisht si grup shoqëror migrator në Kosovë e në Zvicër. I vrojtuar nga perspektiva të ndryshme, problemi bëhet më intrigues dhe shfaqet edhe më komplementar edhe si dukuri për hulumtime më të thelluara ndërdisiplinare (sociologjike, etnologjike, ndërkulturore antropologjike etj.). Më tej, në qëllimet tij, ky projekt mund të krijojë edhe një pikënisje solide e të vlefshme, sidomos në rrafsh metodik dhe të përmbajtjes, kah thellimi i hulumtimit për perceptimet (edhe të diferencuara) e grupeve të ndryshme shoqërore migratore shqiptare gjithandej nëpër diasporat shqiptare, në njërën anë, dhe në trojet shqiptare, në anën tjetër. Po ashtu, ky hulumtim mund të trajtohet edhe si kontribut për shtimin e nxitjes së trajtimit të përshtatshëm të këtij grupi shoqëror, i cili duket mjaft i pranishëm, respektivisht mjaftueshëm i diferencuar për të qenë objekt hulumtimi shkencor ndërdisiplinor e trajtimi shoqëror, kulturor, institucional etj. Pra, të kuptuarit e drejtë të fenomenit «shacat» dhe të gjithë raporteve lidhur me të (grupin) është me interes të veçantë, para së gjithash kulturor, për shqiptarët. Aq më tepër që, siç do të shihet më vonë në rezultatet e këtij hulumtimi, vetë emërtimi «shacat» në perceptimet e jo pak njerëzve nuk duket të jetë mjaftueshëm determinues e i diferencuar, sepse lëkundet ndërmjet të nënkuptuarit apo të identifikimit të tij me tërë mërgatën shqiptare, siç ka të ngjarë të jetë identifikuar në fillim të viteve 90-ta (pra, bars me emigrantin apo shqiptarin me sfond migrator) apo me një grup të veçantë shoqëror të kësaj mërgate/diaspore me specifika shoqërore, kulturore etj., i cili kohëve të fundit afshohet me probleme të shumta.

Duke qenë se ky hulumtim, në këtë format, është modest e me kufizime të caktuara pothuaj se në të gjitha rrafshet, për të pasur në dorë rezultate/të gjetura konkrete e me shkallë solide të besueshmërisë, në kontekst të metodës, në radhë të parë, kam zgjedhur intervistën. Intervistat kryesisht janë gjysmë të standardizuara, pra me pyetje paraprakisht të hartuara e ku respondentit, me qëllim të krijimit të një hapësire e ambienti për të më të përshtatshëm të të shprehurit, mund edhe ta ndërrojë radhën e pyetjeve. Ndon-

7 Materialet e botuara në librin (shqip e gjermanisht): Kultura e parë, e dytë ... dhe ndërkultura: Për dinamikën e rritjes brenda dhe midis normave dhe sistemeve të ndryshme të referimit, Prishtinë, 2016

jëherë, në varësi të situatave konkrete, është zbatuar edhe e ashtuquajtura intervistë jo e strukturuar. Kam bërë kujdes, duke e paralajmëruar respondentin, që narracioni të jetë forma e tij e shprehjes dhe atë gjithnjë duke e pasur në fokus pyetjen konkrete. Gjithnjë kam rrahur në dhënien e udhëzimeve për përgjigje objektive, të pandikuar, pa ekuivoqe, origjinale⁸. Natyrisht duke krijuar edhe ambient për këtë. Prandaj, para së gjithash, me pajtimin e respondentit është parapëlqyer incizimi i intervistës. Për arsye objektive, përgjigjet e ndonjë interviste janë marrë edhe në trajtë të shkruar.

Për efekte plotësuese e krahasimtare, kam pasur në dorë edhe një mori shkrimesh e raportesh nëpër shtypin e shkruar (të Kosovës dhe ndonjëherë edhe zviceran). Nga ky kontingjent, mjerisht, nuk gjeta dot ndonjë përpjekje për ta kapur problemin me kompetencën e duhur shkencore e hulumtuese. Prandaj, do isha shumë i lumtur nëse, sado pak, do të provokoja interesimin e duhur jo vetëm për thellimin e hulumtimit shkencor, por edhe të konkretizimit të përkujdesjes shtetërore institucionale (politike, kulturore, arsimore etj.).

Me interes të veçantë ishte edhe moria e takimeve e bisedave me shkas gjatë një qëndrimi në ambiente të ndryshme shqiptare në Zvicër në shtatorin 2016. Ndërkaq, në kontekst të pikëpamjes sime personale, e përmend edhe lidhjen time të përditshme me problemet kulturore e arsimore të diasporës shqiptare në punën që bëj në Ministrinë e Arsimit... të Kosovës, fakt që sigurisht do t'i japë ngjyrë këtij hulumtimi, duke e nxjerrë edhe si rezultat të një qasjeje krahasuese dhe komplementare.

Meqë fenomeni «shacat» 15 vitet e fundit (në veçanti në Kosovë, Maqedoninë Perëndimore e Luginë të Preshevës) tashmë është bërë lëndë e mirë edhe për krijues të ndryshëm zhanresh të ndryshme, pata në dorë edhe ndonjë emision hulumtues televiziv, filma humoristikë, krijime muzikore, parodi të ndryshme, krijime letrare satirike deri të krijuesve të ndryshëm popullorë (rapsodëve) e të estradës, etj.

Për një hulumtim më të thellë e më përfshirës, intervista duhet të praktikohet, ndër të tjera, edhe më tej, por duhet të jetë me **përgjigje opcionale**, të cilat vetëm shënjojnë nga respondenti. Kjo, edhe për faktin se respondentët potencialë të profilit të «shacave» tipikë ose nuk pranojnë fare të intervistohen, ose ngurojnë të japin përgjigje origjinale. Për një mori pikëpamjesh e nxitjesh u referohem edhe kontributeve kompetente të miqve e të bashkëpunëtorëve të çmuar në Zvicër; Prof.dr. dr. Basil Schader-it nga Qendra IPE e SHLP të Cyrihut (ndër të tjera, një njohës i shkëlqyeshëm i pozitës së shqiptarëve në Zvicër dhe raporteve shqiptaro-zvicerane) dhe Nexhat Malokut, mësues i fëmijëve shqiptarë në Zvicër dhe aktualisht kryetar i LPASH «N. Frashëri» në Zvicër (partner imi në këtë projekt).

Sigurisht që qëllimi i hulumtimit është përfitimi i rezultateve sa më reale dhe, do të

8 Në të vërtetë të shumica e respondentëve qartazi hetohet mëdyshja për përgjigje të mirëfillta, kështu që ajo zakonisht mbetet latente (siç është në një masë edhe percepti publik për «shacat») dhe duhet të kërkohet a të nxirret nga konteksti, siç duket në pamje të parë i «ekulibruar» i atij dyzimi konceptual.

thosha, përfaqësuese, identifikuese, karakterizuese. Së këndejmi, për fillim, u përpoqa të përcaktoj, krahasoj e ballafaqoj një larmi pikëshikimesh a perspektivash të shikimit të marra nga intervistat. Mjerisht, edhe këtu ballafaqohem me rrezikun e zvogëlimit të vërtetësisë e saktësisë së vlerësimit, sepse të gjitha grupet e respondentëve janë shqiptarë⁹. Rrethana reale demografike, gjeografike e kulturore-arsimore të shqiptarëve më imponuan të zgjedh opinionet e katër grupeve të respondentëve relativisht të ndryshëm, të cilët në një mënyrë paraqesin edhe «entitete» karakterizuese e përfaqësuese. Të gjithë shqiptarë/e, moshash, gjinish e veçorish të tjera të ndryshme apo të përafërt (profesione, shkallë arsimit, vokacione të tjera) do të japin përgjigjet e duhura sipas 3 versioneve të pyetjeve, të cilat, edhe ato, të shumtën janë të përafërta.

- a** Pyetjeve të versionit A u janë përgjigjur grupi i respondentëve rezidentë të Kosovës (4 sosh pa lidhje të drejtpërdrejta familjare me «shacat») profilesh e profesioneve të ndryshme; 1 piktor/profesor universiteti, 1 drejtore shkolle, 1 nxënës gjimnazi, një sociologe dhe grupi i shqiptarëve po ashtu rezidentë në Zvicër (4 sosh që nuk identifikohen me «shacin» tipik); 1 mësuese e fëmijëve shqiptarë, një krijues/shkrimtar e mësues kolegji, një teknik medicinal, një dizajner¹⁰. Orientimisht të gjithë këta respondentë posedojnë premisa të duhura për të bërë një vlerësim objektiv, të pavarur dhe original. Respondentët e zgjedhur në Zvicër janë shembull i mirë i qytetarëve me sfond migrator, të integruar suksesshëm në sistemin zviceran, në njërën anë, dhe me qëndrueshmëri e kompetenca shembullore identitare e kulturore në raport me prejardhjen, në anën tjetër.
- b** Pyetjet e versionit B janë hartuar e përshtatur për respondentët rezidentë në Kosovë që kanë lidhje të drejtpërdrejta familjare me «shacat» (3 sosh) e ku ndërveprimi familjar është më i pranishëm në të gjitha segmentet. Sigurisht që ndikimet e reflektimet këtu, brenda një përgjegjësie e ndërlidhje familjariteti, vështirë se do të mund të jenë shmangur.
- c** Pyetjet e versionit C janë hartuar për grupin e veçantë në Zvicër, të emërtuar paraprakisht si «shaca» tipikë (3 sosh). Duke qenë se, në kuptimin pezhorativ, pothuaj se askush nuk pranon të identifikohet me këtë epitet, po ashtu nuk pranon as të intervistohet, ndoshta një model tjetër i intervistës, asaj me përgjigje alternative-opcionale, do të ishte zgjidhja më e mirë për të pasur edhe përgjigje sa më të besueshme.

9 Nisur nga fakti se komuniteti shqiptar në Zvicër tashmë është mjaft i pranishëm në të gjitha rrafshet, në një hulumtim më kompetent të fenomenit «shacat» do të duhej të ishte i pranishëm edhe opinioni /perceptimi zviceran, respektivisht problemi të kapet edhe nga perspektiva zvicerane, duke pasur në fokus edhe atë emërtimin e njihur «Zug Shipi».

10 Në të vërtetë kam intervistuar edhe disa të tjerë, si në Zvicër, si në Kosovë, përgjigjet e të cilëve po ashtu kanë ndikuar në krijimin e opinionit tim e që mund të jenë me interes të veçantë me rastin e thellimit të hulumtimit.

Sidoqoftë, edhe brenda përgjigjeve të profilit thjesht të emigrantit mund të hetohen e lexohen vlerësimet e perceptimet për «shacat» e mirëfilltë¹¹.

Nuk qe e lehtë të gjeje respondentë të vullnetit të mirë dhe me koncepte të qarta, të pavarura e të qëndrueshme. Te shumica e respondentëve, në veçanti të ata të versioneve të pyetjeve B e C sikur manifestohej një lloj konformizmi a uniformizmi, i cili e lëndonte gjykimin e pavarur¹². Një prirje kah një mendim më i pavarur, më kritik, më i hapur dhe jo stereotip hetohej te moshat më të reja të respondentëve. Edhe pse ishte i garantuar anonimiteti i respondentit në interpretim, afria familjare, farefisnore a regjionale mes tyre në një masë të caktuar sikur paragjykonte edhe përgjigjet e vlerësimit. Jo rrallë përgjigje të caktuara dalin të veshura me mjaft emocionalitet të shpifur, me elozhe të tepërta e kësisoj. Ndërkaq, disa respondentë sikur bien në kurthin e gjuhës, kështu që ajo shfaqet edhe me situata e vlerësime ekuivoke, plot ambiguitet, dihotomi etj. E të gjitha këto, në të vërtetë, nxjerrin në pah dyzimin e respondentit e përmes këtij edhe vetë kontradiktën a opinionin ambivalent publik.

Ky klasifikim kësisoj i respondentëve, duke iu referuar faktorëve hapësinorë, të vendqëndrimit, emocionalë e kulturorë, përbën premisën themelore për një hulumtim e interpretim të fenomenit «shacat» nga katër perspektiva. Në njëfarë mënyre është pretenduar të sigurohet paraprakisht një pjesëmarrje sa më e madhe e përfaqësuese grupesh e opinionesh, gjithsesi me sftime të ndryshme apo autentike për llojin.

11 Ekziston një vlerësim i përgjithshëm se te çdo emigrant ka një dozë të caktuar të profilit të «shacit».

12 Edhe ashtu është e njohur se shoqëria shqiptare, për arsye të ndryshme historike e kulturore, edhe më tej sikur me vështirësi lirohet nga konformizmi e uniformizmi.

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkom-bëtarë.a

Kjo punë me sfond kërkimor-hulumtues mund të konsiderohet si një bazë a sugjerim motivues për depërtimin deri në thellësitë dhe të panjohurat e problemit. Të kutuarit e drejtë të fenomenit «shacat», brenda shumësisë së raporteve të ndryshme, të cilat në masë të konsiderueshme edhe më tej mbesin të pasqaruara mjaftueshëm, për shqiptarët dhe migrimet e tyre paraqet interes të veçantë. Koncepti «shac» perceptohet në mënyra të ndryshme dhe ky perceptim lëkundet ndërmjet shënimit fillimisht dashamirës të gjithë mërgatës e diasporës shqiptare dhe të vlerësimit të mëvonshëm të një grupi krejtësisht të caktuar të emigrantëve me veçori shoqërore e kulturore specifike, të cilat kohëve të fundit qenë identifikuar e perceptuar si problematike.

Mbase për të pasur në dorë rezultate më bindëse duhet pasuruar e përshtatur metoda dhe mjetet e hulumtimit. Praktika e pyetësorëve pa përgjigje të mundshme nuk është treguar mjaftueshëm nxitëse. Për shkak të kompleksitetit të problemit dhe lidhjeve të tij emocionale, ndër të tjera, duhet përdorur intervista me pyetësorë që posedojnë përgjigje opcionale (alternativa). Në anën tjetër, jo vetëm përmes intervistës, duhet të vilet edhe opinionin i qytetarit zviceran me prejardhje jo shqiptare dhe ky opinion, po ashtu, të jetë sa më përfaqësues dhe shtresash e kompetencash të ndryshme. Meqë, për fat të mirë e përkundër kufinjve fizikë e shtetëror (shqiptarët përbëjnë një njësi kulturore të integruar e kompakte), kërkimi duhet shtrirë edhe në Shqipëri¹³, Maqedoni etj., gjithandej ku jetojnë shqiptarët.

Dhe, sigurisht për të siguruar thellësi e besueshmëri më të lartë rezultatesh, hulumtimi duhet të zgjerohet në rrafsh ndërdisiplinar dhe ndërnacional, duke përfshirë profile ekspertësh të fushave përkatëse shqiptarë dhe zviceranë.

Një komunikim i ardhshëm i këtij hulumtimi me publikun dhe qarqet e ndryshme të tij (përmes promovimit, tryezave, debateve, botimit etj.) do të ndikonte në kompletimin e formatit të tij të ardhshëm të mundshëm, duke e provokuar e zhvilluar edhe një qasje deri krahasimtare e komplementare.

13 Në rrethe të caktuara është i njohur emërtimi, ka të ngjarë, ekuivalent si «jorgo».

Shtojcë: Tre pyetësorë të përafërt sipas grupeve KOS dhe CH:

A Pyetje për grupet KOS dhe CH (njerëz pa lidhje apo afri të drejtpërdrejtë me shaca: 4 intervista)

- A1 Çka nënkuptoni ju ose çka nënkuptojnë njerëz të tjerë kur flitet për shaca? Ju lutem, tregoni!
- A2 Çka e karakterizon sjelljen e shacave? Konkretizoni sa më shumë, jepni shembuj dhe përshkruajeni profilin e shacit.
- A3 Thoni ca fjalë për shaca meshkuj dhe – nëse ka – për shaca femra. Si janë, çka bëjnë? Si sillen?
- A4 Si dallohen shacat për dallim nga njerëz të tjerë, nga kategoritë e tjera të njerëzve?
- A5 Çfarë parafytyrimesh (asociacionesh) keni me këtë emërtim/term? Si e perceptoni atë?
- A6 Si është prestigji/statusi shoqëror i shacave? Pse është kështu?

B Pyetje për grupin KOS i (familjarë/të afërm etj. të shacave: 3 intervista)

- B1 Çka nënkuptoni ju ose çka nënkuptojnë njerëz të tjerë kur flitet për shaca? Ju lutem, tregoni!
- B2 Çka e karakterizon sjelljen e shacave? Konkretizoni sa më shumë, jepni shembuj dhe përshkruajeni profilin e shacit.
- B3 Thoni ca fjalë për shacat meshkuj dhe – nëse ka – për shacat femra. Si janë, çka bëjnë? Si sillen?
- B4 Si dallohen shacat nga njerëz të tjerë/nga kategoritë e tjera të njerëzve?
- B5 Besoj se edhe ju keni në familjen ose në rrethin tuaj një shac apo më shumë sosh. A është ai/ajo shaci tipik? Nëse po, pse, ç'e bën atë tipik/e? Nëse jo, pse jo, si dallohet nga shacat tipik/e?
- B6 Si e ndjeni/përjetoni faktin që keni një shac apo më shumë në familjen/rrethin tuaj? Tregoni pak për përvojat tuaja të mira e të këqija.
- B7 Pse, sipas mendimit tuaj, sillen shacat ashtu si sillen?

C Pyetje për grupin CH (shaca ose ish-shaca tipikë)

- C1 Çka nënkuptoni ju ose çka nënkuptojnë njerëz të tjerë kur flitet për shaca. Ju lutem, tregoni!
- C2 Edhe ju mund të konsideroheni si shac. Si e përjetoni këtë «etiketë» në lidhje me ju; pse mirë, pse jo aq mirë?
- C3 Çka jeni ose bëni ju që mund të konsiderohet si tipike për shacat?
- C4 Çka nuk bëni ju që shaca të tjerë ndoshta e bëjnë?
- C5 Si i shohin njerëzit në Kosovë shacat? Çka mendojnë për ta?
- C6 A u kanë zili të tjerët shacave, pse?
- C7 A është kategoria ose emërtimi/etiketa shac diçka që është e rëndësishme vetëm në Kosovë ose ka etiketa ose emërtime/ karakterizime të ngjashme edhe në vendin ku jetojnë tani?

Shënim

Tejshkrimet /transkriptet/ e plota të intervistave mund të kërkohen te Nuhi.Gashi@rks-gov.net..

10 «Përkthimi është kulturë»

Pjesa 1: Të dhëna të përgjithshme

Drejtuksi i Projektit (Përgjegjësi kryesor):

- Driton Kajtazi

Partnerët dhe vendet pjesëmarrëse:

Zvicra:

- Driton Kajtazi

Kosova:

- Prof. Dr. Nerimane Kamberi, departamenti i Frëngjishtës i Universitetit të Prishtinës

Buxheti:

- Fr. 14'000.-

Qëllimet e Projektit

- Krijimi i urave të bashkëpunimit në mes të Profesorëve të Universitetit të Lozanës dhe të Prishtinës
- Botimi i librit në gjuhët frënge dhe shqipe: Dallime Identike (Différences Identiques), ese mbi përkthimin
- Dhënia e moduleve mbi komunikimin ndërkulturor në Universitetin e Prishtinës
- Dhënia e një Konferencës me këtë temë në Lozanë.

Referenca për qëllimet gjithëpërfshirëse të rrjetit NEZI

- Komunikimi ndërkulturor dhe përkthimi janë pjesë integruese e Interkulturës.

Plani kohor, agjenda

Shtator – tetor 2016	Pregaditje e aktiviteteve
Tetor 2016	Dhënie e 2 konferencave nga Driton Kajtazi - Konferencë-debat në Departamentin e Frengjishtës të Universitetit të Prishtinës. - Konferencë-debat në kuadër të Masterit «Përkthime dhe Komunikime» në kuadër të Fakultetit të Filologjisë së Universitetit të Prishtinës.
Dhjetor 2016	Takime pune, përcjelle e kurseve dhe shkëmbime nga Prof. Dr. Nerimane Kamberi në Universitetin e Lozanës. - Takim me drejtues të Qendrës së përkthimeve Letrare të Universitetit të Lozanës. - Takim me drejtues të Qendrës së Kërkimeve Letrare për Zvicrën Françeze pranë Universitetit të Lozanës. - Takim pune me drejtues të Dapartamentit të Frengjishtës Gjuhë e Huaj pranë Universitetit të Lozanës. - Konferencë-debat nga Prof Dr Nerimane Kamberi në ISEAL me temën «Komunikimi ndërkulturor».
Nëntor 2016	Botimi në gjuhën frenge i librit: «Différences Identiques, essai sur la traduction».
Nëntor 2016	Prezantim i librit pranë Bibliotekës Kombëtare Pjetër Bogdani në Prishtinë.
Janar 2017	Prezantim i botimit në Lozanë.
Mars 2017	Botim në gjuhën shqipe i librit «Dallime Identike», ese mbi përkthimin.

Pjesa 2: Përshkrimi i pyetjeve dhe përfundimet e projektit

Përmbledhje e shkurtër

Tema është studimi mbi përkthimin në Kosovë dhe studim teorik mbi përkthimin gjetiu në Botë. Ky studim është bërë në kuadër të Master në MIC (Master of Advanced Studies in Intercultural Communication) pranë Fakultetit të shkencave të Komunikimit në Universitetin e Luganës.

Pastaj këtë studim e kam ripërpunuar dhe shoqëruar me kërkime teorike për të dhënë si rezultat botimin në gjuhët fringe dhe shqipe të Librit «Dallime Identike», një ese mbi përkthimin.

Për rikujtim, ky studim, kishte për qëllim tre refleksione:

1. Kuadrot nuk janë të aftësuara në fushën e përkthimit dhe komunikimit.
2. Përkthimi në Kosovë është ndikuar nga filtrimet ideologjike.
3. Përkthimi në Kosovë është i njëanshëm, do të thotë përkthime që vijnë nga jashtë në Kosovë, por jo nga Kosova jashtë saj.

Kuadrot nuk janë të aftësuara në fushën e përkthimit dhe komunikimit (pyetësi i parë).

Lidhur me këtë çështje, vlerësoj se bashkëbiseduesit tanë trajtonin me thellësi çështjen e përkthimit dhe komunikimit:

- Përvoja e tyre profesionale, rrugëtimet e tyre personale dhe përjetimet e tyre i jepnin atyre një lehtësim për ta trajtuar temën. Megjithatë, ky përfundim, me këtë mostër të popullatës, nuk mund të verifikohet.

Lidhur me dy refleksionet e tjera, ato pothuajse janë vërtetuar gjatë intervistave:

- Po, përkthimi, sidomos letrar, ai i produkteve të të gjitha llojeve bëhet në mënyrë të njëanshme: nga jashtë në Kosovë.
- Po, përkthimet në Kosovë janë «filtruar» nga regjimi i ish-Jugosllavisë. As tekstet e autorëve kosovarë, as dëshmitë e tyre, nuk janë përkthyer në gjuhët e huaja, përderisa në ish-Jugosllavi, kishte një traditë të madhe të përkthimit letrar, siç e dëshmojnë dy kongreset vjetore të Federatës Ndërkombëtare të Përkthyesve (më 1963 në Dubrovnik dhe më 1990 në Beograd).

Përkthyesit letrarë kosovarë nuk ishin të stimuluar, të aftësuar, të inkurajuar, të mbështetur gjatë dekadave.

Ky punim, që e trajton një temë aq të gjerë, siç është përkthimi dhe komunikimi, do të mjaftohet të skicojë disa qasje të ndryshme të përkthimit, siç janë:

- qasja deskriptive- «si përkthejmë?»
- qasja preskriptive- «si duhet përkthyer?»
- qasja teorike - «ç'duhet përkthyer?»

Dhe për ta përfunduar këtë prolog, një paraqitje e gjendjes në Zvicër, me katër rajonet e saj gjuhësore; si dhe atë të Kosovës, gjithashtu shumëgjuhësore, të cilat janë shembuj, ku komunikimi ndërkulturor mbështetet gjerësisht mbi përkthimin.

Thelbi i hulumtimit tim ishte në Kosovë, sepse shqiptarët e përbëjnë bashkësinë e dytë të huaj në Zvicër, pas italianëve, e që rreth 10% e popullatës së Kosovës jeton ose punon në Zvicër.

Një përkthim është, para së gjithash, një pasqyrim dhe një komunikim ndërkulturor.

Duke u mbështetur mbi pasqyrime dhe jo mbi refleksë, ai do të rezultoi edhe më i pasur. Zvicra është e pranishme në Kosovë me organizata të ndryshme, ku do të përmend vetëm Agjencinë për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Terre des Hommes, Swisscoy, OSEO dhe Kryqin e Kuq.

Zvicra e ka kremtuar më 1991 përvjetorin e 700 të themelimit të saj, përderisa Kosova e ka shpallur pavarësinë e saj më 2008. Një kontrast i tillë, krahas pikëpamjes së përjetimit, meritonte të merrej parasysh dhe të thellohej në analizat komunikuese.

Qëllimi i hulumtimit dhe elementet e metodologjisë

- Gjendja e letërsisë dytësore: një mungesë e shprehur e studimeve mbi përkthimin dhe komunikimin në Kosovë më kanë motivuar ta ndërmarrë këtë studim.
- Kam zbatuar një hulumtim kualitativ për këtë studim.
- Për grumbullimin e të dhënave kisha nevojë për informatat që paraqitnin një vështrim të përgjithshëm të përkthimit dhe të komunikimit brenda Kosovës, por edhe jashtë saj.
- Kam zgjedhur, si rrjedhojë, bashkëbisedues të privilegjuar, në një mostër domethënëse të popullatës, nga pikëpamja kualitative, që përfaqësonte më së miri dukurinë e hulumtuar në këtë hulumtim.
- Duke qenë se banojë në Zvicër, kam zgjedhur një numër të vogël të njerëzve, pra vetëm dhjetë sosh.
- Kriteret e përzgjedhjes: mosha «transitore», pra midis 30 dhe 50 vjet, që kanë përfunduar përgatitjen e tyre profesionale, që kanë njohur gjendjen e para luftës, që kanë punuar në korniza institucionale ose që kanë qenë profesionistë dhe që kanë një vështrim të përgjithshëm të problematikës.
- Kriteret e shumëllojshmërisë janë marrë po ashtu në konsideratë: 5 meshkuj dhe 5 femra, të profesioneve të ndryshme dhe të rajoneve të ndryshme të Kosovës.
- Si instrumentë për t'i grumbulluar këto informata (në mesin e katër teknikave të mundshme: vëzhgimi, intervista individuale, intervista grupore dhe përdorimi i dokumenteve) kam përzgjedhur intervistat individuale me mbështetjen e një pyetësoi të hartuar paraprakisht.
- Kam vepruar me induksion sa i përket teorisë së hulumtimit.
- Konceptet ishin të hapura dhe janë ndërtuar përgjatë hulumtimit; hipotezat fillestare u konfirmuan në fund.
- Roli im ishte empatik, përderisa roli i subjekteve të studiuara ishte aktiv.
- Përzgjedhja ime metodologjike është ndërtuar me shkathësi gjatë hulumtimit tim, përderisa të dhënat janë grumbulluar duke marrë shënime. Meqë dy persona nuk pranuan të inçizohen, kam marrë shënime me shkrim, duke ia dërguar shënimet për rilexim, për të qenë i sigurt rreth formulimit dhe besueshmërisë së pohimeve të tyre. Është ruajtur spontaniteti, por intervistat ishin më të ngadalshme për shkak të rileximit të tyre.
- Kam kryer vetëm një herë dy intervista në të njëjtën ditë, përndryshe kam bërë një intervistë në ditë.
- Qëllimi i kësaj analize të të dhënave ishte individi, përderisa qëllimi i analizës ishte kuptimi i konteksteve të saj të komunikimit.
- Paraqitja e të dhënave është narative, e shoqëruar me pjesë të përgjigjeve. Për ta lehtësuar leximin dhe paraqitjen e të dhënave, do t'i rimarrë të gjitha pyetjet dhe do t'i paraqes njërën pas tjetrës, me pjesët kuptimplote të përgjigjeve ose të atyre që më kanë munguar.

Pjesa 3: Pyetje të hapura në lidhje me projektin, pikënisjet për punë dhe hulumtime të tjera

- Studimi im është i pamjaftueshëm.
- Disa «shkëndijë» janë nxjerrur dhe shpresoj «ta ndezë zjarrin e mendimeve» dhe më vonë ta thellojë temën me ndonjë studim të ri, me bashkëbisedues të tjerë, sidomos ata nga minoritetet, sepse vetëm pikëpamja e kosovarëve që flasin shqip është e përfaqësuar në këtë punim.
- Poashtu mbetet të bëhët akoma me shumë në promovimin dhe në përcjelljen e njohurive në lëmin e përkthimeve dhe komunikimeve pranë institucioneve të thirrura me këtë problematikë.
- Studimet në fushën e përkthimit janë pothuajse të paqena dhe institucionet nuk kanë bërë me sa duket ndonjë gjë në këtë fushë.
- Përkthimet, sidomos shkencore, rrjedhnin nga serbo-kroatishtja, përderisa ato letra re nga Shqipëria.
- Këto të fundit ishin një herë të «filtruar» ideologjikisht në Shqipëri dhe pastaj për së dyti, nga regjimi nacionalist në pushtet në Beograd.
- Një filtrim i dyfishtë: ideologjik dhe nacionalist.
- Gjendja e përshkruar pas luftës më 1999 nuk e ka ndihmuar fare çështjene përkthimit, edhe pse mund të vërehen disa përparime për momentin.
- Pas shumë përkthimeve të nxituara (ushtarake, policore, dokumente zyrtare, produkte, tekste fetare, dëshmi, barna, etj.), mendimet rreth përkthimit kanë filluar të shpërfaqen.
- Kur përkthimet bëhen në mënyrë pothuajse të njëanshme dhe që numri i tyre i vogël nuk përfundon me një përzgjedhje të menduar, atëherë përkthimi mund ta luajë po ashtu një rol negativ në komunikim.
- Thirrja në shërbimet e përkthyesit do ta lehtësonte komunikimin midis përbërësve gjuhësor në Kosovë por në një kohë afatgjate, kjo gjendje krijon « pengesa të komunikimit » që nuk e ndihmojnë aftësimin e ndërsjellë gjuhësor.

Pjesa 4: Përshkrimi i procesit të punës gjatë kohëzgjatjes së Projektit, përvojat me bashkëpunimin dykombëtar dhe shumëkombëtar

–

Pjesa 5: Këshilla për faza të caktuara të ngjashme për thellimin dhe konsolidimin, lidhur me projekte shumëkombëtare

- Në bazë të përvojës së këtij projekti, rekomandoj të bëhen projekte të cilat japin perspektiva afatgjate.
- Në rastin tone po e përmendi vetëm një shembull të një projekti i cili po merr formë duke ju falenderuar projektit të përkrahur nga NEZI dhe për të cilin po bëhët raporti:
- Në bashkëpunim me Universitetin e Lozanës (Qendrën e Kërkimeve Letrare të Zvicrës Franceze), me departamentin e Frengjishtës së Universitetit të Prishtinës dhe me ISEAL, kemi filluar një projekt në synim të një botimi të një libri në gjuhën frënge dhe një tejtri në gjuhën shqipe në raport me gjeneratën e dytë të shqiptarëve në Zvicër apo të Shqiptarëve të Zvicrës.

Seria e dokumentacioneve DOK e Qendrës International Projects in Education (IPE, Projekte Ndërkombëtare në Edukim) e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Cyrihut, merret me çështjet e fushës së bashkëpunimit për zhvillimin pedagogjik. Seria DOK prezanton rezultatet e dijeve dhe të hulumtimeve nga projektet ndërkombëtare për arsimin të IPE-së. Pika kyçe janë temat e emigrimit dhe të integritit, të edukimit demokratik dhe të edukimit për të Drejtat e Njeriut, të orientimit për përzgjedhjen e profesionit si edhe Life Skills dhe vetëkompetenca.

Në kuadrin e rrjetit «Kultura e parë, e dytë dhe ndërkultura: Për dinamikën e të rriturit në dhe midis sistemeve të ndryshme referimesh dhe normash» (NEZI), në vitet 2013 – 2016, kanë bashkëpunuar në mënyrë shumë konstruktive shkencëtarë dhe hulumtues nga trojet shqiptare dhe nga Zvicra; krahaso vëllimin I të serisë DOK.

Falë menaxhimit me kujdes të financave, mundën të realizoheshin jo më pak se dhjetë projekte të NEZI-t në vijim si edhe projekte implementuese. Në grupe më të vogla, dy- apo shumëkombëtare, hulumtuesit thelluan aspekte të pjesshme, lidhur me rrjetin NEZI: Projekte të implementimit konkret në fushën e edukimit për demokraci, projekte për forcimin e strukturave ndihmëse, si edhe projekte hulumtuese në kontekstin e bikulturalitetit.

«Ky vëllim paraqet raportet përmbyllëse të kësaj faze, jashtëzakonisht të frytshme, për thellimin, realizimin dhe implementimin.»

BENEDIKT HAUSER,
SEKRETARIAT SHTETËROR ZVICERAN PËR ARSIM, KËRKIM DHE INOVACION